II. 111. 387

INSTITUTI I SHKENCAVE

V. I. LENIN

SHTETI
DHE
REVOLUCJONI

TIRANË 1949

NDËRMARRJA SHTETNORE E BOTIMEVE DHE SHPËRNDARJES

V. I. LENIN

★

SHTETI DHE REVOLUCJONI

PROLETARË TË TË GJITHA VËNDEVE, BASHKOHUNI!

INSTITUTI I SHKENCAVE

V. I. LENIN

SHTETI
DHE
REVOLUCJONI

DOKTRINA E MARKSIZMIT MI
SHTETIN DHE DETYRAT E PRO-
LETARJATIT NË REVOLUCJON

NDËRMARJA SHTET. E BOTIMEVE DHE SHPËRNDARJES
TIRANË, 1949

BIBLIOTEKA NARODOWA

II.111.387

1952 D 48/9

Parathënje për botimin e parë

Problemi i shtetit po merr sot një rëndësi të veçantë si nga pikëpamja teorike ashtu edhe nga pikëpamja politike-praktike. Lufta imperjaliste ka shpejtuar dhe ashpërsuar në mënyrë të jashtëzakonëshme procesin e transformimit të kapitalizmit monopolist në kapitalizëm monopolist të shtetit. Shtypja e tmerrshme e masave punonjëse nga ana e shtetit, që lidhet gjithënjë më ngushtë me grupe të plotfuqishme kapitalistësh, bëhet gjithënjë më e tmerrshme. Vëndet e përparuara po bëhen — ne flasim për «prapavijat» e tyre — galera ushtarake për punëtorët.

Tmerret dhe mjerimet pa shëmbëll të luftës, që po zgjatet, po e bëjnë të paduruarshme gjëndjen e masave, shtojnë revoltimin e tyre. Duket sheshit se revolucjoni proletar ndërkombëtar po rritet. Problemi i qëndrimit të tij kundrejt shtetit po merr një kuptim praktik.

Elementet e oportunizmit, që janë grumbulluar gjatë dhjetra vjet çvillimi rëlativisht paqësor, kanë krijuar rrymën socjal-shoviniste, që sundon në partitë socjaliste zyrtare të gjithë botës. Kjo rrymë (Plehanof, Potresof, Breshkofskaja, Rubanoviç, pastaj në një formë pakëzë të mbuluar Z. Z. Cereteli, Çernof dhe Shokë në Rusi; Scheidemann, Legien, David dhe të tjerë në Gjermani; Renaudel, Guesde, Vandervelde në Francë dheinë Belgjikë; Hyndman dhe Fabjanët [1] në Angli etj. etj.) që është socjalizëm me fjalë dhe shovinizëm në fakt, dallohet nga fakti se «krerët» e «socjalizmit» u janë përshtatur në mënyrë të poshtër dhe servile interesave jo vetëm te borgezisë së «tyre» nacjonale, po pikërisht të shtetit të «tyre», pse shumica të ashtuquajturave fuqi të mbëdha ka kohë që çfrytëzon dhe skllavëron

një sërë kombësirash të vogëla dhe të dobëta. Dhe lufta imperjaliste është pikërisht një luftë për ndarjen dhe rindarjen e një plaçke të tillë. Lufta për çlirimin e masave punonjëse nga influenca e borgezisë përgjithërisht, e borgezisë imperjaliste veçanërisht, nukë munt të bëhet pa një luftë me paragjykimet oportuniste në çështjen e «shtetit».

Ne do të studjojmë në krye doktrinën e Marksit dhe të Engelsit mi shtetin, dhe do të flasim me hollësi veçanërisht për ato anë të kësaj doktrine, që janë harruar ose kanë pësuar shtrëmbërime oportuniste. Ne do të merremi pastaj në mënyrë të veçantë me përfaqësonjësin kryesor të këtyre shtrëmbërimeve, me Karl Kautsky-n, me kryetarin më të përmëndur të Internacjonales së Dytë (1889-1914), që falimentoi kaqë keq në këtë luftë. Më në funt, ne do të nxjerrim mësimet kryesore të revolucjoneve ruse të v. 1905 dhe sidomos të v. 1917. Ky revolucjon i fundit, si duket, gjëndet tani (fillim i gushtit 1917) në funt të fazës së parë të çvillimit të tij, po ky revolucjon përgjithërisht munt të kupëtohet vetëm si një nga hallkat e zinxhirit të revolucjoneve proletare socjaliste, të shkaktuara nga lufta imperjaliste. Në këtë mënyrë çështja e qëndrimit të revolucjonit socjalist të proletarjatit kundrejt shtetit fiton jo vetëm një rëndësi politiko-praktike, po dhe një rëndësi shumë aktuale, pse këtu është fjala për t'u shpjeguar masava ç'duhet të bëjnë në një të arthme të afërt për çlirimin e tyre nga zgjedha e kapitalit.

Gusht 1917. AUTORI

Parathënje për botimin e dytë

Ky botim i dytë shtypet pothuajse pa asnjë ndryshim. Është shtuar vetëm, në kapitullin II, paragrafi III.

Moskë, *30 (17) dhjetor 1918.* AUTORI

KAPITULLI I.

SHOQËRIJA ME KLASA DHE SHTETI

1. *Shteti-produkt kontradiktash të papajtuarshme ne mes të klasave*

Me doktrinën e Marksit po ndoth tani ajo që ka ndodhur shumë herë në histori me doktrinat e mendimtarëve revolucjonarë dhe të krerëve të klasave të shtypura në luftën e tyre për çlirim. Klasat shtypëse revolucjonarët e mbëdhenj i kanë çpërblyer për së gjalli me ndjekje të pareshtura, e kanë pritur doktrinën e tyre me inatin më të egër, me urrejtjen më të tërbuar, me një fushatë fare të paturpëshme gënjeshtrash dhe çpifjesh. Pas vdekjes së tyre bëhen orvatje për t'i transformuar në ikona të padëmshme si të thuash, t'i kanonizojnë, t'i japin *emrit* të tyre një farë lavdije për të «ngushëlluar» klasat e shtypura dhe për t'i mashtruar, duke tredhur *përmbajtjen* e doktrinës revolucjonare, duke topitur presen e saj revolucjonare, duke e banalizuar. Në një «trajtim» të tillë të marksizmit puqen tani në gjirin e lëvizjes punëtore, borgezija dhe oportunistët. Harrojnë, e mbysin, e shtrëmbërojnë anën revolucjonare të doktrinës. shpirtin revolucjonar të saj. Nxjerrin në plan të parë, lëvdojnë atë që është e përshtatëshme ose që duket se është e përshtatëshme për borgezinë. Tani gjithë socjal-shovinistët janë «marksistë», — mos qeshni Dhe dijetarët borgezë gjermanë, që gjer më dje ishin spe

cjalizuar në çfarosjen e marksizmit, flasin gjithënjë më tepër për Marksin «nacjonal-gjerman», që gjoja i paska edukuar shoqëritë punëtore të organizuara kaqë bukur për të bërë një luftë grabitëse!

Përpara një gjëndjeje të tillë, përpara shtrëmbërimesh që janë përhapur kaqë shumë, detyra jonë është në radhë të parë të *rivendosim* doktrinën e vërtetë të Marksit mi shtetin. Për këtë gjë duhet të bijem një seri të tërë * citatesh të gjata nga veprat e vetë Marksit dhe Engelsit. Natyrisht, citatet e gjata e bëjnë paraqitjen të rëndë dhe nukë ndihmojnë aspakë për karakterin e saj popullor. Po pa to nukë munt të bëjmë kurrësesi. Duhet të bijem me domosdo, në mënyrë sa më të plotë, të gjitha pasazhet, ose të pakën të gjitha pasazhet vendimtare të veprave të Marksit dhe të Engelsit, që kështu këndonjësi të munt të formojë vetë një ide mi pikëpamjet e themelonjësve të socjalizmit shkencor në tërësinë e tyre dhe mi çvillimin e këtyre pikëpamjeve, që kështu të munt të provohet me dokumenta dhe të tregohet sheshit shtrëmbërimi i këtyre pikëpamjeve nga ana e «kautskizmit» që sundon sot.

Po fillojmë me veprën më të përhapur të Fr. Engelsit: «Origjina e familjes, pronës private dhe shtetit», që doli më 1894 në Stuttgart në botimin e VI. Ne duhet të citojmë nga origjinalet gjermane, pse përkthimet ruse, me gjithë se ka shumë syresh, në pjesën më të madhe ose nukë janë të plota ose janë bërë shumë keq.

> «Shteti — thotë Engelsi dukh nxjerrë përfundimin nga analiza e tij historike, — nuk ësht aspak një forcë, që i ësht impozuar shoqërisë nga jashtë. Shteti gjithashtu nuk është «realiteti i idesë morale», «fotyra dhe realiteti i arësye:», siç thotë Hegeli. Shteti ësbtë produkti i shoqërisë në një shkallë të caktuar të çvillimit të saj; shteti

---

* Në dorëshkrim fjala "të tërë,, mungon. Sh. Red.

është pohimi se kjo shoqëri është futur në një kontradiktë të pazgjidhëshme me veten e saj, prej së cilës nuk është në gjëndje që të shpëtojë. Dhe që këto antagonizma, këto klasa me interesa ekonomike të kundërta, të mos tëgllabërojnë shoqi-shoqin në një luftë të sh!erpë, për këtë gjë u bë e domosdoshme një forcë, që gjoja qëndron përmi shoqërinë, një forcë që ta zbusë konfliktin, që ta mbajë këtë konflikt në kufitë e «rendit». Dhe kjo forcë, e dalënga shoqërija, po që e vë veten përmi shoqërinë, që largohet gjithënjë më tepër prej saj, është shteti» (faqe 177-178 të bot. VI gjerman).

Këtu është shprehur me qartësi të plotë ideja kryesore e marksizmit mi rolin historik dhe mi rëndësinë e shtetit. Shteti është produkti dhe çfaqja e *karakterit të papajtuarshëm* të kontradiktave të klasave. Shteti lint atje, kur dhe në atë masë që kontradiktat e klasave objektivisht *nukë munt* të pajtohen. Dhe përkundrazi: egzistenca e shtetit provon se kontradiktat e klasave nukë munt të pajtohen.

Pikërisht në këtë pikë esencjale dhe rrenjësore fillon shtrembërimi i marksizmit, një shtrëmbërim që ndjek dyvija kryesore.

Nga një anë, ideologët borgezë dhe sidomos ideologët mikroborgjezë, të shtrënguar nënë presjonin e fakteve historike të pamohuarshme që të pranojnë se shteti egziston vetëm atje, ku ka kontradikta klasash dhe luftë klasash, e «ndreqin» Marksin në mënyrë që shteti duket si një organ për *të pajtuar* klasat. Sipas Marksit, shteti as munt të dilte, as munt të mbahesh, po të qe se pajtimi i klasave të ishte një gjë e mundëshme. Sipas profesorëve dhe publicistëve mikroborgezë dhe filistinë — që shpesh e citojnë Marksin me mirëdashje, — shteti pikërisht i pajtoka klasat. Sipas Marksit, shteti është nji organ *sundimi* klasash, organ i *shtypjes* së një klase nga një klasë tjetër,

është krijimi i «rendit», që e sankcjonon dhe siguron këtë shtypje, duke zbutur konfliktin në mes të klasave. Sipas opinjonit të politikanëve mikroborgezë, rendi është pikërisht pajtimi i klasave dhe jo shtypja e një klase nga një klasë tjetër; të zbutësh konfliktin do të thotë të pajtosh klasat, dhe jo t'u heqësh klasave të shtypura mjetet dhe mënyrat e luftës për të përmbysur shtypësit.

Për shembëll në revolucjonin e v. 1917, kur pikërisht çështja e rëndësisë dhe e rolit të shtetit u ngrit në tërë madhërinë e saj, u ngrit në mënyrë praktike, si një problem vepërimi imedjat dhe për më tepër të një vepërimi masash, të gjithë socjalistët-revolucionarë dhe menshevikët shkanë të gjithë menjëherë dhe funt e krye në teorinë mikroborgeze të «pajtimit» të klasave «nga ana e shtetit». Rezolutat dhe artikujt pa numur të politikanëve të këtyre dy partive janë mbushur tej e përtej me këtë teori mikroborgeze dhe filistine të «pajtimit». Që shteti është një organ i sundimit të një klase të caktuar, që *nuk munt* të pajtohet me antipodin e tij (me klasën e kundërt), këtë gjë demokracija mikroborgeze nuk është në gjëndje kurrë që ta kupëtojë. Qëndrimi kundrejt shtetit është një nga provat më evidente se eserët dhe menshevikët tanë nukë janë aspakë socjalistë (siç e kemi provuar gjithënjë ne bolshevikët), po demokratë-mikroborgezë me një frazeologji thuajse socjaliste.

Nga ana tjetër, falstifikimi «kautskjan» i marksizmit është shumë më i hollë. «Nga pikëpamja teorike» nukë mohojnë se shteti është një organ sundimi klasash dhe që kontradiktat e klasave nukë munt të pajtohen. Po lenë me një anë ose fshehin këtë fakt: në qoftë se shteti është një produkt i karakterit të papajtuarshëm të kontradiktave të klasave, në qoftë se ay është një forcë, që qëndron *përmi* shoqërinë dhe «*që largohet gjithënjë më tepër* nga

shoqërija», atëhere është sheshit se çlirimi i klasës së shtypur jo vetëm nukë munt të bëhet pa një revolucjon me forcë, *po edhe pa çdukjen* e aparatit të pushtetit të shtetit, që është krijuar nga klasa sundonjëse dhe në të cilin ky «largim» është trupëzuar. Këtë konkluzjon, që nga pikëpamja teorike ësht i qartë vetëvetiu, Marksi e ka nxjerrë, siç do ta shohim më poshtë, në mënyrë fare kategorike në bazë të një analize historike konkrete të detyrave të revolucjonit. Dhe pikërisht këtë konkluzjon Kautski — në këtë do ta tregojmë më poshtë me hollësi —... «e harroi» dhe e shtrëmbëroi.

2. *Formacjone specjale të armatosura, burgje e të tjera*

.....«Në krahasim me organizimin e vjetër të fiseve të tribuve ose të kiasave — vazhdon Engelsi — shteti dallohet, e para, me ndarjen e shtetasve në bazë territorjale»..... Neve kjo nkarje na duket «e natyrshme», po për këtë gjë është dashur një luftë e gjatë me organizimin e vjetër sipas tribuve ose fiseve

.....«Karakteristika e dytë dallonjëse është themelimi i një pushteti publik, që nukë koincidon më drejt për drejt me popullsinë, që organizohet vetë zi forcë e armatosur. Ky pushtet i veçantë publik ësht i domosdoshëm, ose organizimi i armatosur vëtëvepëronjës i popullisisë u bë një gjë e pamundëshme me ndarjen e shoqërisë në klasa.... Ky pushtet publik egziston në çdo shtet. Ay përbëhet jo vetëm nga sjera të armatosur, po dhe nga akcesorë materjalë, nga burgje dhe nga institucjone detyronjëse te çdo lloji, që nukë njiheshin në stoqërinë e fiseve».....

Engelsi çvillon konceptin e asaj «force», që quhet shtet, e asaj force që ka dalë nga shoqërija, po që e ka vënë veten e saj përmi shoqërinë dhe që largohet gjithënjë më tepër nga shoqërija. Ç'është, kryesisht, kjo forcë? Forma

BIBLIOTEKA NARODNE

cjone specjale të armatosura, që kanë në dispozicjon të tyre burgje etj.

Ne kemi të drejtë të flasim për formacjone të armatosura, pse pushteti publik, që është karakteristikë për çdo shtet, «nukë koincidon drejt për drejt» me popullsinë e armatosur, me «organizimin e armatosur vetëvepëronjës» të saj.

Si gjithë mendimtarët e mëdhenj revolucjonarë, Engelsi përpiqet të drejtojë vëmëndjen e punëtorëve të nëergjegjëshëm pikërisht mi atë gjë që filistinizmit sundonjës i duket si gjëja që meriton me pakë vëmëndje, si gjëja më e zakonëshme, e shënjtëruar nga paragjykime jo vetëm të shëndosha, po, munt të themi, të ngurosura. Ushtërija permanente dhe policija janë veglat kryesore të forcës së pushtetit të shtetit. Po vallë a mund të jetë ndryshe ?

Nga pikëpamja e shumicës së madhe të evropjanëve të fund t të shek. XIX, të cilëve u drejtohesh Engelsi dhe të cilët nuk kishin jetuar dhe nukë kishin parë për së afërmi asnjë revolucjon të math, kjo nukë munt të ishte ndryshe. Ata nukë kupëtojnë fare ç' është «një organizim i armatosur vetëvepronjës i popullsisë». Kur i pyesin përse u deshën formacjone të armatosura specjale (policija, ushtërija e përherëshme) të vëna përmi shoqërinë, që largohen nga shoqërija, filistini i Evropës së Perëndimit dhe filistini rus përgjigjen me dy tri fraza të marra nga Spencer [2]) dhe Mihajlovski, [3]) duke thënë se jeta shoqërore komplikohet, funkcjonet diferencohen, dhe të tjera si këto. Kjo duket si një gjë «shkencore» dhe e vë në gjumë fare bukur filistinin duke mbuluar atë që është kryesore dhe themelore : ndarjen e shoqërisë në klasa kundështare të papajtuarshme.

Po të mos ishte kjo ndarje, «organizimi i armatosur

vetëvepronjës i popullsisë» do të dallohesh për karakterin e tij kompleks, për nivelin e lartë të teknikës së tij etj. nga organizimi primitif i kopesë së majmunëve të armatosur me shkopinj ose nga njerzit primitivë ose nga njerzit e bashkuar në shoqërinë e fiseve, po një organizim i tillë munt të egzistonte.

Ay nukë munt të egzistojë, pse shoqërija e qytetërisë është ndarë në klasa kundërshtare dhe në klasa kundërshtare të papajtuarshme dhe armatosja e tyre «vetëvepëronjëse» do të shpinte në një luftë të armatosur në mes të tyre. Formohet shteti, krijohet një forcë specjale, formacjone të armatosura specjale dhe çdo revolucjon, duke prishur aparatin e shtetit, na tregon sneshit se si klasa sundonjëse përpiqet të përtrijë formacjonet e armatosura specjale që i shërbejnë asaj, se si klasa e shtypur përpiqet të krijojë një organizatë të re të këtij lloji, një organizatë që t' u shërbejë të çfrytëzuarve dhe jo çfrytëzonjësve.

Engelsi në vëndin që cituam shtron nga pikëpamja teorike pikërisht atë problem, që praktikisht, në mënyrë evidente dhe në shkallën e një veprimi të masave, shtron përpara nesh çdo revolucjon i math, — problemin e raportit në mes të formacjoneve të armatosura «specjale» dhe të organizimit të armatosur vetëvepëronjës të popullsisë. Ne do të shohim se si ky problem ilustrohet konkretisht nga eksperjenca e revolucjoneve evropjane edhe ruse.

Po të kthehemi prapë te Engelsi.

Ay thotë se nga një herë, për shëmbëll aty-këtu në Amerikën e Veriut, ky pushtet publik është i dobët (është fjala për një përjashtim të rallë në shoqërinë kapitaliste dhe për ato pjesë të Amerikës së Veriut në periodën e

saj paraimperjaliste, kur predominonte kolonisti i lirë) po përgjithërisht ky pushtet forcohet:

> .....«Pushteti publik forcohet sa më tepër ashpërsohen kontradiktat e klasave brënda shtetit dhe sa më tepër shtetet kufitare rriten dhe shtohen në popullsi. Shikoni për shëmbëll Evropën e sotme, ku lufta e klasave dhe konkurenca për pushtime e kanë vërvitur pushtetin publik në një lartësi të tillë, sa që është rrezik se mos gllabërojë gjithë shoqërinë dhe vetë shtetin.»....

Kjo është shkruar pak kohë pas vitit 1890, jo më vonë.

Parathënja e fundit e Engelsit ka datën 16 qërshor 1891. Atëhere kthesa drejtë imperjalizmit — në kupëtimin e sundimit të plotë të trusteve, në kupëtimin e sundimit të gjithëfuqishëm të bankave të mëdha dhe në kupëtimin e një politike kolonjale në shkallë shumë të gjërë etj. — sapo kish filluar në Francë, kurse në Amerikën e Verrut dhe në Gjermani ishte më e dobët. Që atëhere e këtej «konkurenca e pushtimeve» ka bërë një çap vigan përpara aqë më tepër që në fillim të dhjetëvjetëshit të dytë të shek. XX lëmshi i tokës ishte ndarë në mes të këtyre «pushtonjësve konkurentë» d. m. th. në mes të shteteve të mbëdha grabitëse. Që atëhere e tëhu armatosjet ushtarake dhe detare u shtuan pa masë dhe lufta grabitëse 1914-1918 për sundimin e botës në mes të Anglisë dhe të Gjermanisë, për ndarjen e plaçkës e ka afruar «gllabërimin» e të gjitha forcave të shoqërisë nga ana e pushtetit grabitës të shtetit drejt një katastrofe të plotë'

Engelsi që më 1891 ka thënë se «konkurenca e pushtimeve» është një nga tiparet karakteristike më me rëndësi të politikës së jashtme të shteteve të mbëdha, kurse maskarenjtë e socjal-shovinizmit më 1914-1917, pikërisht kur kjo konkurencë u shtua shumë më tepër dhe polli luftën

imperjaliste, mbulojnë mbrojtjen e interesave grabitëse të borgezisë së «tyre» me fraza mi «mprojtjen e atdheut», mi mprojtjen e republikës dhe të revolucjonit e të tjera si këto!

3. *Shteti si vegël për çfrytëzimin e klasës së shtypur*

Për të mbajtur një pushtet publik të veçantë, që qëndron përmi shoqërinë, duhen taksa dhe hua shteti.

> .....«Duke pasur në dorë pushtetin publik dhe të drejtën për të nxjerrë taksa, funkcjonarët — shkruan Engelsi — si organë të shoqërisë bëhen një forcë, që qëndron *përmi* shoqërinë, Atyre nuk u mjafton më respekti i lirë, vullnetar, që gëzonin organet e shoqërisë së fiseve, edhe sikur ata të munt ta ritonin këtë respekt»..... Krijohen ligjë të veçanta mi shenjtërinë dhë invjolabilitetin e funkcjonarëve. «Agjenti më i humbur i policisë» ka më tepër «autoritet» se sa përfaqësonjësit e fisit, po edhe kryetari i pushtetit ushtarak të një shteti të qytetëruar munt ta ketë zili kryetarin e fisit, që gëzonte «një respekt të fituar jo me shkop» në shoqëri».

Këtu është shtruar problemi i pozitës së privilegjuar të funkcjonarëve si organe të pushtetit të shtetit. Eshtë shënuar si rrënjësore: ç'gjë i vë ata *përmi* shoqërinë? Ne do të shohim se si ky problem teorik u zgjith në mënyrë praktike nga Komuna e Parizit më 1871 dhe u mbyt në mënyrë reakcionare prej Kautskit më 1912.

> .....«Me qenë se shteti lindi nga nevoja për të mbajtur në zgjedhë antagonizmën e klasave; me qenë se shteti lindi njëkohësisht në gjirin e konflikteve në mes të këtyre klasave, prandaj ay, si reguli e përgjithësishmë, është shteti i klasës më të fuqishme, i klasës sundonjëse nga pikëpamja ekonomike, e cila me anën e shtetit bëhet dhe klasa sundonjëse nga pikëpamja politike dhe fiton kështu mjete

> të reja për të shtypur dhe për të çfrytëzuar klasën e shfypur»..... Jo vetëm shteti i vjetër dhe shteti feudal kanë qenë organe çfrytëzimi të skllevërve dhe të robërve të tokës, po dhe «shteti parlamentar modern është një vegël për te çfrytézuar punën me mëditje nga ana e kapitalit. Megjithatë si përjashtim ka perioda, kur klasat që lëftojnë në mes të tyre, arrijnë një ekuilibër të tillë forcash, sa që pushteti i shtetit përkohësisht fiton një farë pavarësije kundrejt të dy klasave, në dukje si ndërmjetës në mes të tyre». ....«Kështu kemi monarkinë absolute të shek. XVII-XVIII, bonapartizmin e perandorisë së parë dhe të dytë në Francë, Bismarkun në Gjermani».

Kështu — shtojmë ne — kemi qeverinë e Kerenskit në Rusinë republikane me fillimin e persekutimeve kundër proletarjatit revolucjonar, në një moment, kur Sovjetët për shkak të udhëheqjes së demokratëve mikroborgjezë janë *tani,* më të pafuqishmë, dhe borgjezija nuk është *akoma* mjaft e fortë që t' i përndajë drejt për dretj.

Në republikën demokratike — vazhdon Engelsi — «pasurija përdor pushtetin e saj. tërthorazi, po në mënyrë të sigurt», — pikërisht, e para, me anë të «korupcjonit direkt të funkcjonarëve» (Amerikë), e dyta, me anë të «aleancës në mes të qeverisë dhe të bursës» (Francë dhe Amerikë).

Në kohën e sotme imperjalizmi dhe sundimi i bankave «i çvilluan» në një mjeshtëri të jashtëzakonëshme të dyja këto mënyra për të mprojtur dhe për të raalizuar tërëfuqinë e pasurisë në të gjitha republikat demokratike. Në qoftë se, për shëmbëll në muajt e parë të republikës demokratike në Rusi, si të thuash, në muajin e mjaltit të martesës së «socjalistëve» eserë dhe menshevikë me borgezinë, në qeverinë e koalicionit [4]) z. Palçinski sabotoi të gjitha masat për të frenuar kapitalistët dhe spekullimet e tyre, grabitjen e arkës së shtetit me anë të furnizimeve ushtarake, në qoftë se më von z. Palçinski, që dolli nga mi-

nistrija (i zëvëndësuar, natyrisht, me një tjetër Palçinski pikërisht si ay), «u çpërblye» prej kapitalistëve me një rrogë prej 120.000 rubla në vit, ç' është kjo? një korupcjon direkt apo i tërthortë? aleancë e qeverisë me sindikatat ose «vetëm» raporte miqësije? Ç' rol luajnë Çernovet dhe Çeretelët, Avksjentevët dho Skobeljevët? A janë ata aleatë «direkt» të miljonarëve-kusarë të arkës së shtetit apo vetëm aleatë të tërthortë?

Sundimi i tërë-fuqishëm i «pasurisë» në republikën demokratike është më i *sigurt*, pse ay nukë varet * nga një pështjellë e keqe politike e kapitalizmit. Republika demokratike është pështjella politike më e mirë e kapitalizmit që munt të bëhet, dhe prandaj kapitali, duke futur në dorë (me anë të Palçinskve, Çernevëve, Çereteleve dhe shokë) këtë pështjellë, që është më e mira, vendos pushtetin e vet në mënyrë aqë të shëndoshë, aqë të sigurt, sa që asnjë *një* ndryshim në personat, institucjonet dhe partitë e republikës demokrate borgeze nukë munt ta trondit këtë pushtet.

Duhet të shënojmë edhe se Engelsi në mënyrë fare të prerë e quan të drejtën universale të zgjedhjeve një vegël sundimi të borgezisë. E drejta universale e zgjedhjeve, thotë ay, duke marrë sigurisht parasysh eksperjencën e gjatë të socjal-demokracisë gjermane, është

> «Një shënjë e pjekurisë së klasës punëtore. Në shtetin e sotmë ajo nukë munt të japë dhe kurrë nukë do të japë më tepër».

Demokratët mikroborgezë si socjalistët-revoluc jonarë dhe menshevikët tanë, si edhe vëllezërit e tyre, socjal-shovinistët dhe oportunistët e Evropës së Perëndimit, presin pikërisht «më tepër» nga e drejta universale e zgje-

---

* Në dorëshkrim vijon: «nga disa të meta të mekanizmit politik». Red.

dhjeve. Ata kanë vetë dhe i sugjerojnë popullit idenë e gabuar se gjoja e drejta universale e zgjedhjeve «në shtetin e *sotmë*» është në gjëndje që të nxjerrë në shesh me të vërtet vullnetin e shumicës së masave punonjëse dhe të sigurojë realizimin e këtij vullneti.

Ne këtu vetem po e shënojmë këtë ide të gabuar, vetëm po themi se deklarata fare e qartë, precize dhe konkrete e Engelsit shtrëmbërohet në çdo çap në propagandën dhe agjitacjonin e partive socjaliste «zyrtare» (d.m.th. oportuniste). Do ta shpjegojmë më pas me hollësi gjithë fallsitetin e kësaj ideje, që Engelsi e heth poshtë këtukur të flasim për idetë e Marksit dhe të Engelsit mi shte, tin e «sotmë».

Kështu i përmbleth idetë e tija Engelsi në veprën e tij më popullore:

«Kësh'u shteti nukë ka egzistuar gjithënjë. Ka pasur shoqërira. ku nukë ka pasur nevojë për shtet, kn nukë kishln asnjë ide për pushtetin e shtetit. Në një shkallë të caktuar të çvillimit ekonomik, që është lidhur në mënyrë të domosdoshme me ndarjen e shoqërisë në klasa, shteti për shkak të kësajë ndarjeje u bë i domosdoshëm. Ne tani po afrohemi me çapa të shpejta drejt një shkalle të tillë çvllimi te prodhimit, kur égzistenca e këtyre klasave jo vetëm nukë do të jetë e domos ioshme, po do të bëhet drejt për drejt një pengesë për prodhimin. Klasat do të çduken në mënyrë të paèvituarshme, ashtu siç lindën në mënyrë të paevituarshme në kohën e shkuar. Me çdukjen e klasave do të çduket në mënyrë të paevituarsbme edhe shteti. Shoqërija që do ta organizojë prodnimin në një mënyrë të re në bazë të një bashkëpunimi të lirë dhe të baraburtë të prodhonjësve, do ta flakë maqinën e shtetit atje, ku e ka vëndin për atëhere: në muzeun e antikave, basbkë me çikrikun dhe me sëpatën prej brunxi.»

Këtë citatë nuk e gjen shpesh në literaturën e propagandës dhe të agjitacjonit të socjal-demokracisë së

sotme. Po edhe atëhere kur haset kjo citatë, atë e bijen më tepër si një farë gjunjëzimi përpara një ikone, d.m.th. për të shprehur zyrtarisht respekt kundrejt Engelsit, pa u munduar që të vrasim mëndjen mi vrullin aqë të gjërë dhe të thellë revolucjonar të këtij «të flakuri të gjithë maqinës së shtetit në muzeun e antikave». Në shumicën e rasteve nukë kupëtojnë as ç'do me thënë ajo, që Engelsi quan maqinë shteti.

4. *«Shuarja» e shtetit dhe revolucjoni me forcë*

Fjalët e Engelsit për «shuarjen» e shtetit janë aqë të përmëndura, ato citohen kaqë shpesh, ato tregojnë në mënyrë kaqë të dukëshme thelbin e falsifikimit të zakonshëm të marksizmit në mënyrë oportuniste, sa që këto fjalë duhet t'i shqyrtojmë gjërë e gjatë. Po bijem gjithë pasazhin, prej të cilit janë marrë këto fjalë:

> «Proletarjati merr në dorë pushtetin e shtetit dhe që në krye ai transformon mjetet e prodnimit në proпë shteti* Po me këtë ay çduk vetëveten si proletarjat, me këtë ay çduk gjithë ndryshimet në mes të klasave dhe gjithë antagonizmat e klasave, dhe njëkohësisht edhe shtetin*. Shoqërisë që ka egzistuar dhe që egziston gjer më sot, shoqërisë që lëvis në antagonizma klasash, i dunesh shteti, d.m.th. një organizatë e klasës çfrytëzonjëse për të mbajtur konditat e saja të jashtme të prodhimit, pra, veçanërisht për të mbajtur me forcë klasën e çfrytëzuar në kondita shtypje, të determinuara nga një mënyrë e caktuar prodhimi (skllavëri, robëri e bujkut, punë me mëditje). Shteti ka qënë përfaqësonjësi zyrtar i gjithë «shoqërisë, përqëndrimi i saj në një korporatë të dukëshme, po ay ishte i tillë vetëm në atë masë që ishte shteti i asaj klase, që në kohën e saj, vetëm, përfaqësonte gjithë shoqërinë: në kohën e vjetër ay ishte shteti i qytetarëve pronarë

---

* Në dorëshktim pason: «si shtet» Red,

skllevërish, në kohën e mesme ay ishte shteti i aristokracisë feudale, në kohën tonë ay është shteti i borgezisë Kur shteti më në funt do të bëhet me të vërtet përfaqësonjësi i gjithë shoqërisë, atëhere ay do të bëhet vetë i tepërm. Kur nukë do të ketë asnjë klasë shoqërore për të mbajtur në zgjedhë, kur bashkë me sundimin e klasave, bashkë me luftën për egzistencën individuale, të pjellë nga anarkija e sotme, në prodhim do të çduken konfliktet dhe ekceset, që rrjedhin nga kjo luftë, — atëhere nukë do të ketë gjësendi për të shtypur, nukë do të ketë dhe nevojë për një forcë të veçantë shtypjeje, për shtetin. Akti i parë, me të cilin shteti del në skenë me të vërtet si, përfaqësonjësi i gjithë shoqërisë — zotërimi i mjeteve të prodhimit në emër të shoqërisë — është njëkohësisht dhe akti i fundit i tij si shtet. Atëhere nderhyrja e pusntetit të shtetit në raportet shoqërore bëhet e tepërt në fusha të ndryshme njera pas tjetrës dhe vetëvetiu shuhet. Vëndin e qeverisjes së personave e zë administrimi i sendeve dhe udhëheqja e proceseve të prodhimit. Shteti nukë «hiqet», *ay shuhet.* Nga kjo pikëpamje duhet çmuar fraza mi «shtetin e lirë popullor», një frazë, që një kohe ka pasur të drejtë egzistence si frazë agjitacjoni, po që në analizë të fundit nukë ka një bazë shkencore. Nga kjo pikëpamje duhet çmuar gjithashtu edhe kërkesa e të ashtuquajturve anarkistë, që duan që shteti të hiqet me sot me neser». (Anti-Dühring) «Përmbysja e shkencës nga zoti Eugen Dühring», f. 302-303 sipas bot. 3 gjermanisht.

Pa frikë se mos gabohemi, munt të themi se nga ky arësyetim shumë i pasur me mendime i Eugelsit u bë pronë e vërtetë e mendimit socjalist të partive socjaliste të sotme vetëm ideja që shteti sipas Marksit «shuhet», në kundërshtim me doktrinën anarkiste të «heqjes» së shtetit. Ta gjymtosh kështu marksizmin do të thotë ta kthesh në oportunizëm, pse me një «interpretim» të tillë nukë mbetet veçse ideja e turbullt e një ndryshimi të ngadalshëm, të barabartë, gradual, e mungesës së hopeve dhe të fortunave, e mungesës së revolucjonit. «Shuarja»

e shtetit në kupëtimin e zakonshëm, në kupëtimin e përhapur përgjithërisht, në kupëtimin si të thuash masif, do të thotë, pa dyshim, maskim, në mos mohim i revolucjonit.

Po, një «interpretim» i tillë është një shtrembërim shumë i trashë i marksizmit, që i intereson vetëm borgezisë, dhe që nga pikëpamja teorike është bazuar në harresën e rrethanave dhe konsideratave esencjale, që përmendëm, për shëmbëll, në arësyetimin «përmbledhës» të Engelsit, që ne e riprodhuam të tërë.

E para. Në filllim të këtij arësyetimi Engelsi thotë se proletarjati, duke marrë në dorë pushtetin e shtetit, «me këtë çduk shtetin si shtet». «Nuk është zakon» të mendosh ç'do të thotë kjo gjë. Zakonisht këtë ose nuk e përmendin fare. ose e konsiderojnë si një farë «dobësije» «hegeljane» të Engelsit. Në të vërtetë në këto fjalë është shprehur shkurt eksperjenca e një nga revolucjonet më të mbëdha proletare, eksperjenca e Komunës së Parizit të v. 1871, për të cilën do të flasim me hollësi në vëndin e duhur. Në të vërtetë Engelsi këtu flet për «çdukjen» e shtetit të *borgezisë* nga ana e revolucjonit proletar, kurse fjalët mi shuarjen kanë të bëjnë me mbeturinat e shtetit *proletar pas* revolucjonit socjalist. Sipas Engelsit, shteti borgez nukë «shuhet» po «çduket» nga proletarjati në revolucjon. Pas këtij revolucjoni shuhet shteti ose gjysmështeti proletar.

E dyta. Shteti është «një forcë specjale për të shtypur». Ky përkufizim shumë i bukur dhe shumë i thellë i Engelslt është formuluar këtu me qartësinë më të madhe. Dhe prej këtij përkufizimi rjeth se «forca e veçantë për shtypjen» e proletarjatit nga ana e borgezisë, e masave punonjëse me miljonë nga një grusht të pasurish duhet të zëvëndësohet me një forcë të veçantë për shtypjen «e borgezisë» nga proletarjati (diktatura e proletarjatit). Këtë do të

thotë «çdukja e shtetit si shtet». Këtë do të thotë «akti» i zotërimit të mjeteve të prodhimit në emër të shoqërisë. Dhe duket sheshit vetëvetiu se një zëvëndësim *i tillë* i një «force të veçantë» (borgeze) nga një tjetër «forcë e veçantë» (proletare), nukë munt të bëhet kurrësesi në formë «shuarjeje».

E treta. Mi «shuarjen» dhe — në mënyrë më të qartë dhe pitoreske — mi «fjetjen» Engelsi flet në mënyrë të qartë dhe kategorike në lidhje me epokën pas marrjes në dorë të mjeteve të prodhimit nga ana e shtetit në emër të gjithë shoqërisë» d.m.th. *pas* revolucjonit socjalist. Ne të gjithë e dimë se forma politike «e shtetit» në këtë kohë është demokracija më e plotë. Po asnjërit nga oportunistët, që shtrëmbërojnë marksizmin paturpërisht, nuk i shkon ndërmënt se këtu është fjala te Engelsi për «fjetjen» dhe «shuarjen» e *demokracisë*. Kjo duket në një vështrim të parë si një gjë shumë e çuditësme. Po kjo «është një gjë e pakupëtuarshme» vetëm për atë që nuk e ka vrarë mëndjen të kupëtojë se demokracija është dhe *ajo* një shtet dhe që, prandaj, demokracija edhe ajo do të çduket kur të çduket shteti. Shtetin borgez munt «ta çdukë» vetëm revolucjoni. Shteti përgjithërisht, d.m.th. demokracija më e plotë, munt vetëm të «shuhet»

E katërta. Si formullon tezën e tij të famëshme: «shteti shuhet», Engelsi shpjegon me një herë në mënyrë konkrete se kjo tezë drejtohet edhe kundër oportunistëve dhe kundër anarkistëve. Dhe në vënt të parë Engelsi vë atë konkluzjon të tezës mi «shuarjen e shtetit», që është drejtuar kundër oportunistëve.

Munt të vëmë bast se prej 10.000 vetash, që kanë kënduar ose dëgjuar për «shuarjen» e shtetit, 9990 nukë dinë fare ose nuk mbajnë mënt se Engelsi nuk i ka drejtuar konkluzjonet e tija të kësaj teze *vetëm* kundër anarkistëve.

Dhe prej 10 vetave që mbeten, sigurisht nëntë nukë dinë ç' është «shteti i lirë popullor» dhe përse sulmi kundër kësaj parulle është një sulm kundër oportunistëve. Kështu shkruhet historija!! Kështu bëhet në mënyrë të padukëshme falsifikimi i doktrinës së madhe revolucjonare sipas filistinizmit që mbretëron. Konkluzjoni kundër anarkistëve është përsëritur me mijra herë, është banalizuar, është futur në kokën e njerzëve në mënyrën më simpliste, ka marrë forcën e një paragjykimi. Kurse konkluzjonin kundër oportunistëve e kanë maskuar dhe «harruar»!

«Shteti i lirë popullor» ka qënë një pikë programatike dhe një parullë kurente e socjal-demokratëve gjermanë më 1870-80. Në këtë parullë nukë ka asnjë përmbajtje politike, përveç përshkrimit mikroborges, emfatik të konceptit të demokracisë. Gjersa në këtë parullë bëhesh aluzjon legalisht për republikën demokratike, Engelsi ishte «përkohësisht» gati «ta justifikonte» këtë parullë për arësye agjitacjoni. Po kjo parullë ishte oportuniste, pse shprehte jo vetëm zbukurimin e demokracisë borgeze, po edhe moskupëtimin e kritikës socjaliste të çdo shteti përgjithërisht. Ne jemi për republikën demokratike si forma më e mirë e shtetit për proletarjatin në regjimin kapitalist, po ne nukë kemi të drejtë të harrojmë se edhe në republikën borgeze më demokratike shorti i popullit është skllavërija me mëditje. Pastaj, çdo shtet është «një forcë e veçantë shtypje» kundër klasës së shtypur. Prandaj *çdo* shtet *nuk* është i lirë dhe *nuk* është popullor. Marksi dhe Engelsi këtë gjë ua kanë shpjeguar shumë herë shokëve të tyre të partisë më 1870-80.

E pesta. Po në këtë vepër të Engelsit, ku përmendet ideja e shuarjes së shtetit që e dimë të gjithë, kemi dhe arësyetimin mi rëndësinë e revolucjonit me forcë. Duke çmuar rolin e tij historik Engelsi bën një panegjirik të

vërtetë të revolucjonit me forcë. Këtë gjë «nuk e përmënt njeri»; mi rëndësinë e kësaj ideje në partinë e sotme socjaliste nuk është zakon që të flasin dhe as që të mendojnë; në propogandën dhe në agjitacjonin e përditshëm në mes të masave këto mendime nukë luajnë asnjë rol. Mirëpo ata janë lidhur me «shuarjen» e shtetit në mënyrë të pazgjidhëshme dhe formojnë një tërësi harmonike.

Ja arësyetimi i Engelsit:

> .....«Që forca luan në histori edhe një rol tjetër (përveç si agjent i së keqes) pikërisht një rol revolucjonar; që ajo, sipas fjalëve të Marksit, është mamija e çdo shoqërije të vjetër, kur ajo është me barrë me një shoqëri të re; që forca është vegla, me të cilën lëvizja shoqërore çan rrugën dhe thyen format politike të ngurosura dhe të vdekura, mi të gjitna këto zoti Dühring nukë thotë asnjë fjalë. Vëtëm me psherëtima dhe me rënkime ay pranon mundësinë që, ndofta, për të përmbysur ekonominë çfrytëzonjëse forca... do të duhet për fat të keq! Pse — thotë ay — çdo përdorje e forcës gjoja demoralizon atë që e përdor. Dhe kjo thuhet, me gjithë ngritjen e madhe morale dhe mendore që ka sjellë me vete çdo revolucjon fitimtar! Dhe kjo thuhet në Gjermani, ku një përpjekje me forcë, që mund t'i impozohesh popullit, do të kishte të paktën avantazhin që do të çdukte frymën e servilizmit, që është futnr në ndërgjegjen nacjonale me poshtërimin që solli me vete lufta e Tridhjet Vjetëve. Dhe kjo ide e turbullt, e qullët, e pafuqishme prej predikatori ka guximin e kërkon t'i imponohet partisë më revolucjonare, që ka parë historija.» (f. 193 e edicjonit të 3-të gjermanisht, fundi i kapitullit 4 të sekcjonit II.)

Si munt të bashkohet në një doktrinë ky panegjirik i revolucjonit me forcë, që Engelsi u a paraqitte me këmbëngulje socjal-demokratëve gjermanë që nga v. 1878 e gjer në vdekjen e tij, me teorinë e «shuarjes» së shtetit?

Zakonisht i bashkojnë njërën me tjetrën me anë të ek-

lektizmit duke kapur pa gjykim ose në mënyrë sofistike, arbitrarisht (ose për t' u bërë qejfin atyre që kanë pushtetin në dorë) herë një arësyetim, herë një tjetër; dhe nëntëdhjetë e nëntë herë mi një qint, në mos edhe më shpesh, vihet në plan të parë pikërisht «shuarja». Djalektika zëvendësohet me eklektizmin: ky është fenomeni më i zakonshëm më i përhapur në literaturën zyrtare socjal-demokrate të ditëve tona, në lidhje me marksizmin. Natyrisht, një zëvendësim i tillë nuk është një gjë e re, kjo gjë është vëne re edhe në historinë e filozofisë klasike greke. Në falsifikimin e marksizmit me oportunizmë, falsifikimi i djalektikës me eklektizmin i gënjen më kollaj masat, u jep një kënaqësi aparente, gjoja se merr parasysh të gjitha anët e procesit, të gjitha tendencat e çvillimit, të gjithë influencat kontradiktore etj, kurse në të vërtetë nukë ep aspak një kupëtim koherent dhe revolucjonar të procesit të çvillimit shoqëror..

Ne thamë më sipër, dhe do të tregojmë me hollësi më të madhe më tutje, se doktrina e Marksit dhe e Engelsit mi karakterin e paevituarshëm të revolucjonit me forcë ka të bëjë me shtetin borg es. Ay *nukë munt* të zëvëndësohet nga shteti proletar (diktatura e proletarjatit) me anë të «shuarjes», po, si rregull e përgjithëshme, munt të zëvëndësohet vetëm me anë të një revolucjoni me forcë. Panegjiriku, që i bën Engelsi revolucjonit me forcë, pajtohet plotërisht me deklaratat e shuma të Marksit — të përmëndim fundin e «Varfërisë së filozofisë» dhe të «Manifestit Komunist», ku çpallet me mburrje dhe sheshit karakteri i paevituarshëm, i revolucjonit me forcë; të përmëndim kritikën e programit të Gothas[6]) të v. 1875, pothuajse tridhjetë vjet më parë, ku Marksi godit pa mëshirë oportunizmin e këtij programi. Ky panegjirik nuk është aspakë efekti i një «entuzjazmi»,

nuk ësht aspak një deklamacjon, një goditje polemike. Nevoja për të edukuar në mënyrë sistematike masat me *këtë* ide dhe pikërisht me këtë ide të revolucjonit me forcë është baza e *gjithë* doktrinës së Marksit dhe të Engelsit. Trathëtija e doktrinës së tyre nga ana e rrymave socjal-shoviniste dhe kautskjane, që sundojnë sot, shprehet në mënyrë veçanërisht të dukëshme në faktin që, si njeri si tjetri, e kanë harruar *këtë* propagandë, këtë agjitacjon.

Zëvëndësimi i shtetit borgez nga shteti proletar nukë munt të bëhet pa një revolucjon me forcë. Çdukja e shtetit proletar, d. m. th. çdukja e çdo shteti, nukë munt të bëhet ndryshe, veçse me «shuarje».

Marksi dhe Engelsi çvilluan këto idera me hollësi dhe në mënyrë konkrete duke studjuar çdo situatë revolucjonare më vete, duke analizuar mësimet e eksperjencës së çdo revolucjoni më vete. Në këtë pjesë, që është pjesa më me rëndësi e doktrinës së tyre, po hidhemi tani.

KAPITULLI II.

SHTETI DHE REVOLUCJONI. EKSPERJENCA E VJETEVE 1848-1851

1. *Vëngjilla e Revolucjonit*

Veprat e para të marksizmit, që kish arrirë në pjekurinë e tij, «Varfërija e Filozofisë» dhe «Manifesti Komunist», bijen pikërisht në vëngjillën e revolucjonit të v.1848. Për këtë arësye, krahas me paraqitjen e parimeve themelore të marksizmit, ne kemi këtu, gjer më një farë pike, pasqyrimin e situatës konkrete revolucjonare të asaj kohe, dhe prandaj është oportune të studjojmë atë që thonë autorët e këtyre veprave mi shterin, pikërisht përpara se të bënin konkluzjonet e tyre nga eksperjenca e vjeteve 1848-1851.

> .....«Klasa punëtore — shkruan Marksi në «Varfërinë e filozofisë» — do të vërë, në çvillim e sipër, në vënt të shoqërisë së vjetër borgeze, një shoqëri, që përjashson klasat dhe antagonizmat e tyre; nukë do të ketë më asnjë pushtet politik në kupëtimin e vërtetë, pse pikërisht pushteti politik është shprehja zyrtare e antagonismit të klasave brënda shoqërisë borgeze» (f. 182 e botimit gjermanisht të v. 1885).

Është instruktive të krahasojmë me këtë paraqitje të përgjithëshme të idesë mi çdukjen e shtetit pas çdukjes së klasave paraqitjen që bëjnë Marksi dhe Engelsi disa muaj

më von — pikërisht në nëntor të v.1848 — në «Manifestin Komunist»:

> .....«Duke përshkruar fazët më të përgjithëshme të çvillimit të proletarjatit, ne kemi ndjekur luftën civile pak' a shumë latente brënda shoqërisë së sotme gjer në pikën, kur ajo bëhet një revolucjon i hapët dhe proletarjati vendos sundimin e tij duke përmbysur me forcë borgezinë».
>
> ....«Ne pamë më sipër se çapi i parë i revolucjonit punëtor është transformimi» (fjalë për fjalë: ngritja) «i proletarjatit në klasë sundonjëse, fitimtar i demokracisë».
>
> «Proletarjati do të përdorë sundimin e tij politik për t'i rrëmbyer pak e nga pakë borgezisë gjithë kapitalin, për të centralizuar të gjitha veglat e prodhimit në duart e shtetit, d.m.th. në duart e proletarjatit të organizuar si klasa sundonjëse dhe për të shtuar sa më shpejt shumën e forcave produktive» (f. 31 dhe 37 të bot. 7 gjermanisht të v. 1906).

Ne shohim këtu formullimin e një ideje nga më të shënuarat dhe më me rëndësi të marksizmit mi shtetin, pikërisht idenë e «diktaturës së proletarjatit» (siç filluan të shpreheshin Marksi dhe Engelsi pas Komunës së Parizit), dhe pastaj një përkufizim shumë interesant të shtetit, që bën pjesë gjithashtu në numrin e «fjalëve të harruara» të marksizmit. «Shteti d.m.th. proletarjati i organizuar në klasë sundonjëse».

Ky përkufizim i shtetit nuk është shpjeguar kurrë në literaturën sundonjëse të propagandës dhe të agjitacjonit të partive zyrtare socjal-demokrate. Po jo vetëm kaqë. Ky përkufizim u harrua pikërisht, pse nukë pajtohet në asnjë mënyrë me reformizmin, pse godit drejt për drejt paragjykimet e zakonëshme oportuniste dhe iluzjonet mikroborgeze mi «çvillimin paqësor të demokracisë».

Proletarjati ka nevojë për shtetin — këtë gjë e përsërisin gjithë oportunistët, socjal-shovinistë dhe kautskjanë,

duke thënë se kjo është doktrina e Marksit, dhe «*duke harruar*» të shtojnë se, e para, sipas Marksit, proletarjati ka nevojë vetëm për një shtet që shuhet, d.m.th. të organizuar në mënyrë të tillë që të fillojë menjëherë të shuhet dhe të mos mundë të mos shuhet. Dhe, e dyta, masat punonjëse kanë nevojë për «shtetin», «d.m.th. për proletarjatin e organizuar si klasë sundonjëse».

Shteti është një organizatë e veçantë e forcës, është organizatë e dhunës për të shtypur një klasë. Ç' klasë duhet të shtypë proletarjati? Natyrisht vetëm klasën çfrytëzonjëse, d.m.th. borgezinë. Masat punonjëse kanë nevojë për shtetin vetëm për të shtypur rezistencën e klasave sundonjëse dhe këtë shtypje munt ta udhëheqë dhe ta realizojë vetëm proletarjati, si e vetmja klasë gjer në funt revolucjonare, si e vetmja klasë, që është në gjëndje të bashkojë të gjitha masat punonjëse dhe të çfrytëzuara kundër borgezisë për përmbysjen e saj të plotë.

Klasat çfrytëzonjëse kanë nevojë për sundimin politik për të mbajtur çfrytëzimin, d.m.th. për interesat egoiste të një pakice të vogël kundër shumicës së madhe të popullit. Klasat e çfrytëzuara kanë nevojë për sundimin politik për të çdukur plotërisht çdo çfrytëzim, d.m.th. për interesat e shumicës së madhe të popullit kundër një pakice shumë të vogël, kundër pronarëve të skllevërve të kohës së sotme, d.m.th. kundër çifligarëve dhe kapitalistëve.

Demokratët mikroborgezë, këta pseudo-socjalistë, që kanë zëvëndësuar luftën e klasave me ëndërrime mi marrëveshjen e klasave, e kanë përfytyruar edhe transformacjonin socjalist si një ëndër, jo si përmbysje të sundimit të klasës çfrytëzonjëse, po si një nënështrim paqësor të pakicës kundrejt shumicës, që ka kupëtuar detyrat e saja. Kjo utopi mikroborgeze, që është lidhur në mënyrë të pazgjidhëshme me pranimin e një shteti, që qëndron përmi kla-

sat, shpuri në praktikë në trathëtinë e interesave të klasave punonjëse, siç e tregoi, për shëmbëll, historija e revolucjoneve franceze të vjeteve 1848-1871, siç e tregoi eksperjenca e pjesëmarrjes «socjaliste» në ministritë borgeze në Angli, në Francë, në Itali dhe në vënde të tjera në fund të shek. XIX dhe në krye të shek. XX.

Marksi gjithë jetën e tij ka lëftuar kundër këtij socjalizmi mikro-borgez, që e kanë ringjallur tani në Rusi partitë e eserëve dhe të menshevikëve. Marksi e ka çvilluar dokrinën e luftës së klasave në mënyrë konsekuente gjer në doktrinën e pushtetit politik, gjer në doktrinën e shtetit.

Përmbysja e sundimit të borgezisë mund të bëhet vetëm nga ana e proletarjatit, si një klasë e veçantë, të cilën e pregatisin për një përmbysje të tillë dhe i japin mundësinë dhe forcën që ta realizojë këtë përmbysje, kondita ekonomike të egzistencës. Në një kohë kur borgezija copëton dhe përndan fshatarësinë dhe gjithë shtresat mikroborgeze, në këtë konë ajo e bashkon, e lith, e organizon proletarjatin. Vetëm proletarjati — në bazë të rolit të tij ekonomik në prodhimin e math — është i aftë të bëhet udhëheqësi i *gjithë* masave punonjëse dhe të çfrytëzuara, që borgezija i çfrytëzon, i mban nënë zgjedhë dhe i shtyp shpesh jo më pakë, po më tepër se proletarët, po që nukë janë në gjëndje të bëjnë një luftë *më vete* për çlirimin e tyre.

Doktrina e luftës së klasave, që Marksi aplikon në çështjen e shtetit dhe të revolucjonit socjalist, shpije në mënyrë të domosdoshme në pranimin e *sundimit politik* të proletarjatit, të diktaturës së tij, d.m.th. të një pushteti që ay nuk e ndan me të tjerë dhe që pështetet drejt për drejt në forcën e armatosur të masave. Përmbysja e borgezisë munt të realizohet vetëm me transformimin e proletarjatit

në klasë sundonjëse, të aftë për të shtypur rezistencën e paevituarshme, të dëshpëruar të borgezisë dhe për të organizuar *të gjitha* masat punonjëse dhe të çfrytëzuara për një regjim të ri ekonomik.

Proletarjatit i duhet pushteti i shtetit, organizimi i centralizuar i forcës, organizimi i dhunës si për të shtypur rezistencën e çfrytëzonjësve, ashtu dhe për të *udhëhequr* masën e madhe të popullsisë, fshatarësinë, borgezinë e vogël, gjysmë-proletarët, në «regullimin» e ekonomisë socjaliste.

Duke edukuar partinë punëtore, marksizmi edukon pararojën e proletarjatit, që është i zoti të marrë pushtetin dhe të *shpjerë gjithë popullin* në socjalizëm, të drejtojë dhe të organizojë regjimin e ri, të jetë mësonjësi, udhëheqësi, kryetari i gjithë masave punonjëse dhe të çfrytëzuara në organizimin e jetës së tyre shoqërore pa borgezi dhe kundër borgezisë. Përkundrazi, oportunizmi që sundon sot edukon në partinë punëtore përfaqësonjësit e paguar më mirë të punëtorëve, që çkëputen nga masa, që «regullohen» mirë në regjimin kapitalist, që shesin për një pjatë me thierza të drejtën e tyre të parësisë, d.m.th. që heqin dorë nga roli si krerë revolucjonarë të popullit në luftën kundër borgezisë.

«Shteti, domethënë proletarjati i organizuar në klasë sundonjëse» — kjo teori e Marksit është lidhur në mënyrë të pandarë me gjithë doktrinën e tij mi rolin revolucjonar të proletarjatit në histori. Kurorëzimi i këtij roli është diktatura proletare, sundimi politik i proletarjatit.

Po në qoftë se proletarjati ka nevojë për shtetin, si një organizatë e *veçantë* dhune *kundër* borgezisë, atëhere këtej del vetëvetiu ky përfundim: a mund të merret me mënt krijimi i një organizate të tillë, pa çdukur më përpara, pa thyer maqinën e shtetit, që borgezija ka krijuar *për ve-*

ten e saj? Në këtë përfundim shpije «Manifesti Komunist», dhe për këtë përfundim flet Marksi duke përmbledhur eksperjencën e revolucjonit të vjeteve 1848-1851.

2. *Bilani i revolucjonit*

Mi çështjen e shtetit që na intereson këtu, Marksi bën bilanin e revolucjonit të vjeteve 1848-1851 në veprën e tij «18 Brumeri i Ludovik Bonapartit» me këtë arësyetim:

> .....«Po revolucjoni është i thellë. Ay është akoma në udhëtim nëpër purgator. Ay e bën punën e tij me metodë. Gjer më 2 dhjetor 1851» (data e grushtit të shtetit të Ludovik Bonapartit) «ay mbaroji gjysmën e punës së tij përgatitëse, tani po mbaron gjysmën tjetër. Ay në fillim shpije gjer në përsosje pushtetin parlamentar, që të këtë mundësi ta përmbysë. Tani, që ay e ka arritur këtë, ay e shpije gjer në përsosje *pushtetin egzekutif*, e çon këtë gjer në shprehjen e tij më të thjeshtë, e izolon, e vë në kundërshtim me veten e tij si të vetëmen njollë, *për të përqëndruar kundër tij të gjitha forcat e çkatërrimit*» (Kursivi është i yni). «Dhe kur revolucjoni do të mbarojë këtë gjysmë të dytë të punës së tij përgatitëse, atëhere Evropa do të ngrihet më këmbë e do të thotë me trijumf: «ti rrëmon mirë, plak uriq!»
>
> «Ky pushtet ekzekutif me organizatën e tij kolosale burokratike dhe ushtarake, me maqinën e tij të shtetit shumë të komplikuar dhe artificjale, me këtë ushtëri funkcjonarësh prej një gjysëm miljon njerzish krahas me ushtërinë, edhe ajo prej gjysmë miljonë vetash, ky organizmë i tmerrshëm parasit, që mbulon si me një rrjetë gjithë trupin e shoqërisë franceze duke mbyllur gjithë poret e tij, lindi në epokën e monarkisë absolute, në epokën e dekadencës së feudalizmit, dekadencë, që ky organizëm e ka ndihmuar të rrukulliset». Revolucjoni i parë francez çvilloji centralizimin, «po njëkohësisht shtoji volumin, atributet dhe numrin e sherbëtorëve të pushtetit qeveritar. Napoleoni e përsosi këtë maqinë të shtetit». Monarkija

legjltime dhe monarkija e qershorit «nukë shtuan asgjësendi, përveç një ndarjeje më të madhe të putës». ...

...«Më në fund, republika parlamentare në luftën e saj kundër revolucjonit u shtrëngua të forcojë, bashkë me masat e represjonit, mjetet dhe centralizimin e pushtetit qeveritar. *Të gjitha revolucjonet e kanë përsosur këtë maqinë në vënt që ta thyejnë»* (Kursivi ësntë i yni). Partitë, që njëra pas tjetrës lëftonin për sundim, e konsideronin marrjen e kësaj ndërtese kolosale të shtetit si prenë kryesore të fitores së tyre» (18 Brumeri i Ludovik Bonapartit, f. 98-99, bot 4, Hamburg, 1907).

Në këtë arsyetim të shënuar marksizmi bën një çap kolosal përpara në krahasim me «Manifestin Komunist». Atje problemi i shtetit shtrohet akoma në mënyrë shumë abstrakte, në nocjone dhe terme shumë të përgjithëshme. Këtu çështja shtrohet në mënyrë konkrete, dhe përfundimi është jashtëzakonisht i prerë, i caktuar, praktikisht i prekshëm: të gjitha revolucjonet e mëparëshme e kanë përsosur maqinën e shtetit, kurse ajo duhet thyer, duhet çkatërruar.

Ky përfundim është gjëja kryesore, themelore në doktrinën e marksizmit mi shtetin. Dhe pikërisht kjo gjë themelore jo vetëm është *harruar* fare nga partitë socjal-demokrate zyrtare sundonjëse, po është drejt për drejt *falsifikuar* (si do ta shohim më poshtë) nga teoretiku më i përmëndur i Internacjonales së Dytë, nga K. Kautski.

Në «Manifestin Komunist» kemi bilanin e përgjithshëm të historisë, që na detyron ta konsiderojmë shtetin si një organ të sundimit të klasave dhe që na jep konkluzjonin e domosdoshmë se proletarjati nukë munt të përmbysë borgezinë pa marrë në dorë më përpara pushtetin politik, pa fituar sundimin politik, pa e kthyer shtetin në «proletarjat të organizuar si klasë sundonjëse»; ky shtet proletar menjëherë pas fitores së tij fillon të shuhet, pse në

shoqërinë pa antagonizma klasash shteti nukë duhet dhe ësht i pamundshëm. Këtu shtrohet problemi: si duhet të jetë — nga pikëpamja e çvillimit historik — ky zëvëndësim i shtetit borges me shtetin proletar?

Pikërisht këtë problem shtron edhe zgjith Marksi më 1852. Besnik kundrejt filozofisë së tij, materjalizmit djalektik, Marksi merr si bazë eksperjencën historike të vjeteve të mbëdha të revolucjonit, vjetet 1848-1851. Doktrina e Marksit edhe këtu, si kurdoherë, është *një përmbledhje eksperjencës*, e ndriçuar nga një botëkupëtim i thellë filozofik dhe nga një dituri e pasur e historisë.

Problemi i shtetit shtrohet në mënyrë konkrete. Si lindi historikisht shteti borges, maqina e shtetit, e domosdoshme për sundimin e borgezisë? Cilat janë ndryshimet e saja, evolucjoni i saj gjatë revolucjoneve borgeze dhe përpara lëvizjeve të pavarura të klasave të shtypura? Cilat janë detyrat e proletarjatit kundrejt kësaj maqine të shtetit?

Pushteti i centralizuar i shtetit, që është karakteristik për shoqërinë borgeze, lindi në epokën e rënjes së absolutizmit. Dy institucjone janë institucjonet më karakteristike të kësaj maqine shteti: burokracija dhe ushtërija permanente. Marksi dhe Engelsi flasin shumë herë në veprat e tyre se si këto institucjone janë lidhur me mijra fije pikërisht me borgezinë. Eksperjenca e çdo punëtori e tregon këtë lidhje në mënyrë jashtëzakonisht të dukëshme dhe sugjestive. Klasa punëtore mëson ta njohë këtë lidhje në kurrizin e saj, — ja përse ajo e kupëton kaqë lehtë dhe e përvetëson kaqë mirë shkencën mi karakterin e paevituarshëm të kësaj lidhjeje, atë shkencë, që demokratët mikroborgezë ose e mohojnë nga injoranca dhe mëdjelehtësija, ose e pranojnë «përgjithërisht» me një mendjelehtësi edhe më të madhe, po harrojnë të nxjerrin konkluzjonet e duhura praktike.

Burokracija dhe ushtërija permanente — janë një «parazit» në trupin e shoqërisë borgeze, një parazit, që është pjella e antogonizmave të brëndëshme, që grryejnë këtë shoqëri, po pikërisht një parazit, «që mbyll» poret e jetës. Oportunizmi kautskjan, që sundon tani në socjal-demokracinë zyrtare, pikëpamjen mi shtetin si një organizëm parazitar, e quan si një atribut ekskluzif të anarkizmit. Natyrisht, ky falsifikim i marksizmit u jep dorë shumë filistinëve, që e kanë shpurë socjalizmin në një turp pa shëmbëll: te justifikimi dhe zbukurimi i luftës imperjaliste me idenë e «mprojtjes së atdheut». Po është gjithënjë një falsifikim i pamohuarshëm

Ky aparat burokratik dhe ushtarak çvillohet, përsoset forcohet nëpër të gjitha revolucionet borgeze, që Evropa i ka parë me shumicë që nga koha e rënjes së feudalizmit. Vëçanërisht, pikërisht borgezija e vogël shkon pas borgezisë së madhe dhe i nënështrohet asaj në një shkallë të gjërë me anë të këtij aparati, që u jep shtresave të larta të katundarisë, zanatçinjve të vegjël, tregëtarëve të vegjël e të tjerëve vënde relativisht të mira, të qeta dhe të ndëruara, që i vënë ata që kanë këto vënde *përmi* popullin. Të marrim atë që ndodhi në Rusi në një gjysmë viti pas 27 shkurtit 1917: nëpunësitë, që më parë ua epnin me preferencë qindsheve të zeza, tani u bënë preja e kadetëve, menshevikëve dhe eserëve. Nukë mendonin aspak për reforma serjoze, duke u përpjekur t'i shtyjnë "gjer në Asamblenë Kushtetonjëse" — dhe Asamblenë Kushtetonjëse pak' e nga pakë gjer në fund të luftës! Për të ndarë prenë, për të zënë postet si ministra, ndihmës-ministra, gjeneral-guvernatorë e të tjera e të tjera, ata nukë humbën kohë dhe nukë pritnë asnjë Asamble Kushtetonjëse! Lodra e kombinacjoneve mi përbërjen e qeverisë ishte në realitet vetëm një shprehje e kësaj ndarjeje dhe rindar-

je e «të presë», që bëhesh sipër dhe posnjë në të gjithë vëndin, në të gjithë administratën qëndrore dhe lokale. Kemi këtu një bilan të sigurt, një bilan objektiv të një gjysmë viti, 27 shkurt — 27 gusht 1917: reformat u shtynë, ndarja e nëpunësive u bë, dhe "gabinet" e ndarjes u ndreqnë me disa rindarje.

Po sa më tepër bëhen "rindarje" të aparatit administrativ në mes të partive të ndryshme borgeze dhe mikroborgeze (në mes të kadetëve, eserëve dhe menshevikëve, po të marrim shëmbëllën ruse), aqë më tepër bëhet e qarte për klasat e shtypura, dhe për proletarjatin që është në krye të tyre, armiqësija e tyre e papajtuarshme kundrejt *gjithë* shoqërisë borgeze. Këtej lint nevoja për të gjitha partitë borgeze dhe për partitë më demokratike dhe "demokratike-revolucjonare", për të shtuar masat shtypëse kundër proletarjatit revolucjonar, për të forcuar aparatin e shtypjes, d.m.th maqinën e shtetit. Një rjedhje e tillë e ngjarjeve e detyron revolucjonin *«që të përqëndrojë të gjitha forcat e shkatërrimit»* kundër pushtetit të shtetit, e shtërngon të ketë si detyrë jo përmirësimin e maqinës së shtetit, po *çkatërrimin, çdukjen e* saj.

Problemi u shtrua kështu jo në bazë arsyetimesh logjike, po në bazë të çvillimit real të ngjarjeve, në bazë të eksperjencës së gjallë të vjeteve 1848-1851. Gjer më ç'pikë Marksi pështetet mi bazën reale të eksperjencës historike, duket nga fakti që ay më 1852 nuk e shtron akoma në mënyrë konkrete problemin: *me se* duhet zëvëndësuar kjo maqinë shteti, që duhet çdukur? Eksperjenca nukë kishi dhënë akoma materjale për një problem të tillë, që historija e vuri në rendin e ditës më von, më 1871. Më 1852 vetëm mund të konstatohesh me precizjonin e shkencave të natyrës se revolucjoni proletar *arriu* te detyra" për të përqëndruar të gjitha forcat e çkatërrimit" kundër pushte-

tit të shtetit, te detyra "për të çkatërruar" maqinën e shtetit[1].

Këtu munt të lint pyetja: a është i drejtë përgjithësimi i eksperjencës, i vërejtjeve dhe i përfundimeve të Marksit, aplikimi i tyre në një shkallë më të gjërë se ç'është historija e Francës në tri vjet, në vjetet 1848-1851? Për të analizuar këtë problem do të përmëndim më parë një vërejtje të Engelsit, dhe pastaj të studjojmë faktet.

> .."Franca — shkruante Engelsi në parathënjen për botimin e 3-të të "18 Brumerit" — Është vëndi ku luftën historike të klasëve e kanë shpurë gjithënjë më tepër se në vëndet e tjerá, gjer në funt. Në Francë duallën me tepáret më të prehta format e ndryshme politike, brënda të cilëve është çvilluar kjo luftë e klasëve dhe në të cilat janë shprehur rezultatet e saje. Qendër e feudalizmit në kohën e mesme, vënt shëmbull i monarkisë me rënde dhe uniformeqë nga koha e Rilindjes, Franca çkatërroji feudalizmin në kohën e Revolucionit të math dhe themeloi sundimin e kulluar të borgezisë me një qartësi klasike, që nuke ka shëmbëll as me një vënt tjetër evropjan. Dhe luf.a e proletarjatit, që po ritet, kundër borgezisë sundonjë-e çaqet këtu në një formë të ashpër, që nuk njihet në vëndet e tjera. (faqe 4 e bot. të v, 1907).

Vërejtja e fundit është vjetëruar, pse që nga v. 1871 kemi një ndërprerje në luftën revolucjonare të proletarjatit francez, ndonëse kjo ndërprerje, sa do e gjatë që të jetë, nuk përjashton aspakë mundësinë që në revolucjonin proletar, që po afrohet, Franca të tregohet si vëndi klasik i luftës së klasave, i një lufte të vendosur gjer në funt.

Po le të hedhim një sy të përgjithëshëm mi historinë e vëndeve të përparuara në funt të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Ne do të shohim se, më me ngadalë, me forma më të ndryshme, në një fushë më të gjërë po bëhet po ay proces: nga një anë kemi krijo-

min e «pushtetit parlamentar», si në vëndet republikane (Francë, Amerikë, Svicër), ashtu edhe në vëndet monarkike (Angli, Gjermani gjer në një farë pike, Itali, vëndet skandinavë etj.) nga ana tjetër, kemi luftën për pushtet të partive të ndryshme borgeze dhe mikroborgeze, që ndajnë dhe rindajnë "plaçkën", d. m. th. ofiqet e majme pa ndryshuar aspakë themelet e regjimit borges; më në fund kemi përsosjen dhe përforcimin e «pushtetit egzekutif, e aparatit të tij burokratik dhe ushtarak.

Nukë ka asnjë dyshim se këto janë tiparet e përbashkëta të gjithë revolucjonit modern të shteteve kapitaliste përgjithërisht. Në tre vjet e sipër, 1848-1851, Franca në një formë të shpejtë, të ashpër, të përqëndruar, tregoi po ato procese çvillimi, që janë karakteristike për gjithë botën kapitaliste.

Po veçanërisht imperjalizmi, epoka e kapitalit bankar, epoka e monopoleve vigane kapitaliste, epoka e transformimit të kapitalizmit monopolist në kapitalizëm monopolist të shtetit tregon se si forcohet në mënyrë të jashtëzakonëshme «maqina e shtetit», se si rritet pa masë aparati i tij burokratik dhe ushtarak në lidhje me forcimin e masave shtypëse kundër proletarjatit, si në vëndet monarkike, ashtu edhe në vëndet më të lira, në vëndet republikane.

Historija universale shpije tani, pa dyshim, në një shkallë pa krahasim më të gjërë se më 1852, në «përqëndrimin e të gjithë forcave» të revolucjonit proletar për «të çkatërruar» maqinën e shtetit.

Me se do të zëvëndësojë proletarjati këtë maqinë? Mi këtë gjë Komuna e Parizit na dha një materjal shumë instruktif.

3. *Si e shtronte Marksi problemin më 1852* *

Më 1907 Mehring-u botonte në «Neue Zeit» [7]) (XXV. 2,164) copëra nga një letër e Marksit drejtuar Weydemeyerit me datë 5 mars 1852. Në këtë letër gjëndet, në mes të tjerave, ky arësvetim i shënuar:

> «Për sa me takon mua, unë nukë kam as meritën e zbulimit të egzistencës së klasëve në shoqërin moderne, as meritën e zbulimit të luftës në mes të tyre. Shumë kohë përpara meje historjanët borgezë e kanë paraqitur çvillimin historik të kësaj lufte të klasëve, dhe ekonomistët borgezë — anatominë ekonomike të klasëve. Gjëja e re që kam bërë unë, është që kam provuar këte: 1) që egzistenca e klasëve është lidhur vetëm me disa beteja historike të caktuara, që janë karakteristike për çvillimin e prodhimit (historische Entwickelungskämpf der Produktion); 2) se lufta e klasëve shpije në mënyrë të domosdoshme në diktaturën e proletarjatit, 3) se vetë kjo diktaturë përbën vetëm një kapërxim në çdukjen e të gjitha klasave dhe në shoqërinë pa klasë»...

Me këtë fjalë Marksi ka shprehur në një mënyrë çuditërisht të dukëshme, e para, ndryshimin kryesor dhe rrënjësor të doktrinës së tij nga doktrina e mendimtarëve të përparuar dhe më të thellë të borgezisë, dhe, e dyta, esencën e doktrinës së tij mi shtetin.

Gjëja kryesore në doktrinën e Marksit është lufta e klasave. Kështu thonë dhe shkruajnë shumë shpesh. Po kjo nuk është e vërtetë. Dhe nga ky gabim shpesh rjeth një shtrëmbërim oportunist i marksizmit, një falsifikim i tij për ta bërë të pranuarshëm për borgezinë. Pse doktrina e luftës së klasave *nuk* është krijuar nga Marksi, po nga borgezija *përpara* Marksit dhe, përgjithërisht, për borge-

---

* I është shtuar botimit të dytë të vitit 1919. Red.

zinë ësht e *pranuarshme*. Kush pranon *vetëm* luftën e klasave, ay nuk ësht akoma një marksist, ay munt të mos dalë akoma jashtë kuadrit të mendimit borges dhe të politikës borgeze. Ta kufizosh marksizmin me doktrinën e luftës së klasave — do të thotë ta gjymtosh marksizmin, ta shtrëmbërosh, ta thjeshtosh në atë, që ësht e pranuarshme për borgezinë. Marksist është vetëm ay, që e *shtrin* pranimin e luftës së klasave gjer në pranimin e *diktaturës së proletarjatit*. Këtu është ndryshimi më i thellë i marksistit nga një borges i vogël (dhe i math) i zakonshëm. Me këtë gur prove duhet të provohet kupëtimi i *vërtetë* dhe pranimi i marksizmit. Dhe nuk është për t'u çuditur se, kur historija e Evropës e shpuri klasën punëtore *praktikisht* përpara këtij problemi, jo vetëm gjithë oportunistët dhe reformistët, po dhe gjithë «kautskjanët» (njerës që lëkunden në mes të reformizmit dhe të marksizmit) u treguan filistinë të mjerë dhe demokratë mikroborgezë, *që mohojnë* diktaturën e proletarjatit. Broshura e Kautski-t «Diktatura e proletarjatit» që dolli të gusht të v. 1918, d. m. th. shumë më von se botimi i parë i këtij libri, është një model shtrëmbërimi mikroborges të marksizmit dhe të mohimit të poshter të marksizmit *në fakt*, duke e pranuar *me fjalë* (shiko broshurën time: «Revolucjoni proletar dhe renegati Kautski», Petrograd dhe Moskë 1918 *).

Oportunizmit të kohës së sotme në personin e përfaqësonjësit të tij kryesor, të ish-marksistit K. Kautski, i përshtatet plotërisht karakteristika e pozitës *borgeze*, siç është të Marksi, pse ky oportunizëm e kufizon sferën e pranimit të luftës së klasave me sferën e raporteve borgeze. (Dhe brënda këtyre kufive, në kuadrin e këtyre ra-

---

* Shiko vol. XXIII të Veprave. Red.

porteve as edhe një liberal i mësuar nukë refuzon të pra nojë «në parim» luftën e klasave!) Oportunizmi *nuk e shpije* pranimin e luftës së klasave pikërisht gjer në çës- tjen më kryesore, gjer në periodën e kapërximit nga kapitali- mi në komunizëm, gjer në periodën *e përmbysjes* së bor- gjisë dhe të çdukjes së plotë të saj. Në realitet kjo pe- riodë është me domosdo një periodë me një luftë klasash pa shëmbëll të rreptë, me forma të ashpra pa shëmbëll, dhe prandaj edhe shteti i kësaj periode duhet të jetë në mënyrë të paevituarshme një shtet demokratik *në mënyrë të re* (për proletarët dhe skamësit përgjithërisht) dhe një shtet diktatorjal *në mënyrë të re* (kundër borgjisë).

Pastaj. Esencën e doktrinës së Marksit mi shtetin e ka përvetësuar vetëm ay, që ka kuptuar se diktatura e *një* klase është e domosdoshme për çdo shoqëri me klasa për- gjithërisht, jo vetëm për *proletarjatin*, që ka përmby:ur borgjinë, po edhe për një *periodë historike* të tërë, që ndan kapitalizmin nga «shoqërija pa klasa», nga komu- nizmi. Format e shteteve borgjeze janë jashtëzakonisht të- ndryshme, po esenca e tyre është një: të gjitha këto shtete janë në një mënyrë ose në një tjetër, në analizë të fun it, me domosdo një *diktaturë e borgjisë*. Natyrisht, ka- përximi nga kapitalizmi në komunizëm nukë munt të mos- na japë një shumicë të madhe dhe një varjetet të math formash politike, po esenca e tyre do të jetë në mënyrë të paevituarshme një: *diktatura e proletarjatit*.

KAPITULLI III.

SHTETI DHE REVOLUCJONI. EKSPERJENCA E KOMUNËS SË PARIZIT TË 1871-së. ANALIZA E MARKSIT

1. *Ku qindron heroizmi i orvajtjes së komunarëve?*

Dihet se disa muaj përpara Komunës, në vjeshtë të v. 1870, Marksi paralajmëronte punëtorët e Parizit duke u provuar se një orvajtje për të përmbysur qeverinë do të ishte një budallallëk dëshpërimi. Po kur në mars të v. 1871 punëtorëve *u propozua* një betejë decizive dhe ata e pranuan, kur kryengritja u bë një fakt, Marksi e përshëndeti me entuzjazmin më të math revolucjonin proletar, me gjithë se shënjat ishin të këqija. Marksi nukë nguli këmbë ta dënojë në mënyrë pedanti këtë lëvizje si te parakohëshme, si bëri famëkeqi renegat rus i marksizmit, Plehanovi, që në nëntor të v. 1905 kishte shkruar duke nxitur luftën e punëtorëve dhe të katundarëve, po që pas dhjetorit 1905 çiresh si një liberal i keq duke thirur: «nukë duneshin rrokur armët» Po Marksf nuk admiroi vetëm heroizmën e komunarëve, të cilët, sipas shprehjes së tij, «sulmonin qiellin». Në këtë lëvizje revolucjonare masash, edhe pse nukë ja arrinte qëllimit, ay shihte një eksperjencë historike me rëndësi kolosale, një farë përparimi në revolucjonin proletar botnor, një çap praktik, më me rëndësi se qindra programe dhe arësyetime Të analizonte

këtë eksperjencë, të nxirrte prej saj mësime taktike, të rishikonte në bazë të saj teorinë e tij — ja detyra që i vuri vetes Marksi.

I vetëmi «korigjim», që Marksi e quajti të domosdoshëm t' i bënte «Manifestit Komunist» u bë prej tij në bazë të eksperjencës revolucjonare të komunarëve të Parizit.

Parathënja e fundit për botimin e ri gjermanisht të «Manifestit Komunist», që është nënëshkruar nga të dy autorët, ka datën 24 qërshor 1871. Në këtë parathënje autorët, Karl Marks dhe Friedrich Engels, thonë se programi i «Manifestit Komunist» «tani vënde-vënde është vjetëruar»:

> ... .«Veçanërisht — vazhdojnë ata — Komuna provoji se "klasa punëtore nukë munt të marrë në dorë maqinën e shtetit ashtu siç e ka gjetur gati dhe ta vërë në lëvizje për qëllimet e saja.,..."

Fjalët e këtij citati, që kanë thonjëza të dyta, autorët i kanë marrë nga vepra e Marksit: «Lufta civile në Francë».

Kështu, këtë mësim themelor dhe kryesor të Komunës së Parizit Marksi dhe Engelsi e konsideronin të një rëndësije kaqë të madhe, sa që ata e futnë, si një korigjim esencjal, në «Manifestin Komunist».

Është një gjë shumë karakteristike që pikërisht ky korigjim esencjal u shtrëmbërua prej oportunistëve, dhe kupëtimin e tij, sigurisht, nuk e njohin nëntë të dhjetat, në mos nëntëdhjetë e nëntë për qint të këndonjësve të «Manifestit Komunist». Mi këtë shtrëmbërim ne do të flasim më hollësisht më poshtë, në kapitullin, që ü kusntojmë në mënyrë të veçantë shtrëmbërimeve. Tani mjafton të themi se «kupëtimi» i zakonshëm, vulgar i formulës

së famëshme të Marksit, që përmendëm, është, që gjoja këtu Marksi theksoka idenë e çvillimit të ngadalshëm në kundërshtim me marrjen në dorë të pushtetit e të tjera si këto. Në të vërtetë *është pikërisht e kundërta.* Ideja e Marksit është, që klasa punëtore duhet *ta thyejë, ta çkatërrojë* «maqinën e shtetit, ashtu siç e ka gjetur gati», dhe jo të kufizohet vetëm me marrjen e saj në dorë.

Më 12 prill 1871, d. m. th. pikërisht në kohën e Komunës, Marksi i shkruante Kugelmann-it:

> .....«Po të hedhësh një sy në kapitullin e fundit të «18 Brumerit» tim, do të vëhohish se unë çpall si orvatje të dytë të revolucjonit frances: që ky të mos ta hedhë maqinën burokratike-ushtarake nga një dorë në një tjetër, siç ka ndodhur gjer më sot, po ta *çkatërrojë*» (kursivi është i Marksit; në original ka *zerbrechen*), dhe pikërisht kjo është kondita paraprake e çdo revolucjoni me të vërtetë popullor në kontinent. Pikërisht këtu qëndron orvatja shokëve tanë heroikë të Parizit» (f. 709 në «Neue Zeit», XX,I, 1901-1902). Letrat e Marksit per Kugelmann-in kanë qenë gati gjithnjë jo me pakë se në dy botime, njëri prej të cilëve nën redaksinë time dhe me një parathenje nga ana ime *).

Në këto fjalë: «ta çkatërrojnë maqinën burokratike-ushtarake të shtetit» përmblidhet shkurt mësimi kryesor i marksizmit mi detyrat e proletarjatit në revolucjon kundrejt shtetit. Dhe pikërisht ky mësim është jo vetëm harruar fare, po edhe shtrëmbëruar drejt për drejt nga «interpretimi» sundonjës, kautskjan i marksizmit!

Për sa i takon pasazhit të Marksit nga «18 Brumeri», ne e suallëm më sipër të tërë.

Ësht intersante të përmëndim në mënyrë të veçantë dy pika të këtij pasazhi të Marksit. E para, ay e kufizon

*) Shif vol. X-të Veprave, f. 361. Red.

konkluzjonin e tij me kontinentin. Kjo kupëtohesh më 1871, kur Anglija ishte akoma modeli i një vëndi kapitalist të kulluar, po pa militarizëm dhe në një shkallë të gjërë pa burokraci. Prandaj Marksi e përjashtonte Anglinë, ku një revolucjon, bile edhe një revolucion popullor, dukesh dhe ishte atëhere e mundëshme pa pasur si konditë parapra-ke çkatërrimin e «maqinës së shtetit ashtu siç ishte gati».

Tani, më 1917, në epokën e luftës së parë imperjaliste, ky kufizim i Marksit bije. Si Anglija, ashtu dhe Amerika, përfaqësonjësit më të mbëdhenj dhe të fundit në botë të «lirisë» anglo-saksone, në kupëtimin e mungesës së militarizmit dhe të burokracisë, kanë rënë funt e krye në kënetën e ndyrë dhe të përgjakëshme të institucjoneve burokratike-ushtarake të gjithë Evropës, që nënështrojnë dhe shtypin çdo gjë. Tani si në Angli, ashtu dhe në Amerikë «kondita paraprake e çdo revolucjoni me të vërtet popullor» është të *çkallmuarit, të çkatërruarit* e "maqinës së shtetit të gjetur gati", e cila më 1914-1917 u përsos atje në shkallë "evropjane", në shkallë të përgjithëshme imperjaliste.

E dyta, meriton një vëmëndje të veçantë vrejtja jashtëzakonisht e thellë e Marksit që çkatërrimi i maqinës burokratike-ushtarake të shtetit është "një konditë paraprake për çdo revolucjon me të vërtet *popullor*". Kjo ide e revolucjonit "popullor" duket si e çuditëshme në gojën e Markslt, dhe plehanovistët dhe menshevikët rusë, këta partizanë të Struves, që duan të jenë marksistë, ndofta do ta konsideronin këtë shprehje të Marksit si një të "shkarë goje". Ata e kanë shpurë marksizmin në një shtrëmbërim liberal kaqë të vartër, sa që përveç antitezës në mes të revolucjonit borges dhe revolucjonit proletar për ata nuk egziston asgjë tjetër; po edhe këtë antitezë ata e kupëtojnë në mënyrë sa s'bëhet skelastike.

Po të marrim si shëmbëll revolucjonet e shekullit të XX, atëhere natyrisht edhe revolucjonin portuges edhe revolucjonin turk, duhet t' i konsiderojmë si revolucjone borgeze. Po as njëra, as tjetra nuk është një revolucjon "popullor", pse as në njerën as në tjetrën masa e popullit, shumica e madhe e tij nukë dalin në skenë në mënyrë aktive, të pavarur, me kërkesa të tyre ekonomike dhe politike. Perkundrazi, revolucjoni borges rus i vv. 1905-1907, ndonëse në këtë revolucjon nukë ka pasur suksese kaqë të "shkëlqyera", siç kanë pasur nga një herë revolucjoni portuges dhe revolucjoni turk, po ay ka qënë, pa dyshim, një revolucjon "me të vërtet popullor", pse masa e popullit, shumica e tij, shtresat më të thella shoqërore të "vegjëlisë", të shtypura nga zgjedha dhe nga çfrytëzimi, u ngritnë vetë, i vunë gjithë rjedhjes së revolucjonit vulën e kërkesave *të tyre*, e përpjekjeve *të tyre* për të ngritur një shoqëri të re në mënyrë të tyre, në vënt të shoqërisë së vjetër, që po çkallmonin.

Në kontinentin evropjan më 1871 proletarjati nuk përbënte shumicën e popullit as në një vënt. Revolucjoni «popullor», që fut në lëvizje me të vërtet shumicën, munt të ishte i tillë vetëm duke përmbledhur proletarjatin edhe katundarinë. Këto dy klasa përbënin atëhere "popullin". Të dyja këto klasa janë të bashkuara nga fakti që "maqina burokratike-ushtarake e shtetit" i mban nënë zgjedhë, i shtyp, i çfrytëzon. *Të thyesh* këtë maqinë, të *çkatërrosh* këtë maqinë — ky është interesi i vërtetë i "popullit", i shumicës së tij, i punëtorëve dhe i shumicës së katundarëve, kjo është "kondita paraprake" e aleancës së lirë të katundarëve të varfër me proletarët. Pa këtë aleancë demokracija nuk ësht e sigurdoshë dhe transformacjoni socjalist nukë munt të bëhet.

Siç dihet, Komuna e Parizit u përpoq të çante rrugën

për një aleancë të tillë, po nuk ia arriti qëllimit për një sërë shkaqesh me karakter të brëndshëm dhe të jashtëm.

Pra, duke folur për «revolucjonin me të vërtet popullor», pa harruar aspakë veçoritë e borgezisë së vogël (për ato ay ka folur shumë dhe shpesh), Marksi mirrte parasysh në mënyrë fare rigoroze raportin real të klasave në shumicën e shteteve kontinentale të Evropës së v. 1871. Nga ana tjetër, ay konstatonte se «çkatërrimi» i maqinës së shtetit është i nevojshëm n' interesë të punëtorëve dhe të katundarëve, se kjo i bashkon ata, i vë përpara një detyre të përbashkët: çdukja e «parazitit» dhe zëvëndësimi i tij me një gjë të re.

Me se pikërisht?

2. *Me se duhet zëvëndësuar maqina e shtetit që është thyer?*

Kësaj pyetje më 1847, në «Manifestin Komunist», Marksi i jipte atëhere një përgjigje fare abstrakte ose më mirë, tregonte detyrat, po jo mënyrat e zgjidhjes së tyre. Duhet zëvëndësuar «me organizimin e proletarjatit si klasë sundonjëse», «me fitimin e demokracisë» — kjo ishte përgjigja e «Manifestit Komunist».

Pa u hedhur në utopi, Marksi priste nga *eksperjenca* e lëvizjes së masave përgjigjen e pyetjes: në ç'forma konkrete do të shprehet ky organizim i proletarjatit si klasë sundonjëse? Në ç' mënyrë pikërisht ky organizim do të pajtohet me «demokracinë» të fituar me luftë më të plotë dhe më konsekuente?

Eksperjencën e Komunës, sa do e vogël që ish, po Marksi e analizon me vëmëndje shumë të madhe në "Luftën civile në Francë". Po bijem pasazhet kryesore të kësaj vepre:

> Në shek. XIX u çvillua «pushteti shtetëror i centralizuar' me organet e tija që gjindeshin kudo, me ush ërinë permanente, policinë, burokracinë, klerin, giykatësit;» push et shtetëror që e kishte or gjinën në kohën e mesme. Me çvillimin e antagonizmit të klasave në mes të kapitalit dhe të punës «pushteti shtetëror mori gjithënjë me tepër karakterin e një force publike për të shtypur punën, mori karakterin e një maqine të sundimit së klasave. Pas çdo revolucjoni, që shënon një çap përpara në luftën e klasave, karakteri i thjesht shtypës i pushtetit shtetëror duket sheshit gjithënjë më tepër». Pushteti shtetëror pas revolucjonit të v.v. 1848-1849 bëhet «një vegël nacjonale lufte e kapitalit kundër punës». Perandorija e dytë [9]) e konsolidon këtë gjë.
>
> «Komuna ka qënë e kundërta dijametrale e perandorisë». «Ajo ka qënë një formë e caktuar» «e një republikë, që duhesh të çdukte jo vetëm formën monarkike të sundimit të klasave, po dhe vetë sundimin e klasëve».

Ç'ishte pikërisht kjo formë «e caktuar» e republikës proletare-socjaliste? Ç'farë shteti ishte ay, që kjo filloi të krijonte?

> .....«Dekreti i parë i Komunës ka qënë çdukja e ushtërisë permanente dhe zëvëndësimi i saj me populin e armatosur».....

Kjo kërkesë është tani në programet e të gjitha partive, që dëshërojnë ta quajnë veten socjalistë. Po se sa u bën lëkura këtyre programeve, duket më mirë se kudo në sjelljen e eserëve dhe të menshevikëve tanë, që në fakt

hoqnë dorë, pikërisht pas revolucjonit të 27 shkurtit, nga realizimi i kësaj kërkese!

... «Komuna u formua nga anëtarë të këshillës së qytetit të zgjedhur në bazë të së drejtës së përgjithëshme të votës në rrethet e ndryshme të Parizit. Ata ishin të përgjegjshëm dhe munt të hiqeshin në çdo moment. Shumica e tyre përbëhesh, kupëtohet vetvehu, rga punëtorë ose rga përfaqësonjes të njohu i të klasës punëtore»....

.... «Policisë, që kish qëne gjer atëhere një vegël e qeverisë qendrore, iu hoqën menjëherë të gjitha funkcionet e saja politike dhe ajo u bë një organ i përgjegjshëm i Komunës, që mund të hiqeshë në çdo moment . . . . . Gjithashtu dhe funkcjonarët e të gjitha degëve të tjera të administratës... Duke filluar nga anëtarët e Komunës, shërbimi publik, funt e krye, duhesh të kryhesh me *mëditje punëtori*. Të gjitha privilegjet dhe shpërblimet e përfaqësisë për ofiqet e larta të shtetit u çduknë bashkë me këto ofiqe.... Me çdukjen e ushtërisë permanente dhe të policisë, të këtyre veglave të pushtetit materjal të qeverisë së vjetër, Komuna ju përvesh punës për të thver veglën e zgjedhës spiritualet, fuqinë e prittërinjve... Gjykatësit humbën pavarësinë e tyre që ish vetëm në dukje... Ata paskëtaj duhesh të zgjidheshin hapta*, duhesh të ishin të përgjegjshëm dhe të munt të hiqeshin»....

Kështu, maqinën e thyer të shtetit Komuna sikur e zëvëndësoi «vetëm» me një demokraci më të plotë: çdukja e ushtërisë permanente, të zgjedhurit dhe të hequrit e të gjithë funkcjonarëve. Po në të vërtetë ky «vetëm» do të thotë një zëvëndësim kolosal të një palë institucjonesh me institucjone të tjera, të ndryshme në parim. Këtu pikërisht kemi një nga rastet e «transformimit të sasisë në cilësi»: demokracija e realizuar në mënyrën më të plotë dhe më konsekuente, që mund të imagjinohet përgjithërisht, transformohet nga demokraci borgeze në demokraci proletare, nga shtet (forcë e veçantë për të shtypur një klasë të

caktuar) në një gjë, që nuk është më shtet në kupëtimin e vërtetë.

Ësht akoma e domosdoshme që të shtypet borgezija dhe rezistenca e saj. Për Komunën kjo ishte një gjë veçanërisht e domosdoshme, dhe një nga shkaqet e disfatës së saj është që ajo nuk e bëri këtë gjë me vendosjen e duhur. Po këtu si organ shtypës kemi tani shumicën e popullsisë dhe jo pakicën, siç ka qënë kurdoherë dhe në regjimin e skllavërisë, dhe në regjimin feudal, dhe në regjimin e skllavërisë me mëditje. Dhe me qënë se shumica e popullit i shtyp *vetë* shtypësit e saj, prandaj këtu *nukë ka më nëvojë* për «një forcë të veçantë» shtypje! Në këtë kupëtim shteti *fillon të shuhet*. Në vënt të institucjoneve të veçanta të pakicës së privilegjuar (funkcjonarë të privilegjuar, krerët e ushtërisë përmanente), vetë shumica munt ta kryej këtë drejt për drejt, dhe sa më tepër populli do të marrë pjesë në kryerjen e funkcjoneve të pushtetit shtetëror, aqë më pakë do të ketë nevojë për këtë pushtet.

Nga kjo pikëpamje është për t'u shënuar një masë e Komunës, që Marksi ve në dukje: heqja e të gjitha çpërblimeve për përfaqësi, e të gjitha privilegjeve financjare për funkcjonarët, zbritja e rrogës për të *gjithë* funkcjonarët gjer në nivelin e «mëditjes së punëtorit». Këtu pikërisht duket më mirë se kudo *kthesa* nga demokracija borgeze në demokracinë proletare, nga demokracija shtypëse në demokracinë e klasëve të shtypura, nga shteti si «forcë e veçantë» për të shtypur një klasë të caktuar, në shtypjen e shtypësve *me forcën e përgjithëshme* të shumicës së popullit, të punëtorëve dhe të fshatarëve. Dhe pikërisht në këtë pikë veçanërisht të qartë — mi çështjen e shtetit ndofta pika më me rëndësi — janë harruar më tepër mësimet e Marksit! Në komentarët popullore — ato nukë nëmërohen dot — nukë flasin për këtë gjë. «Është zakon»

të mos flitet për këtë gjë, si për një «naivitet», që e ka bërë kohën e tij, ashtu sikundër të krishterët, kur fituan pozitën e një feje zyrtare, «harruan» «naivitetet» e krishterimit të lashtë me frymën e tij demokratik-revolucjonar.

Zbritja e rrogës për funkcjonarët e lartë të shtetit duket «vetëm» si një kërkesë e demokracisë naive, primitive. Një nga «themelonjësit» e oportunizmit të kohës së sotme, ish socjal-demokrati Ed. Bernstein, kushedi sa herë i ka përsëritur qesëndítë banale borgeze për demokratizmin «primitif». Si të gjithë oportunistët, si edhe kautskjanët e sotmë, ay nukë ka kupëtuar fare se «e para, kapërximi nga kapitalizmi në socjalizëm *nuk munt të bëhet* pa një farë «rikthimi» në demokratizmin «primitif» (pse ndryshe si munt të bëhet kapërximi në kryerjen e funkcjoneve të shtetit nga shumica e popullsisë dhe nga gjithë popullsija funt e krye?), dhe e dyta, që «demokratizmi primitif» në bazë të kapitalizmit dhe të kulturës kapitaliste nuk është njësoj me demokratizmin primitif të kohëve primitive ose të kohës parakapitaliste. Kultura kapitaliste *krijoi* prodhimin e math, fabrikat, udhët e hekurta, postën, telefonet etj., dhe *në këtë bazë* shumica e madhe e funkcjoneve të «pushtetit» të vjetër «shtetëror» u thjeshtësua aqë lepër dhe ndofta u kthye në operacjone kaqë të thjeshta regjistrimi, kontrolli, sa që këto funkcjone munt t'i bëjnë fare mirë gjithë qytetarët që dinë shkrim e këndim, sa që këto funkcjone munt të kryhen fare mirë për «mëditjen» e zakonëshme «të punëtorit», sa që munt (dhe duhet) t'u hiqet këtyre funkcjoneve çdo karakter i privilegjuar dhe «hierarkik».

Parimi i të zgjedhurit funt e krye, parimi i të hequrit *në çdo moment* të të gjithë funkcjonarëve pa përjashtim, zbritja e rrogës së tyre në «mëditjen» e zakonëshme të punëtorit», këto masa demokratike të thjeshta dhe «që

kupëtohen vetëvetiu», duke bashkuar plotërisht interesat e punëtorëve dhe të shumicës së fshatarëve, shërbejnë njëkohësisht si një urë, që shpije nga kapitalizmi në socjalizëm. Këto masa kanë të bëjnë me riorganizimin e shtetit, me riorganizimin thjesht politik të shoqërisë, po ato e marrin, natyrisht, gjithë kupëtimin dhe rëndësinë e tyre vetëm në lidhje me «çpronësimin e çpronësonjësve», që realizohet ose që është në përgatitje e sipër, d.m.th. me kapërcimin e pronës private kapitaliste të mjeteve të prodhimit në pronë publike.

«Komuna — shkruan Marksi — e bëri një gjë të vërtetë paruliëa e të gjitha revolucjoneve borgeze, qeverinë pa harxhë, duke hequr dy kapitujt më me rëndësi të shpenzimeve, ushtërinë dhe burokracinë».

Nga katundarët, si edhe nga shtresat e tjera të borgezisë së vogël, vetëm një pakicë shumë e vogël «ngrihet», «bën prokopi» në kupëtimin borgez, d. m. th. bëhen ose njers në gjëndje të mirë, borgezë, ose funkcjonarë, që e kanë të siguruar jetën dhe që janë të privilegjuar. Shumica e madhe e katundarëve në të gjitha vendet kapitaliste, ku ka fshatarë (kështu është shumica e vëndeve kapitaliste), ësht e shtypur nga qeverija dhe do me dëshirë të madhe përmbysjen e saj, kërkon një qeveri «pa harxhë». Këtë gje munt ta realizoje *vetëm* proletarjati dhe, duke realizuar këtë, ay njëkohësisht heth një çap drejt riorganizimit socjalist të shoqërisë.

3. *Çdukja e parlamentarizmit*

«Komuna — shkruante Marksi — duhet të ishte jo një trup parlamentar, po një trup vepronjës, që të ushtronte njëkohësisht pushtetin legjislatif dhe pushtetin egzekutif» .... «Në vënt që të vendoste një herë në 3 ose në 6

vjet se cili anëtar i klasës sundonjëse do ta përfaqësonte dhe do ta shtypte *(ver-und zertreten)* popullin në parlament, në vënt të kësaj e drejta e përgjithëshme e votimit duhet t'i shërbente popullit të organizuar në Komunë për të kërkuar për ndërmarrjen e tij punëtorë, mikqyrës, llogaritarë, ashtu si e drejta individuale e zgjedhjeve i shërben po për këtë qëllim çdo punë-dhënësi tjetër».

Kjo kritikë e shënuar e parlamentarizmit, që është bërë më 1871, është sot gjithashtu, për shkak të sundimit të socjal-shovinizmit dhe të oportunizmit, një nga «fjalët e harruara» të marksizmit. Ministrat dhe parlamentarët me profesjon, trathëtarët e proletarjatit dhë socjalistët «afaristë» të ditëve tona, kritikën e parlamentarizmit u a kanë lënë funt e krye anarkistëve, dhe për këtë arësye çuditërisht të arësyeshme *çdo* kritikë të parlamentarizmit e e kanë çpallur «anarkizëm»! Nuk është për t'u çuditur aspakë që proletarjati i vëndeve «të përparuara» parlamentare, duke pasur ndot për «socjalistët» si Scheidemann, David, Legien, Sembat, Renaudel, Henderson, Vandervelde, Stauning, Branting, Bissolati e Shokë ia ka dhënë gjithënjë më tepër simpatitë e tija anarko-sindikalizmit, megjithese ky ka qënë vëllaji i oportunizmit.

Po për Marksin djalektika revolucjonare nukë ka qënë kurrë një frazë e zbrazët mode, një lodër, ashtu siç e bënë Plehanovi, Kautski etj. Marksi ka ditur t'i presë urat pa mëshirë me anarkizmin, sepse ky ish i pazoti, për të përdorur edhe «shtallën» e parlamentarizmit borges sidomos atehere kur duket sheshit se nukë ka një situatë revolucjonare; po njëkohësisht ay ka ditur të bëjë një kritikë më të vërtet proletare dhe revolucjonare të parlamentarizmit.

Të vendosësh një here në disa vjet se ci'i anëtar i klasës sundonjëse do të mbajë nënë zgjedhë, do të shtypë

populllin në parlament — ja esenca e vërtetë e parlamentarizmit borges, jo vetëm në monarkitë konstitucjonale parlamentare, po edhe në republikat më demokratike.

Po, po të shtrojmë problemin e shtetit, po ta konsiderojmë parlamentarizmin si një nga institucjonet e shtetit, nga pikëpamja e detyrave të proletarjatit në *këtë* fushë, ku është atëhere rruga e daljes nga parlamentarizmi? Si munt të bëjmë pa 'të?

Prapë dhe prapë duhet të themi: mësimet e Marksit, që janë bazuar në studimin e Komunës, janë harruar aqë tepër, sa që «socjal-demokrati» i sotmë (këndo: tradhëtari i sotmë i socjalizmit) nukë kupëton tjetër kritikë te parlamentarizmtt, përveç kritikës anarkiste ose reakcjonare.

Natyrisht, rruga e daljes nga parlamentarizmi nuk është në çdukjen e institucjoreve të përfaqësisë dhe të parimit të zgjedhjeve, po në transformimin e institucjoneve të përfaqësisë nga vende për llogje në institucjone «vepëronjëse». «Komuna duhet të ishte jo një institucjon parlamentar, po një institucjon vepëronjës, që të ushtronte njëkohësisht edhe pushtetin legjislatif edhe pushtetin egzekutif».

Një institucjon « jo parlamentar, po vepëronjës» kjo i godit mu në ballë parlamentarët e sotmë dhe «konet» parlamentare të socjal-demokracisë! Hithni sytë e shikoni në çdo vënt parlamentar, nga Amerika gjer te Svicëra, nga Franca gjer te Anglija, Norvegjija etj.: punën e vërtetë «të shtetit» e bëjnë dhe e zbatojnë prapa perdes departamentet, kancelaritë, shtabet. Në parlamentet vetëm llomotisin duke pasur si qëllim të veçantë të mashtrojnë «populli» e vogël». Kjo është aqë e vërtetë, sa që edhe në republikën ruse, në një republikë demokratike borgeze të gjitha këto vese të parlamentarizmit u duknë menjëherë

përpara se ajo të munt të krijonte një parlament të vërtetë. Heronj të tillë të filistinizmit të kalbur si Skobeljevët dhe Ceretelët, Çernovët dhe Avksentjevët kanë gjetur mënyrën se si të fëlliqin edhe Sovjetët sipas tipit të parlamentarizmit borges më të shëmtuar, duke i kthyer në vende për llogje. Në Sovjetët zotërinjtë ministra «socjalistë» mashtrojnë muzhikët besëplotë me fraza të zbrazta dhe me rezoluta. Në qeveritë bëhet një valle që s' ka të sosur, nga një anë, për të shtruar me radhë «në sofër» të ofiqeve të majme dhe të ofiqëve të nderit sa më tepër eserë dhe menshevikë, nga ana tjetër, për të «larguar vëmëndjen» e popullit. Kurse në zyrat, në shtabet «punojnë» punë «shteti»!

«Djello Naroda», organi i partisë qeveritare të «socjalistëve revolucjonarë», pohonte aty afër në një kryeartikull — me sinqeritetin e pashëmbëll të njerzve te «shoqërisë së mirë», ku «të gjithë» merren me prostitucjonin politik — se edhe në ato ministri, ku janë «socjalistët» (faqe me_nder!), edhe në këto ministri gjithë aparati burokratik mbetet në substancë po ay që ka qënë, funkcjonon si më parë, saboton fare «lirisht» inicjativat revolucjonare! Po, edhe po të mos ishte ky pohim, vallë nuk e provon këtë historija reale e pjesëmarrjes së eserëve dhe të menshevikëve në qeveri? Këtu është një gjë karakteristike vetëm ajo, që zotërinjtë Çernovë, Rusanovë, Zenzinovë dhe redaktorë të tjerë të «Djello Naroda», duke qënë në qeveri bashkë me kadetët, e kanë humbur turpin kaqë tepër, sa që kanë guximin të tregojnë publikisht dhe pa u skuqur, si për një gjë pa rëndësi, se në ministritë «e tyre» çdo gjë ka mbetur si më parë! Fraza demokratike revolucjonare për të gënjyer fshatarët sy-leshë, dhe burokracija e kancelarisë për «t'u bërë qejfin» kapitalistëve — ja *esenea* e koalicjonit të «ndershëm».

Parlamentarizmin e korruptuar dhe të kalbur të shoqërisë borgeze Komuna e zëvendëson me institucjone, ku luija e gjykimit dhe e bisedimit nukë degjeneron në mashtrim, pse parlamentarët vetë duhet të punojnë, duhet vetë t'i zbatojnë ligjët e tyre, vetë të kontrollojnë atë që realizohet në jetë dhe vetë të përgjigjen drejt për drejt përpara zgjedhësve të tyre. Institucjonet e përfaqësisë mbeten, po këtu *nukë* ka parlamentarizëm si një sistem të veçantë, si një ndarje pune në mes të pushtetit legjislatif dhe egzekutif, si një pozitë të privilegjuar për deputetët. Pa institucjone përfaqësije ne nukë munt ta përfytyrojmë demokracinë, edne demokracinë proletare; pa parlamentarizëm ne munt ta përfytyrojmë dhe *duhet* ta përfytyrojmë, në qoftë se për ne kritika e shoqërisë borgeze nuk është një fjalë e zbrazët, në qoftë se për ne tendenca për të përmbysur sundimin e borgezisë është një tendencë serjoze dhe e sinqertë dhe jo një frazë «elektorale» për të kapur në grep votat e punëtorëve, siç ndoth me menshevikët dhe eserët, Scheidemann-ët dhe Legien-ët, Sombat-ët dhe Vanderveld-ët.

Është shumë instruktiv fakti që Marksi, duke folur për funkcjonet e *atyre* funkcjonarëve, që i duhen edhe Komunës, edhe demokracisë proletare, merr për krahasim nëpunësit e «çdo punëdhënësi tjetër», d.m.th. një ndërmarrje të zakonshme kapitaliste me «punëtorë, mikqyrës dhe llogaritarë». Marksi nukë ka asnjë pikë utopizmi: ay nukë krijon, nukë çpik nga fantazija një shoqëri «të re». Jo, ay studjon si një proces të historisë së natyrës *lindjen* e shoqërisë së re *nga* shoqërija e vjetër, format e kapërcimit nga e dyta tek e para. Ay merr faktet, eksperjencën e lëvizjes së masave proletare dhe përpiqet të nxjerrë prej saj mësime praktike. Ay «mëson në shkollën» e Komunës si gjithë mendimtarët e mbëdhenj

revolucjonarë që nukë kanë pasur frikë të marrin mësime nga eksperjenca e lëvizjeve të mbëdha të klasës së shtypur, pa «predikuar moral» në mënyrë pedante (si Plehanovi: «nukë duheshin marrë armët» ose Cereteli: «klasa duhet të vetëkufizohet»).

Nukë munt të bëhet fjalë për çdukjen e burokracisë menjëherë, kudo dhe gjer në funt. Kjo është një utopi. Po të *thyesh* menjëhere maqinën e vjetër burokratike dhe të fillosh menjëherë të ndërtosh një maqinë të re, që të lejon të çfarosësh gradualisht çdo burokraci, kjo *nuk është* një utopi, kjo është eksperjenca e Komunës, kjo është një detyrë direkte, aktuale e proletarjatit revolucjonar.

Kapitalizmi i thjeshtëson funkcjonet e administrimit të «shtetit», të lejon të hedhësh poshtë «hierarkinë» dhe ta shpiesh gjithë punën në organizimin e proletarëve (si klasë sundonjëse), që në emër të gjithë shoqërisë pajton «punëtorë, mikqyrës, llogaritar».

Ne nukë jemi utopistë. Ne nukë «ëndërrojmë» të bëjmë *menjëherë* pa asnjë administratë, pa asnjë nënështrim këto ëndrra anarkiste, që bazohen në moskupëtimin e detyrave të diktaturës së proletarjatit, janë në themel të huaja për marksizmin dhe në realitet shërbejnë vetëm për të shtyrë revolucjonin socjalist gjersa njerzit të ndryshojnë. Jo, ne e duam revolucjonin socjalist me këta njerës, siç janë sot, të cilët nukë munt të bëjnë pa nënështrim, pa kontroll, pa «mikqyrës dhe llogaritarë»,

Po duhet t'i nënështrohesh pararojës së armatosur të gjithë masave të çfrytëzuara dhe punonjëse — proletarjatit. «Hierarkija specifike e funkcjonarëve të shtetit munt dhe duhet të zëvendësohet menjëherë, që të nesërmen, me funkcjone të thjeshta të «mikqyrësve dhe llogaritarëve», me funkcjone, të cilat që tani i përshtaten fare mirë nivelit të

çvillimit të qytetarëve përgjithërisht dhe munt të kryhen fare mirë për «mëditjen e punëtorit».

Duke u nisur nga ajo, që është krijuar prej kapitalizmit, do ta organizojmë prodhimin e math ne vetë, ne punëtorët, duke u pështetur në eksperjencën tonë si punëtorë, duke krijuar një disciplinë shumë të rreptë, një disciplinë të hekurt, të përkrahur nga pushteti shtetëror i punëtorëve të armatosur; ne do t'i shpijem funkcjonarët e shtetit në rolin e zbatonjesit të thjeshtë të direktivave tona, në rolin e «mikqyrësve dhe llogaritarëve» (natyrisht, duke mbajtur gjithë teknikët e llojeve dhe gradave të ndryshme), të cilët duhet të jenë të përgjegjshëm, të munt të hiqen dhe do të paguhen në mënyrë modeste — ja detyra *jonë* proletare, ja me se munt dhe duhet *të fillojmë* ne realizimin e revolucjonit proletar. Një fillim i tillë, në bazë të prodhimit të math, shpije vetëveliu në «shua-jen» gradуale të çdo burokracije, në krijimin progresif të një rendi — të një rendi pa thonjëza, të një rendi, që nuk i shëmbëllen skllavërisë me mëditje — të një rendi të tillë, ku funkcjonet e mikqyrjes dhe të evidencës, që do të thjeshtësohen gjithënjë më t.për, do të kryhen prej të gjithëve me radhë, pastaj do të bëhen një zakon dhe, më në funt, do të çduken si funkcjone *specjale* të një shtrese të veçantë njerzish.

Një socjal-demokrat gjerman mendjemprehtë i viteve pas 1870-ës e quajti *postën* një model ekonomije socjaliste. Kjo është shumë e vertetë. Sot posta është një ekonomi e organizuar sipas tipit të monopolit *kapitalist* të shtetit. Imperjalizmi i ktheu shkallë-shkallë të gjitha trustet në organizata të këtij tipi. Mi masat e «thjeshta» punonjëse, të cilat janë mbytur në punë dhe vuajnë prej urije, qëndron këtu po ajo burokraci borgeze. Po mekanizmi i udhëheqjes shoqërore të ekonomisë këtu është gati. Të

përmbysim kapitalistët, të thyejmë me dorën e hekurt të punëtorëve të armatosur rezistencën e këtyre çfrytëzonjësve, të çkatërrojmë maqinën burokratike të shtetit të sotmë — dhe përpara nesh do të kemi një mekanizëm të armatosur me teknikë të lartë dhe të çliruar nga «paraziti», mekanizëm të cilin munt ta vënë fare mirë në vepërim vetë punëtorët e bashkuar, duke pajtuar teknikë, mikqyrës, llogaritarë, duke paguar punën e *tyre*, si edhe punën e gjithë funkcjonarëve «të shtetit» përgjithërisht, në bazë të mëditjes së punëtorit. Kjo është detyra konkrete, praktike, që munt të realizohet menjëherë kundrejt të gjitha trusteve, që i shpëton masat punonjëse nga çfrytëzimi, që merr parasysh eksperjencën e filluar praktikisht (sidomos në fushën e organizimit të shtetit) nga Komuna.

Gjithë ekonomija nacjonale, e organizuar si posta në mënyrë që teknikët, mikqyrësit, llogaritarët, si edhe *gjithë* funkcjonarët, të marrin një rrogë jo më të madhe se „mëditja e punëtorit», nënë kontrollin dhe udhëheqjen e proletarjatit të armatosur, — ja qëllimi ynë i parë. Ja ç'shtet, ja ç'bazë ekonomike e shtetit na duhet neve. Ja ç'do të japë çdukja e parlamentarizmit dhe ruajtja e institucjoneve të përfaqësisë, ja ç'do t'i shpëtojë klasat punonjëse nga këto institucjone të shkërdhyera nga borgezija.

4. *Organizimi i unitetit të kombit*

„.. "Në skicën e shkurtër të organizimit nacjonal që Komuna nukë pati kohë të përpunonte më tutje, thuhet në mënyrë fare të caktuar se Komuna duhesh... të bëhesh forma politike edhe e fshatit më të vogël" .„ Prej Komuneve do të zgjidhesh edhe "delegacjoni nacjonai" i Parizit.

..... "Ato pakë funkcjone, po me shumë rëndësi, që do të mbetëshin atëhere për qeverinë qendrore, nukë duhesh të hiqëshin, — ata që e thonin, bënin me dije një falsifikim,

— po duhesh t'u besoheshin funkcjonarëve komunalë, d.m.th. rreptësisht të përgjegjshëm"...

..."Uniteti i kombit nukë duhesh çdukur, po përkundrazi, duhesh organizuar me anë të kushtetutës komunale. Uniteti i kombit duhesh të bëhësh një realitet duke çdukur pushtetin e shtetit, që e shiste veten si trupëzim të këtij uniteti, po që donte të mbetesh i pavarur nga kombi, të qëndronte përmi kombin. Në realitet ky pushtet shtetëror ishte vetëm një mish i huaj parazitar në trupin e kombit" .... "Detyra ishte që organet thjesht shtypëse të pushtetit të vjetër qeveritar t'i amputoheshin, që këtij pushteti që pretendonte të ishte përmi shoqërinë, t'i mereshin funkcjonet legjitime dhe t'u dorëzoheshin shërbëtorëve të përgjegjshëm të shoqërisë".

Gjer më ç'pikë oportunistët e socjal-demokracisë së sotme nuk i kanë kupëtuar — ndofta do të ishte më mirë të thonim: nukë kanë dashur të kupëtojnë — këto arsyetime të Marksit, provohet më mirë se nga çdo gjë tjetër prej librit të famshëm në mënyrën e Erostratit, të renegatit Bernstein: «Premisat e socjalizmit dhe detyrat e socjal-demokracisë». Pikërisht në lidhje me fjalët e qekura të Marksit Bernstein ka shkruar se ky program «nga përmbajtja e tij politike i përngjan shumë në të gjitha pikat esencjale federalizmit — të Proudhon-it.... Me gjithë divergjencat e tjera në mes të Marksit dhe të «borgezit të vogël» Proudhon» (Bernstein i vë fjalët „borges i vogël" në thonjëza, që, sipas mendimit të tij, duhet të jenë ironike)" në këto pika mënyra e mendimit të tyre është aqë e afërme, sa s'ka". Natyrisht, vazhdon Bernstein, rëndësija e municipalitetit shtohet, po: «më duket e dyshimtë që detyra e parë e demokracisë të jetë një heqje e tillë» (*Aufloesung* — përndarje, shkrirje) e shteteve moderne dhe një ndryshim kaqë i plotë (*Umwandlung* — shndërrim) i organizimit

të tyre, siç e përfytyrojnë Marksi dhe Proudhon-i — formim i kuvëndit nacjonal me delegatë nga kuvëndet të provinceve ose të retheve, të cilët, nga ana e tyre, do të përbëheshin nga delegatët e komuneve — kështu që gjithë forma e mëparëshme e përfaqësive nacjonale do të çdukesh fare (Bernstein, «Premisat», f. 134 dhe 136 të botimit gjermanisht të v. 1899).

Kjo është për të zënë kokën me duar: të ngatërrosh mendimet e Marksit mi "çdukjen e pushtetit të shtetit-parazit" me federalizmin e Proudhon-it! Po kjo nuk është një gjë e rastit, pse oportunistit as që i shkon ndërmënt se Marksi këtu nukë flet aspakë për federalizmin në kundërshtim me centralizmin, po mi çkatërrimin e maqinës së vjetër borgeze të shtetit, që egziston në të gjitha vëndet borgeze.

Oportunistit i shkon ndërmënt vetëm ajo, që ay sheh reth tij, në rethin e filistinizmit mikroborges të anullimit «reformist», d. m. th. vetëm «municipalitetet»! Mi revolucjonin e proletarjatit oportunisti nukë di më as të mendojë.

Kjo është qesharake. Po eshtë për t'u shënuar se në këtë pikë Bernstein-in nuk e kanë kundërshtuar. Mendimin e Bernstein-it shumë vetë e kanë hedhur poshtë — sidomos Plehanovi në literaturën ruse, Kautski në literaturën evropjane, po as njëri, as tjetri *nukë* kanë folur për *këtë* shtrëmbërim të Marksit nga ana e Bernstein-it.

Oportunisti aqë tepër nukë di më të mendojë në mënyrë revolucjonare dhe të gjykojë për revolucjonin, sa që i ngarkon Marksit "federalizmin", duke e ngatërruar atë me Proudhon-in, themelonjësin e anarkizmit. Dhe Kautski me Plehanov-in, që duan të jenë marksistë ortodoksë, që duan të mprojnë doktrinën e marksizmit revolucjonar, heshtin për këtë gjë! Këtu qëndron një nga rrënjët e bana-

lizimit ekstrem të pikëpamjes mi ndryshimin në mes të marksizmit dhe të anarkizmit, që është karakteristike për kautskjanët dhe oportunistët; për këtë gjë do të flasim prapë.

Në arësyetimet e qekura të Marksit mi eksperjencën e Komunës nukë ka asnjë gjurmë federalizmi. Marksi pajtohet me Proudhon-in pikërisht në atë gjë, që oportunisti Bernstein nuk e sheh. Marksi largohet nga Proudhon-i pikërisht në atë gjë, ku Bernstein-i sheh një gjasi në mes të tyre.

Marksi pajtohet me Proudhon-in, pse që të dy janë për «çkatërrimin» e maqinës shtetërore të sotme. Këtë gjasi të marksizmit me anarkizmin (edhe me Proudhon-in edhe me Bakuninin) nukë duan ta shohin as oportunistët, as kautskjanët, pse ata në këtë pikë janë larguar nga marksizmi.

Marksi ndahet edhe me Proudhon-in edhe me Bakuninin pikërisht në çështjen e federalizmit (pa zënë në gojë diktaturën e proletarjatit). Federalizmi rjeth parimisht nga pikëpamjet mikroborgeze të anarkizmit. Marksi është centralist. Dhe në arësyetimet e qekura të tij nukë ka shtëmëngje nga centralizmi. Vetëm njers, të mbushur me «bestytni» mikroborgeze për shtetin, munt të marrin çdukjen e maqinës borgeze si çdukje të centralizmit!

Po, në qoftë se proletarjati dhe katundarija e varfër marrin në dorë pushtetin e shtetit, organizohen në mënyrë fare të lirë në bazë të komuneve dhe *bashkojnë* vepërimin e të gjitha komuneve për të goditur kapitalin, për të thyer rezistencën e kapitalistëve, për të transferuar në duart e *gjithë* kombit, gjithë shoqërisë pronën private të udhëve të hekurta, të fabrikave, të tokës etj., vallë nuk është kjo centralizëm? Vallë nuk është kjo centralizmi më demokratik dhe më konsekuent? Dhe për më tepër një centralizëm proletar?

Bernstein-i nuk është fare në gjëndje të kupëtojë se munt të ketë një centralizëm të lirë, një bashkim të lirë të komuneve në komb, një shkrirje të lire të komuneve proletare, për të çkatërruar sundimin borges dhe maqinën borgeze të shtetit. Bernstein, si gjithë filistinët, e përfyty-ron centralizmin si një gjë që vjen vetëm nga lart, që munt të impozohet dhe të mbahet vetëm prej burokracisë dhe prej militarizmit.

Marksi sikur e dinte se pikëpamjet e tija do të munt të falsifikoheshin, e thekson me qëllim, se janë një falsifikim me dashje akuzat kundër Komunës, sikur ajo ka dashur të çdukë unitetin e kombit, të heqë pushtetin qëndror. Marksi përdor me qëllim shprehjen «organizimi i unitetit të kombit» për të vënë në kundrësitim centralizmin e ndërgjegjshëm, demokratik, proletar me centralizmin borges, ushtarak, burokratik.

Po..., ay që nuk do të dëgjojë është më keq se shurdhi. Dhe oportunistët e socjal-demokracisë së sotme pikërisht nukë duan të dëgjojnë të flitet për çdukjen e pushtetit shtetëror, për prerjen e mishit të huaj.

5. *Çdukja e shtetit parazit*

Ne prumë më sipër fjalët përkatëse të Marksit dhe tani duhet t'i plotësojmë.

.... «Është zakonisht fati i çdo krijimi të ri historik — ka shkruar Marksi — që ta marrin si një kopje të formave të vjetra dhe bile të formave të çdukura të jetës shoqërore, me të cilat institucjonet e reja rgjasin gjer më një rarë pike. Kështu edhe Komuna e re, që thyen (bricht) pushtetin e shtetit modern, është konsideruar si një ringjallje e komunës mesjetare.. si një federatë shtetesh të vogla (siç e ëndëronin Montesquieu, Zhirondinët[10]),...si një formë e smadhuar e luftës së vjetër kundër një centralizimi të pamasë...

... "Kushtetuta komunale përkundrazi do t'i rikthente trupit shoqëror të gjitha forcat e gllabëruara gjer më atëhere nga ky mish i huaj parazitar i "shtetit", që ushqehet mi kurrus të shoqërisë dhe që pengon lëvizjen e lirë të saj. Vetëm me këtë do të kishte bërë një hapë përpara për ringjalljen e Francës"...

...«Kushtetuta komunale do t'i viste prodhonjësit e katundeve nënë udhëheqjen mendore të qyteteve kryesore të çdo rethi dhe do t'u siguronte atje, në personin e punëtorëve të qyteteve, përfaqësonjësit e natyrshëm të interesave të tyre. Edhe veté egzistenca e Komunës do të sillte me vete, si një gjë që kupëtohet vetëvetiu, vetëqeverisjen lokale, po jo më si një kundërpeshë të pushtetit shtetëror, që tani bëhet i tepërm".

«Çdukja e pushtetit shtetëror», të këtij «mishi të huaj parazitar», «prerja» e tij, «çkatërrimi» i tij; «pushteti shtetëror bëhet tani i tepërm» — ja si shprehet Marksi për shtetin, duke çmuar dhe analizuar eksperjencën e Komunës.

Të gjitha këto janë shkruar një çikë më pakë se gjysmë shekulli përpara, dhe tani na duhet të bëjmë gërmime të vërteta për të futur në ndërgjegjen e masave marksizmin pa shtrëmbërime. Përfundimet, që nxori Marksi nga analiza e të fundit revolucjon të math, që jetoji ay vetë, i harruan pikërisht atëhere, kur erdhi koha e revolucjoneve të reja, e revolucjoneve të mbëdha të proletarjatit.

..«Intepretimet e ndryshme që shkaktoi Komuna, dhe interesat e ndryshme që u shprehën aty, provojnë se ajo ka qënë një formë politike. që kish në shkallë fë lartë në vete aftësinë të shtrihej më tej, kurse të gjitha format e mëparëshme qeveritare kanë qënë në esencën e tyre shtypëse. Sekreti i vërtetë i saj ka qënë ky: ajo ishte, në esencë, *një qeveri e klasës punëtore*, një rezultat i luftës së klasës prodhonjëse kundër klasës që përvetëson, ajo ishte, forma politike që u gjet më në fund, në të cilën munt të realizohej çlirimi ekonomik i punës"...

"Pa këtë kondité të fundit kushtetu'a komunale do të ishte një gjë e pamundëshme dhe një mashtrim"...

Utopistët janë marrë «me zbulimin» e formave politike, në të cilat do të bëhesh riorganizimi i shoqërisë. Anarkistët i janë shtëmëngur përgjithërisht problemit të formave politike. Oportunistët e socjal-demokracisë së sotme i kanë quajtur formal politike borgeze të shtetit demokratik parlamentar si një kufi, që nukë munt të kapërxehet, dhe kanë thyer ballët duke u lutur përpara këtij «*modeli*», kanë deklaruar si anarkizëm çdo tendencë per të *çkatërruar* këto forma.

Marksi nxori nga gjithë historija e socjalizmit dhe e luftës politike konkluzjonin se shteti duhet të çduket, se forma transitore e çdukjes së tij (kapërcimi nga shteti në jo-shtet) do të jetë «proletarjati i organizuar në klasë sundonjëse». Po Marksi nukë mori përsipër që të *zbulonte format* politike të kësaj së arthme. Ay u kufizua me një vërejtje të përpikët të historisë franceze, me analizën e saj dhe me përfundimin që doli nga viti 1851: puna shkon në *çkatërrimin* e maqinës së shtetit borges.

Dhe kur plasi lëvizja revolucjonare e masave proletare, Marksi, me gjithë se kjo lëvizje dështoi, me gjithë se zgjati një kohë të shkurtër dhe ishte sheshit dobësija e saj, filloji të studjojë format e *zbuluara* prej saj.

Komuna është forma „e zbuluar më në funt" e revolucjonit proletar, në të cilën munt të realizohet çlirimi ekonomik i punës.

Komuna është orvatja e parë e revolucjonit proletar per të *thyer* maqinën e shtetit borges dhe forma politike „e zbuluar më në funt", në të cilën munt dhe duhet të *zëvëndësohet* ajo që është thyer.

Ne do të shohim më poshtë se revolucjonet ruse të viteve 1905 dhe 1917, në një situatë tjetër, në kondita të tjera, vazhdojnë punën e Komunës dhe vërtetojnë analizën historike gjenjale të Marksit.

KAPITULLI IV.

VAZHDIM.
SHPJEGIME PLOTËSONJËSE TË ENGELSIT

Marksi ka dhënë atë që është themelore mi rëndësinë e eksperjencës së Komunës. Engelsi është kthyer e rikthyer shumë herë në këtë temë, duke shpjeguar analizën dhe përfundimet e Marksit, duke hedhur dritë mi anët *e tjera* të problemit me kaqë forcë dhe duke e theksuar aqë tepër, sa që na duhet të flasim për këto shpjegime në mënyrë të veçantë.

1. «*Problemi i banesave*»

Në veprën e tij mi problemin e banesave (1872) Engelsi merr parasysh eksperjencën e Komunës, duke folur disa herë mi detyrat e revolucjonit në lidhje me shtetin. Ësht interesante që në këtë temë konkrete duken në mënyrë të qartë, nga një anë, tiparet analoge të shtetit proletar me ato të shtetit të sotmë, — tipare, që na lejojnë në të dyja rastet të flasim për shtet, — dhe, nga ana tjetër, tiparet që i dallojnë ose kapërcimi që shpije në çdukjen e shtetit.

> "Si munt të zgjidhet problemi i banesave? Në shoqërinë e sotme ky problem zigjidhet fare njësoj si çdo problem tjetër shoqëror: me ekuilibrimin gradual, ekonomik të kërkesës dhe të ofertës; po kjo është një zgjidhje e

tillë, që e ringjall pa reshtur problemin, d. m. th. nuk i i jep asnjë zgjidhje. Si do ta zgjidhë këtë problem revolucjoni shoqeror, kjo do të varet jo vetëm nga rethanat e kohës dhe të vëndit, po edhe nga probleme, që shkojnë shumë më tej, prej të cilave një nga problemet më me rëndësi është problemi i çdukjes së kundrështimit në mes të qytetit dhe të katundit. Me qënë se nukë duam të çpikim sisteme utopike mi organizimin e shoqërisë së nesërme, prandaj do të ishte një gjë fare e kotë të ndalemi në këtë pikë. Një gjë ësht e sigurt: edhe tani në qytetet e mbëdha ka mjaft ndërtesa për t'i bërë ballë me një herë çdo mungese reale banesash, po të jetë se këto ndërtesa do të përdoren në mënyrë racjonale. Kjo, natyrisht, munt të realizohet vetëm duke çpronësuar pronarët e tanishëm dhe duke vendosur në këto shtëpi punëtorët pa shtëpi ose punëtorët, që rrojnë tani shumë ngushtë. Dhe sa po që proletarjati të marrë në dorë pushtetin politik, një masë e tillë, që diktohet nga interesat e dobisë publike, do të munt të realizohet aqë lehtë, sa edhe çpronësimet e tjera dhe rekuizimet e shtëpive nga ana e shtetit të sotmë" (f. 22 e botimit gjermanisht të v. 1887).

Këtu nukë merret parasysh ndryshimi i formës së pushtetit shtetëror, po vetëm përmbajtja e aktivitetit të tij. Çpronësimet dhe rekuizimet e shtëpive bëhen edhe më urdhër të shtetit të sotmë. Shteti proletar, nga ana formale, edhe ay «do të japë urdhër» për të rekuizuar dhe për të çpronësuar shtëpitë. Po ësht e qartë se aparati i vjetër egzekutif, burokracija e lidhur me borgezinë, nukë do të ishte aspakë i përshtatshëm për të zbatuar urdhërat e shtetit proletar.

.... "Duhet të konstatojmë se marrja në dorë efektive e mjeteve të punës, e gjithë industrisë nga ana e populit punonjës është dijametralisht e kundërta e "shpërblesës" së Proudhon-it. Në këtë rast të fundit çdo punëtor më vete bëhet pronar i shtëpisë, i tokës, i mjeteve të punës; kurse në rastin e parë është "populli punonjës" që mbe-

tet pronar kolektif i shtëpive, i fabrikave dhe i mjeteve, të punës. Të përdorurit e këtyre shtëpive, fabrikave etj. të pakën në kohën e kapërcimit, si zor që t' u jepet personave ose shoqerive pa shpërblim të shpenzimeve. Gjithashtu edhe çdukja e pronës së tokës nuk do të thotë çdukjen e rentës nga toka, po transferimin e saj ndonëse në një formë të ndryshuar, në duart e shoqërisë. Prandaj marrja në dorë efektive e të gjitha mjeteve të punës nga ana e popullit punonjës nukë përjashton në asnjë mënyrë ruajtjen e qirasë dhe dhënjen me qira" (f. 69).

Problemin, që prekëm në këtë arësyetim, d.m.th. problemin e bazave ekonomike të shuarjes së shtetit, ne do ta studjojmë në kapitullin që vjen. Engelsi shprehet në mënyrë tepër të matur, kur thotë se shteti proletar «si zor» që të japi shtëpi pa pagesë, «të pakën në kohën e kapërcimit» Dhënja me pagesë e shtëpive, që janë të gjithë popullit, familjeve të veçanta, supozon edhe nxjerrjen e kësaj pagese, si edhe një farë kontrolli dhe vendosjen e disa regullave për të ndarë shtëpitë. Të gjitha këto lypin një formë të caktuar shteti, po aspakë një aparat të veçantë ushtarak dhe burokratik me funkcjonarë që kanë një pozitë veçanërisht të privilegjuar. Kurse kapërcimi në një gjëndje të tillë, kur shtëpitë munt të jepen falas, është lidhur me «shuarjen» e plotë të shtetit.

Duke folur për blankistët, [11]) që pas Komunës dhe nënë influencën e eksperjencës së saj u hodhën në pozitën parimore të marksizmit, Engelsi e formulon, në kalim e sipër, këtë pozitë në këtë mënyrë :

> .. "Nevoja e domosdoshme e vepërim't politik të proletarjatit dhe të diktaturës së tij, si kapërcim që shpije në heqjen e klasave, dhe bashkë me të dhe të shtetit"... (f. 55)

Ndofta amatorët e kritikës gërmë për gërmë ose «çfarosësit» borgezë «të marksizmit» do të shohin një kundrë-

shtim në mes të këtij *pranimi* të «heqjes së shtetit» dhe të mohimit të kësaj formule, si formulë anarkiste, në rrjeshtat e qekura më sipër të «Anti-Dühring-ut». Nukë do të ishte për t'u çuditur, sikur oportunistët ta quanin edhe Engelsin «anarkist», — tani po përhapet gjithënjë më tepër akuza për anarkizëm kundër internacionalistëve nga ana e socjal-shovinistëve.

Marksizmi na ka mësuar kurdoherë se bashkë me heqjen e klasëve do të bënet dhe heqja e shtetit. Ato rrjeshtat e njohura mi «shuarjen e shtetit» në «Anti-Dühring» i akuzojnë anarkistët jo vetëm pse ata janë për heqjen e shtetit, po pse ata predikojnë se shteti munt të hiqet «sot — nësër».

Në lidhje me shtrëmbërimin e plotë të pozitës së marksizmit kundrejt anarkizmit mi problemin e çdukjes së shtetit, shtrëmbërim që e bën doktrina «socjal-demokrate» që sundon sot, është veçanërisht e dobishme të përmëndim një polemikë të Marksit dhe të Engelsit me anarkistët.

2. *Polemika me anarkistët*

Kjo polemikë ësht e vitit 1873. Marksi dhe Engelsi kishin botuar disa artikuj kundër proudhonistëve, «autonomistëve» ose «antiautoritaristëve», në një përmbledhje socjaliste italjane, dhe vetëm me 1913 këta artikuj duallën të përkthyer gjermanisht në «Neue Zeit.

...«Në qoftë se lufta politike e klasës punëtore — shkruante Marksi duke qesëndisur anarkistët për mohimin e politikës nga ana e tyre — merr forma revolucjonare, në qoftë se punëtorët në vënt të diktaturës së borgezisë vënë diktaturën e tyre revolucjonare, ata kryejnë një krim të tmerrshëm kundër parimeve, sepse, për të përmbushur

nevojat e tyre të ditës, nevoja të mjera dhe banale, për të thyer rezistencën e borgezisë, punëtorët i japin shtetit një formë revolucjonare dhe transitore, në vënt që të lënë armët dhe ta heqin shtetin»... («*Neue Zeit*», 1913-14, v, 32 vol. I, f. 40).

Ja kundër çfarë «heqjeje» të shtetit, dhe vetëm kundër kësaj heqjeje të shtetit, ngrihesh Marksi, duke hedhur poshtë mendimin e anarkistëve! Jo, aspakë kundër çdukjes së shtetit bashkë me çdukjen e klasave ose kundër heqjes së shtetit me heqjen e klasëve, po kundër dorëheqjes së punëtorëve nga të përdorurit e armëve, nga dhuna e organizuar, d. m. th. *nga shteti*, që duhet të shërbejë për të «thyer rezistencën e borgezisë».

Marksi thekson me qëllim — që të mos të shtrëmbërojnë kupëtimin e vërtetë të luftës së tij kundër anarkizmit — «formën revolucjonare dhe transitore» të shtetit, që i duhet proletarjatit. Proletarjatit i duhet shteti vetëm përkohësisht. Ne nukë kemi divergjenca me anarkistët mi problemin e heqjes së shtetit, si *qëllim*. Ne themi se për të realizuar këtë qëllim duhet të përdoren përkohësisht veglat, mjetet, mënyrat e pushtetit shtetëror *kundër* çfrytëzonjësve, ashtu sindëkur duhet diktatura e përkohëshme e klasës së shtypur për të çdukur klasat. Marksi zgjeth mënyrën më të prerë dhe më të qartë kur shtron problemet kundër anarkistëve: duke përmbysur zgjedhën e kapitalistëve, a duhet punëtorët «t'i lëshojnë armët» ose t'i përdorin kundër kapitalistëve për të thyer rezistencën e tyre? Dhe të përdorurit sistematik të armëve nga ana e një klase kundër një klase tjetër, ç'është kjo tjetër veçse një «formë transitore» e shtetit?

Çdo socjal-demokrat le të pyesë veten: vallë *kështu* e ka shtruar ay problemin e shtetit në polemikë me anarkistët? Vallë *kështu* e ka shtruar këtë problem shumica

e madhe e partive zyrtare socjal-demokrate të Internacjonales së Dytë?

Engelsi paraqit po këto mendime në një mënyrë edhe më të hollësishme dhe popullore. Ay pikë së pari tallet me konfuzjonin e ideve të proudhonistëve, të cilët e quajnin veten «antiautoritaristë», d.m.th. mohonin çdo autoritet, çdo nënështrim, çdo pushtet. Të marrim një fabrikë, një udhë të hekurt, një vapor në det të hapët — thotë Engelsi — vallë a nuk është e qartë se pa një farë nënështrimi, d.m.th. pa një farë autoriteti ose pushteti nukë munt që të funkcjonojë asnjë nga këto stabilimente teknike të koklavitura, që bazohen në përdorimin e maqinave dhe në bashkëpunimin me plan të shumë personave?

> . . . «Kur unë parashtroj këto argumente — shkruan Engelsi — kundër antiautoritaristëve më të tërbuar, ata nukë munt të më japin veçse këtë përgjigje: «Po! Kjo është e vërtetë, po këtu nuk është fjala për autoritetin, që ne u japim delegatëve tanë, po për një misjon të *caktuar*. Keta njerz kujtojnë se ne munt të ndryshojmë një send duke i ndryshuar emrin»...

Si tregon në këtë mënyrë se autoriteti dhe autonomija janë koncepte relative; se fusha e aplikimit të tyre ndryshon me fazat e ndryshme të çvillimit shoqëror; se është një gjë absurde të quhen si absolute; si shton se fusha e përdorimit të maqinave dhe të prodhimit të math po zgjerohet gjithënjë më tepër, Engelsi hidhet nga arësyetimet e përgjithëshme mi autoritetin në problemin e shtetit.

> . . . Në qoftë se autonomistët — shkruan ay — kanë dashur të thonë vetëm, se organizimi shoqëror i së arthmes do ta lejojë autoritetin vetëm brënda kufive, që diktohen me domosdo ga kondit at e prodhimit, atëhere munt të merrëshim vesh me ta. Po ata janë të verbër kundrejt të gjitha fakteve që e bëjnë autoritetin të domosdoshëm dhe ata leftojnë me pasjon kundër fjalës.

«Përse antiautoritaristët nukë kufizohen duke bërtitur kundër autoritetit politik, kundër shtetit? Të gjithë socjalistet janë në një mendje se shteti, dhe bashkë me të edhe autoriteti politik do të çduken si rezultat i revolucjonit shoqëror të nesërm; d.m.th. se funkcjonet shoqërore do të humbasin karakterin e tyre politik dhe do të kthehen në funkcjone të thjeshta administrative që do të kujdesen për interesat shoqërore. Po antiautoritaristët kërkojnë që shteti politik të hiqet menjëherë, më përpara se të hiqen marrëdhënjet shoqërore, që e kanë pjellë. Ata kërkojnë që akti i parë i revolucjonit shoqëror të jetë heqja e autoritetit.

«A kanë parë nonjë herë një revolucjon këta zotërinj? Revolucjoni është pa dyshim, gjëja më autoritare, që munt të bëhet. Revolucjoni është një akt, me të cilin një pjesë e populisisë i impozon vullnetin e saj pjesës tjetër me armë, me bajoneta, me topa, d.m.th. me mjete jashtëzakonisht autoritare. Dhe partija fitimtare është e detyruar nga nevoja që të mbajë sundimin e saj me anë të frikës, që u shtijnë reakcjonarëve armët e saja. Sikur Komuna e Parizit të mos ishte përshtetur në autoritetin e populli t të armatosur kundër borgezisë, vallë a do të kishte qëndruar ajo më tepër se një ditë? A nukë kemi të drejtë ne, përkundrazi, ta qërtojmë Komunën pse ajo e përdori tepër pakë këtë autoritet? Kështu: ose — ose. Ose antiautoritaristët nukë dinë dhe ata vetë çthonë, dhe në këtë rast ata mbjellin vetëm konfuzion. Ose ata e dinë këtë dhe në këtë rast ata trathë ojnë kauzën e proletarjatit. Në të dyja rastet a a i shërbejnë vetëm reakcjonit». (f. 39).

Në këtë arësyetim janë prekur probleme, që duhet të studjohen në lidhje me temën mi raportin në mes të politikës dhe të ekonomisë në periodën e shuarjes së shteti • (kësaj teme i kushtohet kapitulli që vjen). Këto janë: problemi i transformimit të funkcjoneve shoqërore nga funkcjone politike në funkcjone të thjeshta administrative dhe

problemi i «shtetit politik» Kjo shprehje e fundit, që munt të krijojë veçanërisht mos-kupëtime, tregon procesin e shuarjes së shtetit: shtetin që shuhet, në një shkallë të caktuar të shuarjes së tij, munt ta quajmë shtet jo-politik.

Gjëja që është për t' u shënuar më tepër në këtë arësyetim të Engelsit është prapë të shtruarit e problemit kundra anarkistëve- Socjal-demokratët, që dëshërojnë të jenë dishepuj të Engelsit, kanë folur që prej 1873 me miljona herë kundër anarkistëve, po kanë folur pikërisht *jo* ashtu, si munt dhe si duhet të diskutojnë marksistët. Ideja anarkiste mi heqjen e shtetit është konfuze dhe *jo-revolucjonare*, — ja si e shtronte problemin Engelsi. Anarkistët pikërisht nukë duan të shohin revolucjonin në lindjen dhe çvillimin e tij, në detyrat e tija specifike në lidhje me dhunën, autoritetin, pushtetin, shtetin.

Kritika e zakonëshme kundër anarkizmit nga ana e socjal-demokratëve të sotmë është katandisur në një banalitet të thjeshtë mikroborges: «Ne e pranojmë shtetin, kurse anarkistët jo! » Natyrisht, një banalitet i tillë nukë munt të mos i largojë punëtorët që mendojnë pak' a shumë, punëtorët revolucjonarë. Engelsi flet ndryshe: ay thekson se gjithë socjalistët pranojnë çdukjen e shtetit si një pasojë të revolucjonit socjalist. Ay shtron pastaj në mënyrë konkrete problemin e revolucjonit, d.m.th. atë problem, që zakonisht socjal-demokratët oportunistë e lënë me një anë, duke ua lënë, si të thuash, eksklusivisht anarkistëve që ta «përpunojnë». Dhe, duke shtruar këtë problem, Engelsi e kap demin nga brirët: a nukë duhesh ta përdorte Komuna *më tepër* pushtetin *revolucjonar të shtetit*, d.m.th. të proletarjatit të armatosur, të organizuar në klasë sundonjëse?

Socjal-demokracija zyrtare sundonjëse zakonisht i është shtëmëngur problemit të detyrave konkrete të proletarjatit

në revolucjon — ose vetëm me një ironi prej filistini, ose në rastin më të mirë, u bënte bisht me një sofizmë: shohim e bëjmë pastaj. Dhe anarkistët lituan të drejtën të flasin kundër kësaj demokracije, të thonë se ajo trathëton detyrën e saj për edukimin revolucjonar të punëtorëve. Engelsi çfrytëzon eksperjencën e revolucjonit proletar të fundit, pikërisht për të studjuar në menyrën më konkrete, se ç'duhet të bëjë dhe si duhet të bëjë proletarjati si në lidhje me bankat, ashtu edhe në lidhje me shtetin.

3 *Letra Bebelit*

Një nga arësyetimet më të shënuara, në mos arësyetimi më i shënuar, në veprat e Marksit dhe të Engelsit mi problemin e shtetit është kjo pjesë e letrës së Engelsit drejtuar Bebelit me datë 18-28 mars — 1875. Kjo letër — në parantezë — u shtyp, me sa dimë, për herë të parë nga Bebeli në vol. e II-të të kujtimeve të tija («Nga jeta ime»), që dolli në dritë më 1911, d.m.th. 36 vjet pas hartimit dhe dërgimit të letrës.

Engelsi i shkruante kështu Bebelit, duke kritikuar po atë projekt të programit te Gotha-s, që ka kritikuar dhe Marksi në letrën e famëshme drejtuar Brackes, dhe duke prekur në mënyrë të veçantë problemin e shtetit:

.. «Shteti i lirë popullor është bërë shtet i lirë. Sipas kupëtimit gramatikal të këtyre fjalëve, shteti i lirë është një shtet i lirë kundrejt qytetarëve të tij, d. m. th. një shtet me një qeveri despotike. Duhan lënë të gjitha këto pallavra mi shtetin, sidomos pas Komunës, e cila nukë ka qënë një shtet në kupëtimin e vërtetë. Anarkistët na kanë çarë kokën më tepër se ç'duhet me «shtetin popullor» ndonëse vepra e Marksit kundër Proudhon-it, dhe pastaj «Manifesti Komunist» thonë shprehimisht se me vendosjen e regjimit shoqëror socjalist shteti prishet vetëvetiu

(*sich aufloest*) dhe çduket. Me qënë se shteti është vetëm një institucjon i përkohshëm, që duhet përdorur në luftë, në revolucjon, për të shtypur me forcë kundërshtarët, prandaj është një gjë fare absurde të flasësh për një shtet popullor të lirë: gjërsa proletarjati *ka* akoma *nevojë* për shtetin, ay nukë ka nevojë për të në interesin e lirisë, por në interesin e shtypjes së kundërshtarëve të tij, dhe kur do të bëhet e mundëshme që të flasin për liri, atëhere shteti, si i tillë, nukë do të egzistojë më. Prandaj ne propozojmë që të vihet kudo në vënt të fjalës *shtet* fjala: «*Gemeinwesen*», nje fjalë e vjetër gjermane shumë e bukur, që i përgjigjet fjalës frëngjisht «Komune» (f. 322 e origjinalit gjermanisht).

Duhet të kemi parasysh se kjo letër ka të bëjë me programin e partisë, që Marksi kritikoji në një letër, që ishte shkruar vetëm disa javë më von (letra e Marksit me datë 5 maj 1875) dhe se Engelsi ironte atëhere, bash kë me Marksin, në Londër. Prandaj, duke thënë «ne» në frazën e fundit, Engelsi, pa dyshim, i propozon në emër të tij dhe të Marksit kryetarit të partisë gjermane që *ta heqë nga programi* fjalën «shtet» dhe ta zëvëndësojë me fjalën «*Komunë*».

Ç' ulërimë mi «anarkizmin» do të ngrinin krerët e «marksizmit» të sotmë, të falsifikuar sipas qejfit të oportunistëve, sikur t'u propozonin një korigjim të tillë të programit!

Le të ulërijnë. Për këtë gjë do t' i lëvdojë borgezija.

Dhe ne do të bëjmë punën tonë. Në revizjonin e programit të partisë sonë këshilla e Engelsit dhe e Marksit duhet të merret pa tjetër parasysh për të qënë më afër së vërtetës, për ta vënë në vënd marksizmin duke e qëruar nga shtrëmbërimet, për të drejtuar me siguri më të madhe luftën e klasës punëtore për çlirimin e saj. Sigurisht se në mes të bolshevikëve nukë do të ketë kundrështarë të kë-

shillës së Engelsit dhe të Marksit. Vështirësija do të dalë, ndofta, vetëm për termin. Gjermanisht ka dy fjalë për «Komunë», prej të cilave Engelsi zgjodhi atë, që *nukë* do të thotë një Komunë më vete, po tërësinë e tyre, një sistem komunesh. Rusisht nukë ka një fjalë të tillë, dhe ndofta duhet të zgjedhim fjalën frëngjisht «Komunë», ndonëse dhe kjo ka të metat e saja.

.....«Komuna nuk ishte një shtet në kupëtimin e vërtetë» — ja teza më me rëndësi nga pikëpamja teorike e Engels-it. Pas asaj që thamë më sipër, kjo tezë kupëtohet fare mirë. Komuna *pushonte* së qeni një shtet, me qënë se ajo duhesh të shtypte jo shumicën e popullsisë, po pakicën (çfrytëzonjësit); maqinën e shtetit borges ajo e kish thyer ; në vënt të forcës së *veçantë* shtypëse dilte në skenë vetë popullsija. Të gjitha këto janë largime nga shteti në kupëtimin e vërtetë. Dhe po të ish se Komuna do të konsolidohesh, atëhere aty vetëvetiu «do të shuhesnin» gjurmat e shtetit, ajo nukë do të kishte nevojë për të «hequr» institucjonet e tija: ato do të pushonin së funkcjonuaji në masën që nuk do t'u kish mbetur gjësendi për të bërë.

«Anarkistët na çajnë kokën» me shtetin popullor»; kur thotë kështu, Engelsi ka parasysh sidomos Bakuninin dhe sulmet e tija kundër socjal-demokratëve gjermanë. Engelsi i quan të drejta këto sulme në atë masë, që «shteti popullor» është një absurditet dhe një shtëmengje aqë e madhe nga socjalizmi, sa edhe «shteti i lirë popullor«. Engelsi përpiqet ta drejtojë luftën e socjal-demokratëve gjermanë kundra anarkistëve, ta bëjë këtë luftë të drejtë në parim, ta spastrojë nga paragjykimet oportuniste në lidhje me «shtetin», Medet! Letra e Engelsit mbeti 36 vjet në sirtar. Ne do të shohim më poshtë se, edhe pas botimit të kësaj letre, Kautski në substancë, ngul këmbë përsëri në ato gabime, që Engelsi porosiste të evitoheshin.

Bebeli iu përgjegj Engelsit në letrën me datë 21 shtator 1875, ku shkruante, në mes të tjerave, se ay ishte «fare në një mëndje» me gjykimin e tij mi projektin e programit dhe se ay kish qortuar Liebknecht-in për koncesjonet e tij (f. 304 e botimit gjermanisht të «Kujtimeve» të Bebelit, vol. II). Po, po të marrim broshurën e Bebelit «Qëllimet t'ona», ne do të gjejmë aty arësyetime fare të gabuara mi shtetin:

> «Shteti duhet të transformohet nga një shtet i bazuar në *sundimin e klasëve* në një *shtet popullor*» (botimi gjermanisht i «*Unsere Ziele*»; 1886, f. 14).

Kjo është shtypur në botimin e *nëntë* (e nëntë!) të broshurës së Bebelit! Nuk është për t' u çuditur që socjaldemokracija gjermane i thëthin këto arësyetime oportuniste të përsëritura me kaqë këmbëngulje, sidomos në një kohë kur shpjegimet revolucjonare të Engelsit mbaheshin në sirtar dhe gjithë situata e jetës të bënte të «harroje zakonin» e revolucjonit.

4. *Kritika e projektit të programit të Erfurt-it* [12])

Kritika e projektit të programit të Erfurt-it, që Engelsi i dërgoji Kautskit më 29 qershor 1891 dhe që u botua vetëm 10 vjet më von në «Neue Zeit», nukë munt të lihet me një anë. kur analizojmë doktrinën e marksizmit mi shtetin, pse ajo i kushtohet, sidomos, pikërisht kritikës së pikëpamjeve *oportuniste* të socjal-demokracisë në problemet e organizimit të *shtetit*.

Po përmëndim, *në kalim e sipër* se në çështjet ekonomike Engelsi bën gjithashtu një vrejtje shumë të vjyer, që tregon sesi ay ndiqte me vëmëndje dhe studjonte thellë pikërisht ndryshimet e kapitalizmit modern dhe se si

prandaj ay ka ditur gjer më një farë pike të parashikojë detyrat e epokës sonë imperjaliste. Ja vrejtja: në lidhje me fjalën «mungesë plani» *(Planlosigkeit)*, që përdoret në projektin e programit për të karakterizuar kapitalizmin, Engelsi shkruan;

> ...«Në qoftë se ne hidhemi nga shoqëritë akcjonare në trustet, të cilat nënësntrojnë dhe monopolizojnë degë të tëra të industrisë, atëhere këtu nukë merr funt vetëm prodhimi privat, po edhe mungesa e planit» («Neue Zeit», v. 20, vol. I, 1901-1902, f. 8).

Këtu kemi gjënë më themelore për të çmuar kapitalizmin modern nga pikëpamja teorike, d.m.th. imperjalizmin: kapitalizmi transformohet në *kapitalizëm* monopoli. Kjo e fundit duhet nënëvizuar, pse gabimi më i përhapur është teza reformiste se gjoja kapitalizmi monopolist ose kapitalizmi i monopolit të shtetit *nuk* është *më* kapitalizëm, dhe se munt të quhet tani «socjalizëm shteti» e të tjera si këto. Natyrisht, trustet nukë kanë dhënë, nukë japin gjer më sot dhe nukë do të japin një plan të plotë. Po gjersa trustet na japin një plan, gjersa magnatët e kapitalit llogarisin që më parë proporcjonet e prodhimit në një shkallë nacjonale ose edhe në shkallë internacjonale, gjersa ata e regullojnë prodhimin në bazë të një plani, ne mbetemi gjthënjë në *regjimin kapitalist*, ndonëse në një fazë të re të tij, po, pa dyshim, në regjimin kapitalist. «Afrimi» i një kapitalizmi *të tillë* me socjalizmin për përfaqësonjesit e vërtetë të proletarjatit duhet të jetë një argument në favor të afrimit, të lehtësisë, të mundësisë së realizimit, të ngutësisë së revolucjonit socjalist dhe aspakë një argument për të toleruar mohimin e këtij revolucjoni dhe për të zbukuruar kapitalizmin, siç bëjnë gjithë reformistët.

Po të kthehëmi prapë në problemin e shtetit. Engelsi

na bën këtu tri vrejtje veçanërisht të vjyera: e para, mi problemin e republikës; e dyta, mi lidhjen e problemit nacjonal me organizimin e shtetit; e treta, mi vëtëqeverisjen lokale.

Për sa i takon republikës, Engelsi e bëri këtë qëndrën e gravitetit të kritikës së tij të projektit të programit të Erfurt-it. Dhe po të sjellim ndërmënt ç' rëndësi pati programi i Erfurt-it në gjithë socjal-demokracinë ndërkombëtare, se si ky program u bë një model për gjithë Internacjonalen e Dytë, atëhere munt të themi pa shtuar, se Engelsi kritikon këtu oportunizmin e gjithë Internacjonales së Dytë.

«Kërkesat politike të projektit — shkruan Engelsi — kanë një mungesë të madhe. *Aty mungon ajo* (kursivi është i Engelsit), që pikërisht duhesh thënë».

Dhe më poshtë ay shpjegon se konstitucjoni gjerman është në të vërtetë një kopje e konstitucjonit shumë reakcjonar të v. 1850, se Reichstag-u është, siç shprehesh Wilhelm Liebknecht, «vetëm një fletë fiku e absolutizmit», dhe që të duash të realizosh «transformimin e të gjitha veglave të punës në pronë të përbashkët» në bazë të një konstitucjoni, që konsakron shtetet e vogla dhe federatën e shteteve të vogla gjermanë, është «sheshit një gjë absurde».

«Të prekësh këtë temë, është një gjë e rezikëshme» — shton Engelsi, që e di fare mirë se në Gjermani nukë munt të vinet legalisht ne program kërkesa e republikës. Po Engelsi nukë pajtohet ashtu kollaj me këtë arësyetim evident, me të cilin kënaqen «të gjithë». Engelsi vazhdon: «po, sidoqoftë, i duhet hyrë kësaj pune. Se sa e domosdoshme është kjo gjë, duket pikërisht nga oportunizmi, që po përhapet *(einreissende)* pikërisht tani në pjesën më të madhe të shtypit socjal-demokrat. Nga frika se mos përsëritet ligja kundër socjalistëve, [13]) ose duke sjellë ndërmënt sa deklarata përpara kohës, që u bënë kur ishte në fu-

qi ligja kundër socjalistëve, duan tani që partija të pranojë se regjimi legal i sotmë në Gjermani mjafton për të realizuar në mënyrë paqësore të gjitha kërkesat e saj»..

Që socjal-demokratët gjermanë vepëronin nga frika se mos përsëritesh ligja e jashtëzakonëshme, këtë fakt kryesor Engelsi e vë në plan të parë dhe, pa u stepur, e quan oportunizëm, duke thënë se pikërisht për shkak të mungesës së republikës dhe të lirisë në Gjermani është fare absurde të ëndërrosh për një rrugë «paqësore».

Engelsi është mjaft i matur, sa që të mos i lidhë vetes duart. Ay pranon se në vëndet republikane, ose me lirl shumë të madhe, «munt të merret me mëni» (vetëm «të merret me mënt»!) një çvillim paqësor drejt socjalizmit, po në Gjermani, thotë ay përsëri:

... «në Gjermani, ku qeverija është pothuajse e plotfuqishme, kurse Reichstag-u dhe gjithë institucjonet e tjera të përfaqësisë nukë kanë një pushtet efektif, të proklamosh në Gjermani një gjë të tillë, dhe pa asnjë nevojë, do të thotë t'i heqësh absolutizmit fletën e fikut dhe të mbulosh vetë me trupin tënt atë që është lakuriq»...

Dhe me të vërtetë shumica e madhe e krerëve zyrtarë të partisë socjal-demokrate gjermane, që vuri në «sirtar» këto vrejtje të Engelsit, u treguan si mbulesë e absolutizmit.

...«Një politikë e tillë nukë munt të mos ta shpjerë me kohë partine në një rrugë të gabuar. Në plan të parë vënë çështjet e përgjithëshme politike, çështjet abstrakte dhe kështu mbulojnë problemet konkrete më të afërta, që vetëvetiu dalin në rendin e ditës me ngjarjet e para të mbëdha, me krizën e parë politike. Ç'munt të dalë prej kësaj, veçse që partija në çastin vendimtar pa pritur e pa pandehur të mos dijë se ç'të bëjë, që në çështjet vendimtare të mos ketë në parti qartësi dhe unitet, pse këto çështje nukë janë biseduar kurrë...

«Kjo harresë e pikëpamjeve të mbëdha, esencjale për interesat e çastit dhe të ditës, ky vrap dhe kjo luftë për sukcese të çastit pa marrë parasysn pasojet e pastajme, ky sakrifikim i së arthmes së lëvizjes për të tanishmen, bëhet ndofta për motive «të ndershme». Po kjo është dhe mbetet një oportunizëm, dhe, ndofta, oportunizmi «i ndershëm» është më i rezikshëm se gjithë të tjerët...

Ajo, për të cilën nukë ka asnjë dyshim, është që partija jonë dhe klasa punëtore nukë munt të arrijnë në fuqi veçse me formën politike të republikës demokratike. Bile kjo e fundit eshtë një formë specifike e diktaturës së proletarjatit, siç e tregoji revolucjoni i math frances»..

Engelsi përsërit këtu, duke e vënë në dukje në mënyrë të veçantë, idenë kryesore, që shënon si me një fill të kuq të gjitha veprat e Marksit: republika demokratike është rruga më e shkurtër për diktaturën e proletarjatit Sepse një republikë e tillë, edhe pa çdukur aspak sundimin e kapitalit, dhe si pasojë shtypjen e masave dhe luftën e klasave, shpije në mënyrë të paevituarshme në një zgjerim, çvillim, zbulim dhe ashpërim të tillë të kësaj lufte, sa që mundësija për të kënaqur interesat jetësore të masave të shtypura, po sa që lint në këtë mënyrë, realizohet pa tjetër dhe vetëm në diktaturën e proletarjatit, në udhëheqjen e këtyre masave nga ana e proletarjatit. Kjo për gjithë Internacjonalen e Dytë është «një fjalë e harruar» e marksizmit, dhe këtë harresë e zbuloji në mënyrë jashtëzakonisht të gjallë historija e partisë së menshevikëve në gjysmën e parë të vitit të revolucjonit rus të 1917.

Mi çështjen e republikës federative në lidhje me përbërjen nacjonale të popullsisë Engelsi shkruante:

«Ç'duhet të kemi në vënt të Gjermanisë së sotme?» (me konstitucjonin e saj monarkik reakcjonar dhe me një ndarje po aqë reakcjonare në shtete të vogla, ndarje, që

përjetëson veçoritë e «prusjanizmit», në vënt që t'i shkrijë në një Gjermani si një gjë të tërë). «Sipas mëndjes sime, proletarjati munt të përdorë vetëm formën e një republike, që të jetë një dhe e pandarë. Republika federative ësht edhe sot, përgjithërisht, një gjë e domosdoshme në teritorin kolosal të Shteteve të Bashkuara, ndonëse në Lindje të tij ajo po bëhet që tani një pengesë. Ajo do të ishte një çap përpara në Angli, ku në dy ishuj rrojnë katër kombe dhe, me gjithë unitetin e parlamentit, egzistojnë që tani njëri pranë tjetrit tri legjislacjone të ndryshme. Forma e republikës federative ka kohë që është bërë pengesë për Svicrën e vogel, që e ka mban vetëm sepse Svicra është kënaqur të jetë një mis krejt ësisht pasiv i sistemit të shteteve europjanë. Për Gjermaninë një organizim federalist sipas sistemit sviceran, do të ishte një çap shumë i math prapa. Dy pika e dallojne një shtet federal nga një shtet krejt unitar: e para, çdo shtet më vete, që bën pjesë në federatë, ka një legjislacjon civil dhe penal më vete, ka një organizim të gjyqeve më vete, dhe e dyta, krahas me dhomën popullore egzziston dhoma e përfaqësonjësve të shteteve, dhe në këtë dhomë çdo kanton voton si i tillë, pavarësisht në ësht i math ose i vogël». Në Gjermani shteti federal është kapërximi në një shtet krejt unitar, dhe «revolucjoni që lart» [14]) i viteve 1866 dhe 1870 nuk ë duhet kthyer prapa, po duhet plotësuar me një «lëvizje që poshtë».

Engelsi jo vetëm nuk ë tregohet indiferent kundrejt formave të shtetit, po, përkundrazi, përpiqet të analizojë me kujdesin më të math pikërisht format tranzitore për të caktuar, në lidhje me veçoritë konkrete-historike të çdo rasti të veçantë, ç' kapërxim — *nga dhe ku* — përfaqëson forma tranzitore në fjalë.

Engelsi, si dhe Marksi, mpron, nga pikëpamja e proletarjatit dhe e revolucjonit proletar, centralizmin demokratik, republikën një dhe të pandare. Republikën federative ay e konsideron ose si përjashtim dhe pengesë për çvillimin, ose si kapërxim nga monarkija në republikën e

centralizuar, si «një çap përpara» në disa kondita të veçanta. Dhe në mes të këtyre konditave të veçanta përmëndet çështja nacjonale.

Te Engelsi, si edhe te Marksi, me gjithë kritikën e pamëshirshme të karakterit reakcjonar të shteteve të vogla dhe të maskimit të këtij karakteri reakcjonar me çështjen nacjonale në disa raste konkrete, nukë ka aspakë nonjë tendencë për të mos përfillur çështjen nacjonale, tendencë që është shpesh një mëkatë e marksistëve hollandezë dhe polonezë, të cilët nisen nga lufta krejt legjitime kundër nacjonalizmit të ngushtë mikroborges të shteteve «të tyre» të vogëla.

Edhe në Angli, ku konditat gjeografike, komuniteti i gjuhës dhe një histori prej qindra vjetësh duket sikur «i kanë dhënë funt» çështjes nacjonale të disa pjesëve të vogëla të Anglisë, edhe këtu Engelsi merr parasysh faktin evident që çështja nacjonale egziston akoma, dhe prandaj e konsideron republikën federative si një «çap përpara». Natyrisht, këtu Engelsi nuk heq dorë aspakë nga kritika e të metave të republikës federative dhe as nga propaganda dhe nga lufta e vendosur për një republikë demokratike unitare dhe të centralizuar.

Po Engelsi centralizmin demokratik nuk e kupëton aspakë në kupëtimin burokratik, siç përdoret ky koncept nga ideologët borgezë dhe mikroborgezë, dhe në mes të tyre dhe nga anarkistët. Për Engelsin centralizmi nukë përjashton aspakë një vetëqeverisje lokale të gjërë, e cila, kur «komunet» dhe qarqet mprojnë lirisht unitetin e shtetit, çduk pa tjetër çdo burokratizëm dhe çdo «komandë nga lart».

> «... Republikë unitare pra» — shkruan Engelsi, duke çvilluar pikëpamjet «programatike të marksizmit mi shtetin», — po jo në kupëtimin e republikës së sotme franceze, e cila nuk është gjë tjetër veçse perandorija pa peran-

dor, që u themelua më 1798. Që nga v, 1792 e gjer më 1798 çdo departament frances, çdo komunë (*Gemeinde*) kanë pasur një vetëqeverisje të plotë sipas modelit amerikan, dhe këtë duhet ta kemi edhe ne. Se si duhet organizuar vetëqeverisja dhe se si munt të bëhet pa burokraci, këtë na e ka treguar dhe provuar Amerika dhe republika e parë franceze, dhe tani po na e tregojnë Kanada, Australija dhe koloni të tjera inglize. Një vetëqeverisje e tillë provincjale (e qarqeve) dhe komunale është një institucjon shumë më i lirë nga federalizmi sviceran, për shëmbëll, ku vërtet kantoni është shumë i pavarur kundrejt konfederatës, po është i pavarur gjithashtu edhe kundrejt rethit (*Bezirk*) edhe kundrejt komunës. Qeveritë kantonale emërojnë guvernatorin e rethit (*Bezirksstatthalter*) dhe prefektët, që nukë njihen fare në vëndet me gjuhë inglize dhe që ne në të arhmen duhet t'i çdukim në mënyrë të vendosur, ashtu sikundër dhe këshilltarët prusjanë të provincave dhe të qeverisë» (komisarë, shefa të policisë së rethit, guvernatorë, përgjithërisht funkcjonarë të emëruar nga lart). Engelsi propozon që në konformitet me këtë, pika e programit mi vetëqeverisjen të formulohet në këtë mënyrë: «Vetëqeverisje e plotë në provincë» (departament ose krahinë), «reth dhe komunë me anë funkcjonarësh të zgjedhur në bazë të së drejtës së përgjithëshme të votimit; neqja e të gjitha autoriteteve lokale dhe provincjale të emëruara nga shteti».

Në «Pravda»[15]) Nr. 68, me datë 28 maj 1917 *) që u mbyll nga qeverija e Kerenskit dhe e ministrave të tjerë «socjalistë», unë kam pasur rastin të them se në këtë pikë — natyrisht, jo vetëm në këtë pikë — përfaqësonjësit tanë gjoja-socjalistë të gjoja-demokracisë gjoja-revolucjonare kanë kryer shtëmëngje flagrante *nga demokratizmi*. Kupëtohet që njers, të cilët ishin lidhur në «koalicjon» me borgezinë imperjaliste, të mbetëshin të shurdhër kundrejt këtyre vrejtjeve.

Ka rëndësi shumë të madhe të përmëndim se Engelsi me

---

* Shiko Vol. XX të Veprave, f. 437. Red.

fakte në dorë, me një shëmbëll të një precizjoni shumë të math, heth poshtë paragjykimin e përhapur në mënyrë të jashtëzakonëshme, sidomos në mes të demokracisë mikro-borgeze, se gjoja republika federative do të thotë me domosdo më tepër liri se sa republika e centralizuar. Kjo nuk është e vërtetë. Faktet që bije Engelsi në lidhje me republikën e centralizuar franceze të vjeteve 1792-1798 dhe me republikën federative sviceране, e hedhin poshtë këtë tezë. Republika me të vërtetë e centralizuar ka dhënë *më tepër* liri se sa republika federative. Ose me fjalë të tjera: lirinë *më të madhe* lokale, krahinore e të tjera, që ka parë historija, e ka dhënë republika e *centralizuar* dhe jo republika federative.

Po këtij fakti, si edhe përgjithërisht gjithë problemit të republikës federative dhe të centralizuar dhe të vetëqeverisjes lokale, nuk i është kushtuar dhe nuk i kushtohet vëmëndja e duhur në propagandën dhe në agjitacjonin tonë të partisë.

5. *Parathënja e vitit 1891 për «Luftën Civile» të Marksit*

Në parathënjen për botimin e tretë te «Luftës civile në Francë» — kjo parathënje mban datën 18 mars 1891 dhe u botua për herë të parë në rivistën «Neue Zeit» — Engelsi, krahas me vrejtje interesante të rastit mi çështje, që kanë të bëjnë me qëndrimin kundrejt shtetit, bën një përmbledhje të mësimeve të Komunës në mënyrë shumë të gjallë. Kjo përmbledhje, e pasuruar nga gjithë eksperjenca e një periode njëzet vjetshe, që ndan autorin nga Komuna, dhe që është drejtuar në mënyrë të veçantë kundër «adhurimit bestytë të shtetit» të përhapur në Gjermani, munt të quhet me të drejtë *fjala e fundit* e marksizmit më çështjen në fjalë.

«Në Francë, — thotë Engelsi, — punëtorët pas çdo revolucjoni kanë qënë të armatosur; prandaj për borgezët, që kishin frenat e shtetit, kujdesi i parë ka qënë çarmatosja e punëtorëve. Kështu, pas çdo revolucjoni të fituar prej punëtorëve, fillonte një luftë e re, që mbaronte me disfatën e punëtorëve»...

Bilani i eksperjencës së revolucjoneve borgeze është aqë i shkurtër sa edhe shprehës. Këtu thelbi i problemit — ashtu si dhe në problemin e shtetit (*a ka armë klasa e shtypur?*) — është kapur në mënyrë të admiruarshme. Pikërisht për këtë esencë heshtin më tepër si profesorët, që gjënden nënë influencën e ideologjisë borgeze, ashtu edhe demokratët mikroborgezë. Në revolucjonin rus të v. 1917 i takoji nderi (nderi i një Cavaignac-u [16]), për të nxjerrë në shesh këtë sekret të revolucjoneve borgeze, «menshevikut» dhe «gjithashtu-marksistit» Cereteli. Ne fjalimin e tij «historik» të 9 qershorit Cereteli foli për vendosjen e borgezisë për të çarmatosur punëtorët e Petrogradit, duke e paraqitur, natyrisht, këtë vendim edhe si të tijnë edhe si një nevojë «të shtetit» përgjithërisht!

Fjalimi historik i Ceretelit më 9 qershor, natyrisht, do të jetë për çdo historjan të revolucjonit të v. 1917 një nga shëmbëllat më të kjarta se si blloku i eserëve dhe i menshevikëve, që ishte drejtuar nga zoti Cereteli, u hoth nga ana e borgezisë *kundër* proletarjatit revolucjonar.

Një tjetër vrejtje e rastit e Engelsit, që është lidhur gjithashtu me problemin e shtetit, ka të bëjë me fenë. Dihet se socjal-demokracija gjermane sa më tepër kalbesh, sa më tepër bëhesh oportuniste, aqë më shpesh binte në një interpretim të gabuar filistin të formullës së famëshme: «feja është një çështje private». Kjo formullë interpretohesh në mënyrë që gjoja *nga pozicioni i partisë* e proletarjatit revolucjonar çështja e fesë është një çështje private! Kundër

kësaj trathëtije të plotë të programit të proletarjatit u ngrit Engelsi, i cili më 1891 shihte vetëm elemente *shumë të dobëta* të oportunizmit në partinë e tij dhe prandaj shprehesh në mënyrë shumë të matur:

«Në përshtatje me faktin që në Komunë kishte pothuajse vetëm punëtorë ose përfaqësonjës të njohur të punëtorëve, edhe vendimet e saja kishin një karakter të theksuar proletar. Ose këto vendime dekretonin reforma të tilla, prej të cilave borgezija republikane kishte pasë hekur dorë vetëm nga frika dhe poshtërsija, dhe të cilat përbënin bazën e domosdoshme të aktivitetit të lirë të klasës punëtore. Kështu për shëmbëll realizimi i parimit, sipas të cilit feja *në raport me shtetin* është vetëm një çështje private, ose Komuna çpallte vendime, që ishin drejt për drejt në interesën e klasës punëtore dhe që pjesërisht preknin thellë rendin e vjetër shoqëror» ..

Engelsi i ka theksuar me qëllim fjalët «në raport me shtetin» duke goditur drejt për drejt oportunizmin gjerman, që e kish deklaruar fenë një çështje private *në raport me partinë* dhe kështu e kish zbritur partinë e proletarjatit revolucjonar që gier në shkallën e filistinizmit të «mendimtarëve të lirë» më vulgarë, që është gati të pranojë qëndrimin jashtë fesë, po që heq dorë nga detyra e partisë për të lëftuar kundër opjumit fetar që budalleps popullin.

Historjani i nesërm i socjal-demokracisë gjermane, duke analizuar rrënjët e falimentimit të saj të turpshëm më 1914, do të gjejë mjaft materjal interesant mi këtë çështje, duke filluar nga deklaratat evazive në artikujt e kryetarit ideologjik të partisë, Kautskit, deklarata që i hapnin dyert oportunizmit, dhe duke mbaruar me qëndrimin e partisë kundrejt «Los-von der Kirche-Bewegung» (lëvizjes për ndarjen nga kisha) më 1913.

Po të shohim se si përmblithte Engelsi njëzet vjet pas Komunës mësimet e saja për proletarjatin në luftë.

Ja ç' mësime vinte në plan të parë Engelsi:

... «Pikërisht fuqija shtypëse e qeverisë së centralizuar, që kishte egzistuar më parë, ushterija, policija politike, burokracija, që krijoji Napoleoni më 1798 dhe që pastaj çdo qeveri e re e kish pranuar si një vegël të dëshëruar dhe e kish përdorur kundër kundërshtarëve të saja, pikërisht kjo fuqi duhesh të binte kudo në Francë, siç kishte rënë në Paris.

«Komunes iu desh të pranonte që në fillim se klasa punëtore, me ardhjen në fuqi, nukë munt të qevariste më me maqinën e vjetër të shtetit; për të mos humbur përsëri sundimin, që sa po kish fituar, klasa punëtore duhesh, nga një anë, të çdukte gjithë maqinën e vjetër, që ishte përdorur gjer ahere kundër saj, dhe nga ana tjetër, duhesh të merrte masa sigurimi kundër deputetëve dhe funkcjonarëve të saj duke çpallur se të gjithë, pa përjashtim, munt të hiqeshin në çdo çast» ..

Engelsi thekson shumë herë se shteti mbetet një shtet jo vetëm në regjimin e monarkisë, po edhe në *republikën demokratike*, d. m. th. ruan tiparin kryesor karakteristik të tij: transformimin e funkcjonarëve, «shërbëtorëve të shoqërisë», të organeve të shoqërisë *në zotërinj* të shoqërisë.

...,«Kundër këtij transformimi të shtetit dhe të organeve të shtetit nga shërbëtorë të shoqërisë në zotërinj të shoqërisë, kundër këtij transformimi të paevituarshëm në të gjitha shtetet që kanë egzistuar gjer më sot, Komuna përdori dy mjete të sigurta E para, ajo emëroji në të gjitha detyrat e administratës, të gjyqit, të arësimit persona të zgjedhura në bazë të së drejtës së përgjithëshme të votimit dhe përveç kësaj futi dhe të drejtën e heqjes së tyre në çdo kohë me vendim të zgjedhësve të tyre. Dhe e dyta, ajo u pagoji gjithë funkcjonarëve të lartë dhe të unjët vetëm një rrogë të barabartë më mëditjen e punëtorëve të tjerë. Rroga më e madhe, që pagoji përgjithërisht Komuna,

ka qënë 6000 fr.* Kështu u krijua një pengesë e sigurt kundër gjahut për ofiqe dhe kundër karjerizmit, edhe pa mandatet imperative[17]) për deputetët në institucjonet e përfaqësisë, që vuri Komuna»....

Engelsi arrin këtu në atë kufi interesante, ku demokracija konsekuente, nga një anë, *transformohet* në socjalizëm, dhe ku ajo, nga ana tjetër, *kërkon* socjalizmin. Pse për çdukjen e shtetit duhet transformimi i funkcjoneve të shërbimit shtetëror në operacjone të thjeshta kontrolli dhe evidence, që munt t'i bëjë shumica e madhe e popullsisë dhe më von gjithë popullsija. Dhe për çdukjen e plotë të karjerizmit duhet që ofiqet «e nderit», edhe kur nukë çpërblehen, të *mos* munt të shërbejnë si një sustë për të kër cyer në ofiqe të majme, në bankat dhe në shoqëritë akcjonare, siç ndoth *gjithënjë* në të gjitha vëndet kapitaliste, edhe në vëndet më të lira.

Po Engelsi nukë bën gabimin që bëjnë, për shëmbëll, disa marksistë në çështjen mi të drejtën e kombeve për vetëvendosje: gjoja ajo në regjimin kapitalist nukë munt të realizohet, kurse në regjimin socjalist është e tepërt. Një arësyetim i tillë, gjoja i hollë, po në realitet i gabuar, munt të aplikohet për çdo institucjon demokratik, edhe për rrogën modeste të funkcjonarëve, pse në regjimin kapitalist nukë munt të ketë një demokraci gjer në funt konsekuente, dhe në regjimin socjalist çdo demokraci *do të shuhet*.

Ky është një sofizëm, që i shëmbëllen një shakaje të

---

* Sipas kursit nominal kjo bën afro 2400 rubla, dhe sipas kursit aktual afro 6000 rubla. Bëjnë një gabim që nukë munt të falet ata bolshevikë, që propozojnë, për shëmbëll në këshillat bashkijake, një rrogë prej 9000 rubla, në vënt që të propozojnë për gjithë shtetin një maksimum prej 6000 rublash, që është një shumë e mjaf ë.

vjetër : a bëhet njeriu tullac, në qoftë se ay do të këtë një flok më pakë ?

Çvillimi i demokracisë *gjër në funt*, të kërkuarit e *formave* të këtij çvillimi, të provuarit e tyre në *praktikë* etj., — të gjitha këto janë një nga detyrat integrante të luftës për revolucjonin shoqëror. Po ta marrësh më vete, asnjë demokratizëm nukë na jep socjalizmin, po demokratizmi në jetë kurrë nukë do të merret «më vete», po do të merret «në tërësi», do të influencojë dhe mi ekonominë, do të nxisë transformimin e *saj*, do të pësojë influencën e çvillimit ekonomik etj... Kjo është djalektika e historisë së gjallë.

Engelsi vazhdon :

> ... «Kë'a të hedhur në erë (*Sprengung*) të pushtetit të vjetër shtetëror dhe zevëndësimi i tij me një pushtet të ri, me të vertet demokratik, përshkruhet me hollësi në pjesën e tretë të «Luftës civile». Po këtu ishte e domosdoshme që të flisnim edhe një herë mi disa karakteristika të këtij zëvëndësimi, pse pikërisht në Gjermani adhurimi bestytë i shtetit ka shkuar nga filozofija në ndërgjegjen e gjithë borgezisë dhe bile të shumë punëtorëve. Sipas doktrinës së filozofëve, shteti është «realizimi i idesë», ose përkthimi në gjuhën filozofike i mbretërisë së zotit mi tokë, shteti është një shesh ku realizohet ose duhet të reallzohet e vërteta dhe drejtësija e përjetëshme. Dhe këtej rjeth respekti bestytë kundrejtë shtetit dhe kundrejt çdo gjëje që ka të bëjë me shtetin — respekt bestytë që rrënjoset aqë më lehtë, sa më tepër njerëzit mësohen që në vegjëli të mendojnë se gjoja punët dhe interesat e përbashkëta të shoqërisë nukë munt të kryhen dhe të ruhen përveç se me mënyrën e vjetër d. m th. me anë të shtetit dhe të funkcjonarëve të tij, që shpërblehen me ofiqe të majme. Njerzit kujtojnë se ata bëjnë një çap jashtëzakonisht të math përpara, kur shpëtojne nga besimi në monarkinë trashëgimtare dhe bëhen partizanë të republikës demokratike. Kurse në të vërtetë shteti nuk esht ë një gjë tjetër veçse një maqinë për shtyp-

jen e një klase nga një tjetër, dhe në republikën demokratike jo më pake se në monarki. Në rastin më të mirë shteti është një e keqe, që i mbetet proletarjatit me trashëgim pas fitores së tij në luftë për sundimin e tij si klasë; proletarjati fitimtar, ashtu si dhe Komuna, do të detyrohet menjëherë të çdukë anët më të këqija të kësaj së keqe, gjersa në kondita të reja dhe të lira shoqërore të mos rritet një bres, që të jetë në gjëndje ta hedhë poshtë gjithë këtë rangallë, që quhet shtet».

Engelsi i paralajmëroji gjermanët, që ata në rast se do të zëvëndësonin monarkinë me republikën, të mos harronin parimet e socjalizmit në çështjen e shtetit përgjithërisht. Këto paralajmërime u drejtohen tani drejt për drejt si një mësim zotërinjve Cereteli dhe Çernov, që kanë treguar në praktikën e tyre të «koalicjonit» një besim bestytë në shtetin dhe një respekt bestytë kundrejt tij!

Ehhe dy vrejtje. 1) Kur thotë Engelsi se në republikën demokratike shteti mbetet «një makinë shtypjeje të një klase nga një klasë tjetër» «jo më pakë» se në monarki, kjo nukë do të thotë aspakë se për proletarjatin është një gjë indiferente forma e shtypjes, siç «na mësojnë» disa anarkistë. Një *formë* më e gjerë, më e lirë, më e hapët e luftës së klasëve dne e shtypjes së klasëve ja lehtëson proletarjatit në një masë shumë të madhe luftën e tij për të çdukur klasat përgjithërisht.

2) Përse brezi i ri është në gjëndje që ta hedhë poshtë krejt këtë rangallë, që quhet shtet? Kjo çështje është lidhur me problemin e kapërximit të demokracisë për të cilin do të flasim këtu poshtë.

6. *Engelsi mi kapërximin e demokracisë*

Engelsit i është dashur të flasë mi këtë gjë në lidhje me çështjen e emrit «socjal-demokrat» si një emër që s' ësht egzakt nga pikëpamja shkencore.

Në parathënjen që i bën botimit të artikujve të tij të shkruar më 1870-1880 mi tema të ndryshme, sidomos me përmbajtje «internacjonale» («Internationales aus dem Volksstaat» *) — parathënje, që mban datën 3 janar 1894, d. m. th. se është shkruar një vit e gjysëm përpara vdekjes së Engelsit — ay shkruante se në të gjithë artikujt përdoret fjala «komunist» dhe jo «socjal-demokrat», pse atëhere socjal-demokratë quheshin proudhonistët në Francë dhe lassaljanët në Gjermani.

> ...,... «Prandaj për mua dhe për Marksin — vazhdon Engelsi — ishte e pa mundëshme të përdornim për të treguar pikëpamjen tonë të veçantë një shprehje kaqë të llastiktë. Sot puna qendron ndryshe, dhe kjo fjalë («socjal-demokrat») munt edhe të vejë *(mag passieren)*, me gjithë se ajo mbetet jo egzakte *(unpassend*, e papërshtateshme) për një parti, programi ekonomik i së cilës nuk është përgjithërisht vetëm socjalist, po drejt për drejt komunist, — për një parti, qëllim i fundit i së cilës është kapërximi i çdo shteti përgjithërisht dhe, si pasojë, edhe i demokracisë. Po emrat e partive politike *të vërteta* (kursivi është i Engelsit) kurrë nuk u përshtaten plotërisht këtyre; partija çvillohet, emri mbetet».

Djalektiku Engels në perëndim të ditëve të tija mbetet besnik i djalektikës. Ne me Marksin, thotë ay, kishim një emër shumë të bukur, shkencërisht egzakt, po nukë kishim një parti proletare të vërtetë, d. m. th. një parti proletare masash. Tani (fundi i shek. XIX) egziston një parti e vërtetë, po emri i saj nuk është egzakt nga pikëpamja shkencore. S'ka gjë, «munt të vejë», vetëm partija të çvillohet, vetëm karakteri jo-egzakt nga pikëpamja shkencore i emrit të saj të mos t'i fshihet asaj dhe të mos e pengojë të çvillohet në drejtim të mbarë!

---

* Mi tema internacjonale nga «Shteti Popullor». Red.

Ndofta nonjë shakaxhi do të na ngushëllonte edhe ne bolshevikët në mënyrën e Engelsit: ne kemi një parti të vërtetë, ajo po çvillohet fare mirë; «munt të vejë» * dhe një fjalë kaqë absurde, kaqë e shëmtuar si «bolshevik», që nukë shpreh asgjë fare, përveç rrethanës thjesht të rastit që në kongresin që u bë në Bruksel-Londër më 1903 ne patëm shumicën [18]) ... Ndofta tani, kur persekutimet e korrikut dhe të gushtit kundër partisë sonë nga ana e republikanëve dhe nga demokracija mikroborgeze «revolucjonare», e bënë fjalën «bolshevik» një gjë të respektuar nga gjithë populli; tani që këto ngjarje kanë shënuar përveç kësaj një çap kaqë të math përpara, një çap historik, që ka bërë partija jonë në çvillimin e saj *të vërtetë*, tani ndofta edhe unë do të lëkundesha në propozimin tim të prillit për të ndryshuar emrin e partisë sonë. Ndofta unë do t'u propozoja shokëve të mij një «kompromis»: të quhemi parti komuniste dhe në kllapa të mbetet fjala bolshevikë...

Po çështja e emrit të partisë ka rëndësi pa krahasim më pakë se çështja e qëndrimit të proletarjatit revolucjonar kundrejt shtetit.

Në arësyetimet e zakonëshme mi shtetin bëhet gjithënjë ay gabim, prej të cilit Engelsi na këshillon këtu të ruhemi, dhe që e kemi përmendur edhe ne kalimthi më sipër: harrojnë gjithënjë se çdukja e shtetit është gjithashtu çdukja e demokracisë, se shuarja e shtetit është shuarja e demokracisë.

Në një vështrim të parë një tezë e tillë duket fare e çuditëshme dhe e pakupëtuarshme; ndofta ndokujt do t'i hyjë dhe frika se mos presim ne ardhjen e një rendi të tillë shoqëror, ku nukë do të respektohet parimi i nënështrimit të pakicës kundrejt shumicës, pse, fundi, demokracija është pranimi i këtij parimi.

---

*Në dorëshkrim; «bile». Red.

Jo. Demokracija *nuk është* identike me nënështrimin e pakicës kundrejt shumicës. Demokracija është një *shtet* që pranon nënështrimin e pakicës kundrejt shumicës, d. m. th. është organizimi i *dhunës* sistematike të një klase kundër një klase tjetër, të një pjese të popullsisë kundër pjesës tjetër.

Ne kemi si qëllim të fundit çdukjen e shtetit, d. m. th. çdukjen e çdo dhune të organizuar dhe sistematike, çdukjen e çdo dhune kundër njeriut përgjithërisht. Ne nukë presim ardhjen e një rendi të tillë shoqëror, ku nukë do të respektohet parimi i nënështrimit të pakicës kundrejt shumicës. Po duke patur si aspiratë socjalizmin, ne jemi të bindur se socjalizmi do të transformohet në komunizëm, dhe në lidhje me këtë do të çduket përgjithërisht nevoja e dhunës kundër njeriut përgjithërisht, nevoja e nënështrimit të një njeriu kundrejt tjetrit, të një pjese të popullsisë kundrejt pjesës tjetër, pse njerzit *do të mësohen* të respektojnë konditat elementare të jetës publike *pa dhunë* dhe *pa nënështrim*. Pikërisht për të theksuar këtë element të zakonit, Engelsi flet për *brezin* e ri, «që do të rritet në kondita të reja dhe të lira shoqërore dhe që do të jetë në gjëndje të hedhë poshtë krejt këtë rangallë, që quhet shtet», shtetin përgjithërisht, dhe prandaj edhe shtetin e republikes demokratike.

Për të sqaruar këtë pikë duhet të analizojmë problemin e bazave ekonomike të shuarjes së shtetit.

KAPITULLI V.

BAZAT EKONOMIKE TË SHUARJES SË SHTETIT

Shpjegimi më i gjerë i këtij problemi gjëndet te Marksi në «Kritikën e programit të Gotha-s» (letra për Bracke-n me datë 5 maj 1875, shtypur vetëm më 1891 në «Neue Zeit», IX,I; rusisht doli në dritë në një botim të veçantë). Pjesa polemike e kësaj vepre të shënuar, ku kritikohet lassaljanizmi, si të thuash, e ka mbuluar me hije pjesën e saj pozitive: analizën e raportit në mes të çvillimit të komunizmit dhe të shuarjes së shtetit.

1. *Si e shtron problemin Marksi*

Po të krahasohen për cipe letra e Marksit për Bracke-n me datë 5 maj 1875 dhe letra e Engelsit për Bebelin me datë 28 mars 1875, që pamë më sipër, munt të duket sikur Marksi është shumë më tepër «partizan i shtetit» se sa Engelsi dhe sikur ka një ndryshim shumë të math në mes të pikëpamjeve të këtyre dy shkrimtarëve mi shtetin.

Engelsi i propozon Bebelit që të hidhen poshtë krejt pallavrat mi shtetin, të hiqet fare fjala shtet nga programi, të zëvëndësohet me fjalën «Komunë»; Engelsi thotë bile se Komuna nukë ka qënë një shtet në kupëtimin e vërtetë. Kurse Marksi flet edhe për «shtetin e artnmë të shoqërisë komuniste», d. m. th. sikur pranon nevojën e shtetit edhe në regjimin komunist.

Po një kuptim i tillë do të ishte i gabuar në themel. Një studim më i thellë tregon se pikëpamjet e Marksit dhe të Engelsit mi shtetin dhe mi shuarjen e tij koincidojnë plotërisht, kurse shprehja e Marksit, që përmendëm, ka të bëjë pikërisht me shtetin në shuarje e sipër.

Është e qartë se nukë munt të bëhet fjalë për të caktuar çastin e «shuarjes» *së arthme*, aqë më tepër që dihet që më parë, se ajo është një proces i gjatë. Ay ndryshim që egziston në dukje në mes të Marksit dhe të Engelsit shpjegohet me ndryshimin e subjekteve, që ata trajtonin, të qëllimeve, që ata ndiqnin. Engelsi kishte për qëllim t'i provonte Bebelit në mënyrë të qartë, të prerë, në vija të mbëdha absurditetin e paragjykimeve kurente (që kishte Lassall-i në një masë të gjërë) mi shtetin. Marksi e prek *këtë* problem vetëm kalimthi, pse e interesón një subjekt tjetër: *çvillimi* i shoqërisë komuniste.

Gjithë teorija e Marksit është një aplikim i teorisë së çvillimit në formën e saj më konsekuente, më të plotë, më të thellë dhe me substancjale — me kapitalizmin e sotmë. Natyrisht se për Marksin shtrohesh dhe problemi i aplikimit të kësaj teorije për përmbysjen e *arthme* të kapitalizmit dhe për çvillimin e *arthmë* të komunizmit të *arthmë*.

Mi ç'*të dhëna* munt të bazohet problemi i çvillimit të nesërm të komunizmit të nesërm?

Munt të bazohemi mi faktin që ay *rjeth* nga kapitalizmi, çvillohet historikisht nga kapitalizmi, është rezultati i veprimeve të një force shoqërore, që është *pjella* e kapitalizmit. Marksi nukë mundohet aspakë të çpikë utopira, të hedhë fall më kot për një gjë që nukë munt të dihet. Marksi shtron problemin e komunizmit si një naturalist do të shtronte problemin e çvillimit, për shëmbëll, të një lloji të ri biologjik, sa po që dimë origjinën e tij dhe drejtimin e evolucjonit të tij.

Marksi pikësëpari hedh poshtë konfuzjonin që shkakton programi i Gotha-s në çështjen e raportit në mes të shtetit dhe të shoqërisë.

..... «Shoqërija e sotme — shkruan ay — është shoqërija kapitaliste, që egziston në të gjitha vëndet e qyteteruara në një formë pak' a shumë të lirë nga elementet mesjetare, në një formë pak' a shumë të modifikuar nga veçoritë e çvillimit historik të çdo vëndi, në një formë pak' a shumë të çvilluar. Përkundrazi, «shteti i sotmë» ndryshon me ndryshimin e kufive të shtetit. Në perandorinë prusjano-gjermane ay është fare ndryshe, nga ç'është në Svicër; në Angli është fare ndryshe, nga ç'është në Shtetet e Bashkuara. Pra «shteti modern» është një fikcjon.

«Po, me gjithë variietetin laraman të formave të tyre, shtetet e ndryshme të qytetëruara kanë në mes të tyre, një gjë të perbashkët: ato ngrihen mi bazën e shoqërisë së sotme borgeze, të një shoqërije të çvilluar pak' a shumë nga pikëpamja kapitaliste. Prandaj ato kanë disa tipare esencjale të përbashkëta. Në këtë kuptim mund të flasim «për shtetin e sotmë» në kundrështim me kohën e arthme, kur do të çduket rrënja e tij e sotme, shoqërija borgeze.

«Pastaj problemi shtrohet kështu: ç'ndryshim do të pësojë shteti në shoqërinë komuniste? Me fjalë të tjera; ç'funkcjone shoqërore, që i ngjasin funkcjoneve të shtetit të sotmë, do të mbeten atëhere? Kësaj pyetje mund t'i jepet një përgjigje vetëm në mënyrë shkencore; dhe sa do që ta kombinojmë fjalën «popull» me fjalën «shtet», qoftë dhe me mijra herë, kjo nuk e shpije përpara as edhe një grimë zgjidhjen e saj»...

Duke u tallur në këtë mënyrë me të gjitha pallavrat mi «shtetin popullor», Marksi shtron problemin, dhe si kur do të paralajmërojë se ky problem mund të zgjidhet në mënyrë shkencore vetëm duke u bazuar në të dhëna shkencore të konstatuara mirë.

Fakti i parë, që është konstatuar në mënyrë fare egzakte nga gjithë teorija e çvillimit, nga gjithë shkenca

përgjithërisht, — dhe që e harruan utopistët, që e harrojnë oportunistët e sotmë, që kanë frikë nga revolucjoni socjalist, — është ky fakt: nga pikëpamja historike është një gjë e sigurt se duhet të kalë një fazë të veçantë ose një etapë të veçantë kapërximi prej kapitalizmit në komunizem.

2. *Kapërximi prej kapitalizmit në komunizëm*

> ...,«Në mes të shoqërisë kapitaliste dhe komuniste — vazhdon Marksi — shtrihet perioda e transformimit revolucjonar të së parës në të dytën. Kësaj periode i përgjigjet dhe një periodë politike kapërximi, dhe shteti i kësaj periode nukë munt të jetë tjetër gjë, veçse *një diktaturë revolucjonare e proletarjatit*»...

Ky përfundim pështetet te Marksi mi analizën e rolit që luan proletarjati në shoqërinë e sotme kapitaliste, mi të dhënat e çvillimit të kësaj shoqërije dhe mi karakterin e papajtuarshëm të interesave antagoniste në mes të proletarjatit dhe të borgezisë.

Më parë problemi shtrohesh kështu: për të realizuar çlirimin e tij, proletarjati duhet të përmbysë borgezinë, të marrë në dorë pushtetin politik, të vendosë diktaturën e tij revolucjonare.

Tani problemi shtrohet pakë ndryshe: kapërximi nga shoqërija kapitaliste, që çvillohet drejt komunizmit, në shoqërinë komuniste, nukë munt të bëhet pa «një periodë politike kapërximi», dhe si shtet i kësaj periode munt të jetë vetëm diktatura revolucjonare e proletarjatit.

Po cili është qëndrimi i kësaj diktature kundrejt demokracisë?

Ne pamë se «Manifesti Komunist» vë pranë njëra me

sjetrën dy nocjone: «transformimin» e proletarjatit në klasë sundonjëse» dhe «fitimin e demokracisë». Në bazë të asaj që thamë më sipër, munt të caktojmë në mënyrë më egzakte se si ndryshohet demokracija në periodën e kapërxhimit nga kapitalizmi në komunizëm.

Në shoqërinë kapitaliste, në konditat më të favorëshme të çvillimit të saj, ne kemi një demokraci pak' a shumë të plotë në republikën demokratike. Po kjo demokraci është gjithënjë e shtrënguar në rethin e ngushtë të çfrytëzimit kapitalist dhe prandaj mbetet gjithënjë, në esencë, një demokraci për pakicën, vetëm për klasat kamëse, vetëm për të pasurit. Lirija e shoqërisë kapitaliste mbetet gjithënjë pothuajse ashtu siç ishte lirija në republikat e vjetra greke: liri për pronarët e skllevërve. Skllevërit e sotmë, skllevërit me mëditje, për shkak të konditave të çfrytëzimit kapitalist, mbeten aqë të shtypur nga nevoja dhe nga varfëria, sa që «nukë kanë nge për demokraci», «nukë kanë nge për politikë», sa që në një kohë të zakonëshme, në një kohë paqeje shumica e populisisë mbetet jashtë jetës politike dhe shoqërore.

Se sa i drejtë është ky pohim, provohet në mënyrën më të qartë, ndofta, nga Gjermanija pikërisht pse në këtë shtet legaliteti konstitucjonal ka qëndruar për një kohë çuditërisht të gjatë dhe në mënyrë çuditërisht konstante pothuajse një gjysmë shekulli (1871-1914), kurse socjal-demokracija ka mundur «të përfitojë nga legaliteti» shumë më tepër se në vëndet e tjera dhe të organizojë një pjesë shumë të madhe të punëtorëve në një parti politike, si në asnjë vënt tjetër në botë.

Sa e madhe është kjo pjesë e skllevërve me mëditje, që janë politikisht të ndërgjegjshëm dhe aktivë, — më e larta pjesë që është vënë re në shoqërinë kapitaliste? Një miljon anëtarë të partisë socjal-demokrate — nga 15.000.000

punëtorë me mëditje! Tre miljonë të organizuar në sindikata — nga 15 000.000!

Demokraci për një pakicë shumë të vogël, demokraci për të pasurit, — kjo është demokracija e shoqërisë kapitaliste. Po ta shikojmë për së afërmi mekanizmin e demokracisë kapitaliste, do të shohim kudo, edhe në hollësitë «e vogla», gioja të vogëla, të së drejtës së votimit (kushti i vëndbanimit, përjashtimi i grave etj.), edhe në teknikën e institucjoneve të përfaqësisë, dhe në pengesat efektive për të drejtën e mbledhjeve (ndërtesat publike nukë janë për «fukarenjtë»!), dhe në organizimin thjesht kapitalist të shtypit të përditshëm e të tjera, e të tjera, kudo, do të shohim kufizime mi kufizime të demokracisë. Këto kufizime, përjashtime, qëbime dhe pengesa për të varfërit duken të vogëla, sidomos për syrin e atyre, që vetë nukë kanë provuar kurrë ç'është nevoja dhe nukë kanë qënë kurrë afër me klasat e shtypura dhe me jetën e masave (të tullë janë nëntë mi dhjetë, në mos nëntëdhjetë e nëntë mi njëqint të publicistëve dhe të politikanëve borgezë), — po në tërësinë e tyre këto kufizime i përjashtojnë, i largojnë të varfërit nga politika, nga pjesëmarrja aktive në demokraci.

Marksi e ka kupëtuar fare bukur këtë *esencë* të demokracisë kapitaliste, kur thotë në analizën e tij të eksperiencës së Komunës: të shtypurve u lejojnë në disa vjet një herë të vendosin se cili pikërisht nga përfaqësonjësit e klasës shtypëse do t'i përfaqësojë dhe do t'i shtypë në parlament!

Po përparimi nga kjo demokraci kapitaliste, që është domosdo e ngushtë, që largon fshehurazi të varfërit dhe që është prandaj funt e krye hipokrite dhe gënjeshtare, «në një demokract gjithënjë më të madhe» nukë bëhet në mënyrë të thjeshtë, drejt për drejt dhe pa përpjekje, siç kujtojnë profesorët liberalë dhe oportunistët mikroborgezë.

Jo. Përpariini drejt komunizmit bëhet me anë të diktaturës së proletarjatit dhe ndryshe nukë munt të bëhet, pse nukë ka tjetër klasë dhe tjetër udhë *për të thyer rezistencin* e çfrytëzonjësve kapitalistë.

Diktatura e proletarjatit, d. m. th. organizimi i pararojës së masave të shtypura në klasë sundonjëse për të dërmuar shtypësit, nukë munt të kufizohet vetëm me zgjerimin e demokracisë. *Bashkë* me një zgjerim kolosal të demokracisë, që bëhet *për herë të parë* një demokraci për të varfërit, një demokraci për popullin, dhe jo një demokraci për të pasurit, diktatura e proletarjatit bije një sërë kufizimesh të lirisë për shtypësit, për çfrytëzonjësit, për kapitalistët. Ne ata duhet t'i shtypim për të çliruar njerëzinë nga skllavërija me mëditje, rezistëncën e tyre duhet ta thyejmë me forcë, — pra është e qartë se atje, ku ka shtypje, ku ka dhunë, atje nukë ka liri, nukë ka demokraci.

Engelsi e ka shprehur këtë shumë bukur në letrën për Bebelin, ku thotë, siç e mban mënt këndonjësi, se «proletarjatit i duhet akoma shteti, po jo në interesin e lirisë, po për të shtypur kundrështarët e tij, dhe kur të munt të flitet për liri, atëhere shteti si i tillë pushon së qëni.

Demokraci për shumicën e madhe të popullit dhe shtypje me forcë, d. m. th. përjashtim nga demokracija, për çfrytëzonjësit, për shtypësit e popullit — ky është ndryshimi që pëson demokracija në kohën e kapërximit nga kapitalizmi në komunizëm.

Vetëm në shoqërinë komuniste, ku rezistenca e kapitalistëve do të thyhet në mënyrë definitive, kur kapitalistët do të çduken, kur nukë do të ketë klasa (d. m. th. nukë do të ketë ndryshim në mes të anëtarëve të shoqërisë në raportet e tyre kundrejt mjeteve të prodhimit të shoqërisë), *vetëm* atëhere «çduket shteti dhe *munt të flitet për liri*». Vetëm atëhere munt të ketë dhe do të realizohet një de-

mokraci me të vërtet e plotë, me të vërtet pa kufizime. Dhe vetëm atëhere demokracija fillon të shuhet nga shkaku i thjeshtë që atëhere njerzit, të çliruar nga skllavërija kapitaliste, nga tmerret, barbarizmat, absurditetet, poshtërsitë pa funt të çfrytëzimit kapitalist, *do të mësohen* dalë nga dalë të respektojnë regullat elementare të bashkëjetesës, që njihen me shekuj, që janë përsëritur mijra vjet me radhë në të gjitha shkrimet, t'i respektojnë pa dhunë, pa detyrim, pa nënështrim, *pa një aparat të veçantë* detyrimi që quhet shtet.

Shprehja «shteti *shuhet*» është shumë me vënt, pse ajo tregon edhe karakterin gradual të procesit, edhe karakterin spontan të tij. Vetëm zakoni munt të ushtrojë dhe ushtron padyshim një influencë të tillë, pse ne po shohim reth nesh me miljonëra herë, se sa kollaj mësohen njerzit për të respektuar regullat e bashkëjetesës, që janë të domosdoshme për ta, kur nuk ka çfrytëzim, kur nukë ka asgjë, që të revolton, që shkakton protestë dhe kryengritje, që krijon nevojën e shtypjes.

Kështu: në shoqërinë kapitaliste ne kemi një demokraci të gjymtuar, të varfër, të rreme, një demokraci vetëm për të pasurit, për pakicën. Diktatura e proletarjatit, perioda e kapërximit në komunizëm, na jep për herë të parë një demokraci për popullin, për shumicën, krahas me shtypjen e domosdoshme të pakicës, të çfrytëzonjësve. Vetëm komunizmi është në gjëndje që të na japë një demokraci me të vërtetë të plotë; dhe sa më tepër të jetë e plotë demokracija, aqë më shpejt bëhet e tepër, shuhet vetë-vetiu.

Me fjalë të tjera: në regjimin kapitalist ne kemi një shtet në kupëtimin e vërtetë të fjalës, një maqinë të veçantë shtypjeje të një klase nga një klasë tjetër dhe pikërisht të shumicës nga pakica. Kupëtohet se shtypja sis-

tematike e shumicës së çfrytëzuar nga ana e pakicës çfrytëzonjëse, për të pasur sukces, duhet të jetë shumë mizore, shtazërisht e egër, duhen derdhur lumenj me gjak, nëpër të cilët njerëzija ndjek rrugën e saj nëpër regjimin e skllavërisë, të robërisë së bujkut dhe të punës me mëditje.

Pastaj, në kapërximin nga kapitalizmi në komunizëm shtypja është *akoma* e domosdoshme, po tani është një shtypje e pakicës çtrytëzonjëse nga ana e shumicës së çfrytëzuar. Një aparat i veçantë, një maqinë e veçantë shtypje, «shteti», është *akoma* i domosdoshëm, po tani ky është një shtet transitor, nuk është më një shtet në kupëtimin e vërtetë, pse shtypja e pakicës çfrytëzonjëse nga ana e shumicës së *ish*-skllevërve me mëditje është një punë relativisht aqë e lehtë, e thjeshtë dhe e natyrëshme, sa që do të kushtojë shumë më pakë gjak se sa shtypja e kryengritjeve të skllevërve, të robërve të tokës, të punëtorëve me mëditje, do t'i kushtojë shumë më pak njerëzisë. Kjo shtypje pajtohet me shtrirjen e demokracisë mi shumicën dërmonjëse të popullsisë, dhe kështu nevoja për një *maqinë të veçantë* shtypje fillon të çduket. Natyrisht, çfrytëzonjësit nukë janë në gjëndje ta shtypin popullin pa një maqinë shumë të komplikuar, të destinuar për këtë qëllim, po *populli* munt t'i shtypë çfrytëzonjësit dhe me një «maqinë» shumë të thjeshtë, pothuajse pa «maqinë», pa një aparat të veçantë, vetëm *me organizimin e masave të armatosura* (si Sovjetët e deputetëve të punëtorëve dhe të ushtarëve — e themi këtë duke dalur pakë përpara).

Më në funt, vetëm komunizmi e bën krejt të tepër shtetin, pse *nukë ka njeri* për të shtypur, «nukë ka njeri» në kupëtimin e *klasës*, në kupëtimin e një lufte sistematike kundër një pjese të caktuar të popullsisë. Ne nukë jemi utopistë dhe nukë mohojmë aspakë mundësinë dhe karakterin e paevituarshëm të ekceseve *individuale*,

si edhe nevojën e domosdoshme të shtypjes kundër *këtyre* ekceseve. Po, e para, për këtë gjë nukë duhet një maqinë e veçantë, një aparat i veçantë shtypje; këtë do ta bëjë vetë populli i armatosur me atë thjeshtësi dhe lehtësi, me të cilën një turmë njerzisn të qytetëruar edhe në shoqërinë e sotme i ndan ata që zihen ose nukë lejon që të dhunohet një grua. Dhe, e dyta, ne e dimë se shkaku socjal kryesor i ekceseve, që përbëjnë një shkelje* të regullave të bashkëjetesës, është çfrytëzimi i masave, nevoja dhe varfëria e tyre. Me çdukjen e këtij shkaku kryesor ekceset do të fillojnë «të shuhen» në mënyrë të paevitueshme. Ne nuk e dimë se sa shpejt dhe me ç'rend do të shuhen, po ne e dimë se ato do të shuhen. Me shuarjen e tyre *do të shuhet* edhe shteti.

Marksi, pa u hedhur në utopi, ka përcaktuar me hollësi nga kjo e nesërme atë, që mund të përcaktohet *që sot*, d. m. th.: ndryshimin në mes të fazës (shkallës, etapës) më të unjët dhe më të lartë të shoqërisë komuniste.

3. *Faza e parë e shoqërisë komuniste*

Në «Kritikën e programit të Gotha-s» Marksi heth poshtë me hollësi idenë lassaljane, sipas së cilës punëtorët në regjimin socjalist do ta marrin «të pacënuar produktin e punës» ose «të plotë». Marksi tregon se nga gjithë puna shoqërore e gjithë shoqërisë duhet hequr një fond reserve, një fond për zgjerimin e prodhimit, zëvëndësimin e maqinave «të konsumuara» e të tjera si këto, dhe pastaj nga sendet e konsumit një fond për shpenximet e administratës, për shkollat, spitalet, azilet e pleqve e të tjera si këto.

---

* Në dorëshkrim më pas vjen : «themelore». Red.

Në vënt të frazës së mjergullt, të errët, në vent të frazës së përgjithëshme («punëtorit — produkti i plotë i punës»)- të Lassalit, Marksi konstaton në mënyrë të matur se si shoqërisë socjaliste do t'i duhet të qeverisë punët e saja.. Marksi hyn në analizën *konkrete* të konditave të jetës së kësaj shoqërije, ku nukë do të ketë kapitalizëm, dhe thotë:

> «Ne këtu kemi të bëjmë» (duke analizuar programin e partisë punëtore) «jo me një shoqëri komuniste, që është *çvilluar* mi bazën e saj, po me një shoqëri, që sapo *del* nga shoqërija kapitaliste dhe që prandaj nga çdo pikëpamje — ekonomike, morale dhe intelektuale — mban akoma vulën e shoqërisë së vjetër, nga gjiri i së cilës ajo ka dalë».

Pikërisht këtë shoqëri komuniste, që sapo ka dalë në dritë nga gjiri i kapitalizmit, që mban nga çdo pikëpamje vulën e shoqërisë së vjetër, Marksi e quan fazë «të parë» ose të unjët të shoqërisë komuniste.

Mjetet e prodnimit nukë janë më pronë private e individëve. Mjetet e prodhimit i takojne gjithë shoqërisë. Çdo anëtar i shoqërisë, duke kryer një pjesë të caktuar të punës shoqërisht të domosdoshme, merr nga shoqërija nje dëftesë, ku vërtetohet sasija e punës që ka bërë. Me këtë dëftesë ay merr nga magazitë publike të sendeve të konsumit një sasi korespondente produktesh. Pra, po të heqim sasinë e punës, që vete për fondin publik, çdo punëtor merr nga shoqërija aqë, sa i ka dhënë shoqërisë.

Munt të dukeshe sikur mbretëron «barasija».

Po kur Lassali thotë, duke pasur parasysh këtë rend shoqëror (që zakonisht quhet socjalizëm, po që Marksi e quan fazë të parë të komunizmit), se kjo është «një ndarje e drejtë», një «e drejtë e barabartë e sicilit për një produkt të barabartë pune», Lassali gabohet dhe Marksi tregon se ku qëndron gabimi i tij.

«Ve këtu — thotë Marksi — kemi me të vërtetë një «të drejtë të barabartë», po kjo ësht *akoma* një **«e drejtë borgeze»**, që, si çdo e drejtë, *presupozon pabarazinë*. Çdo e drejtë është aplikimi i një proporcjoni të barabartë për njers të *ndryshmë*, të cilët në realitet nukë janë njësoj, nukë janë baras në mes të tyre ; dhe prandaj «e drejta e barabartë» është një shkelje e barasisë dhe një padrejtësi». Dhe me të vërtet sicilido merr për një pjesë, të barabartë me një tjetër, të punës shoqërore një pjesë të barabartë të prodhimit* shoqëror (duke hequr ato që thamë më sipër).

Mirë po individët nukë janë njësoj; disa janë më të fortë, disa janë më të dobët, disa janë të martuar, disa jo, disa kanë fëmijë më tepër, disa më pakë etj..

> ...«Me një punë të barabartë, — këtë përfundim nxjerr Marksi — pra dhe me një pjesëmarrje të barabartë në fondin publik të konsumit, në realitet njëri merr më tepër se tjetri, është më i pasur se tjetri e të tjera. Për të evituar të gjitha këto, e drejta nukë duhet të jetë e barabartë, po e pabarabartë»...,.

Pra, faza e parë e komunizmit nukë munt të japë drejtësi dhe barasi: ndryshimet në pasuri mbeten, dhe ndryshime të padrejta, po *çfrytëzimi* i njeriut prej njeriut do të jetë i pamundshëm, pse nukë munt të bëhen pronë private *mjetet e prodhimit*, fabrikat, maqinat, toka etj.. Duke hedhur poshtë frazën e errët mikroborgeze të Lassalit mi «barasinë» dhe «drejtësinë» *përgjithërisht*, Marksi tregon rrugën e çvillimit të shoqërisë komuniste, që në fillim *ësht e shtrënguar* të çdukë *vetëm* «padrejtësinë» e përvetësimit të mjeteve të prodhimit nga ana e individëve, po që nuk është në *gjëndje* menjëherë të çdukë padrejtësinë tjetër,

---

* Në dorëshkrim: «produktit». Red.

padrejtësinë e ndarjes së sendeve të konsumit «sipas punës» (dhe jo «sipas nevojave»).

Ekonomistët vulgarë, bashkë me ta edhe profesorët borgezë, edhe Tugani «vnë», i qërtojnë gjithënjë socjalistët se gjoja këta harrojnë pabarasinë e njerëzve dhe «ëndërrojnë» të çdukin këtë pabarasi. Një qërtim i tillë, siç pashohim, provon vetëm injorancën ekstreme të zotërinjve ideologë borgezë.

Marksi jo vetëm konstaton në mënyrë shumë precize pabarasinë e paevituarshme të njerzve, po ay konstaton edhe, se vetëm kalimi i mjeteve të prodhimit në pronë të përbashkët të gjithë shoqërisë («socjalizmi» në kupëtimin e zakonshëm të kësaj fjale) nukë *çduk* mungesat e ndarjes dhe të pabarasisë të «së drejtës borgeze», e cila *vazhdon të sundojë*, me qënë se produkiet ndahen «sipas punës».

> ....«Po këto mungesa — vazhdon Marksi — janë të paevituarshme në fazën e parë të shoqërisë komuniste, ashtu si lint, pas mundimesh të gjata, nga shoqërija kapitaliste. E drejta nukë munt të jetë kurrë më lart se rendi ekonomik dhe çvillimi kultural i kondicjonuar prej tij»....

Kështu, në fazën e parë të shoqërisë komuniste (që zakonisht e quajnë socjalizëm) «e drejta borgeze» *nukë* hiqet krejt, po vetëm pjesërisht, vetëm në atë masë që është bërë revolucjoni ekonomik, d. m. th. vetëm përsa u takon mjeteve të prodhimit. «E drejta borgeze» i konsideron ato si pronë private të individëve. Socjalizmi i bën pronë të përbashkët. *Në këtë masë* — dhe vetëm në këtë masë — «e drejta borgeze» bije.

Po ajo mbetet gjithënjë në pjesën tjetër të saj, mbetet siregullonjës (përcaktonjës) i ndarjes së produkteve dhe i ndarjes së punës në mes të anëtarëve të shoqërisë. «Kush nukë punon, nukë duhet të hajë», ky parim socjalist *tani* është

realizuar; «për një sasi të barabartë pune një sasi të barabartë produktesh» — edhe ky parim socjalist *tani* është realizuar. Po megjithatë këtu nukë kemi *akoma* komunizëm, dhe këtu nukë çduket akoma «e drejta borgeze», e cila njerëzve të pabarabartë për një sasi të pabarabartë pune (të pabarabartë në fakt) u jep një sasi të barabartë produktesh.

Kjo është një «mungesë», thotë Marksi po kjo është e paevituarshme në fazën e parë të komunizmit, pse, pa rënë në utopi, nukë munt të mendojmë se njerzit menjëherë pas përmbysies së kapitalizmit do të mësohen të punojnë për shoqërinë *pa asnjë normë juridike*, përveç asaj, dhe heqja e kapitalizmit nukë na jep *menjëherë* kushtet ekonomike për një ndryshim *të tillë*.

Po përveç «së drejtës borgeze», nukë ka norma të tjera dhe prandaj mbetet akoma nevoja për një shtet, që duke ruajtur pronën e përbasnkët të mjeteve të prodhimit, të ruajë barasinë e punës dhe barasinë e ndarjes së produkteve.

Shteti shuhet, me qënë se kapitalistë nukë ka më, klasa nukë ka më, dhe prandaj nukë munt të *shtypet* nonjë *klasë*.

Po shteti nuk është shuar krejt akoma, pse mbetet mprojtja e «së drejtës borgeze» që konsakron pabarazinë reale. Për shuarjen e plotë të shtetit duhet komunizmi integral.

4. *Faza më e lartë e shoqërisë komuniste*

Marksi vazhdon:

„... «Në fazën më të lartë të shoqërisë komuniste, kur të çduket nënështrimi skllavëronjës i njeriut nën ndarjen e punës; kur të çduket bashkë me të antagonizmi i punës intelektuale dhe fizike; kur puna do të pushojë së qëni vetëm një mjet jetese dhe do të bëhet ajo vetë nevoja e

parë e jetës; kur bashkë me një çvillim të gjithëanshëm të individëve do të shtohen forcat e prodhimit dhe do të rrjedhin me rrymë të plotë të gjitha burimet e pasurisë kolektive, vetëm atëhere munt të kapërxehet krejt horizonti i ngushtë i së drejtës borgeze dhe shoqërija munt të shkruajë mi flamurin e saj: «Sicilido sipas zotësive, sicilit. do sipas nevojave».

Vetëm tani munt të çmojmë plotërisht se sa të drejta janë vrejtjet e Engelsit, kur av tallet pa mëshirë me absurdìtetin e bashkimit të tjalëve «liri» dhe «shtet». Gjersa të ketë shtet, nukë ka liri. Kur do të ketë liri, nukë do të ketë shtet.

Baza ekonomike e shuarjes së plotë të shtetit është një çvillim kaqë i math i komunizmit, saqë çdukɛet çdo antagonizëm në mes të punës intelektuale dhe fizike, pra çduket një nga burimet kryesore të pabarasisë së sotme *shoqërore,* një burim i tillë, që nukë munt të çduket menjëherë, sa po të kthehen mjetet e prodhimit në pronë të përbashkët, sapo të çpronësohen kapitalistët.

Ky çpronësim krijon *mundësinë* për një çvillim kolosal të forcave prodhonjëse. Dhe kur shohim se si që tani kapitalizmi *pengon* pa masë këtë çvillim, kur shohim se sa përpara munt të shkonin punët në bazë të teknikës moderne që është realizuar, ne kemi të drejtë të themi me siguri të plotë se çpronësimi i kapitalistëve do të sjellë me vete në mënyrë të paevituarshme një çvillim kolosal të forcave prodhonjëse të shoqërisë njerëzore. Po se sa shpejt do të bëhet ky përparim, se sa shpejt do të arrijë në çdukjen e ndarjes së punës, në çdukjen e antagonizmit në mes të punës intelektuale dhe të punës fizike, në transformimin e punës në një «nevojë të parë të jetës», këtë ne nuk e dimë dhe nukë munt t'a dimë.

Prandaj ne kemi të drejtë të flasim vetëm për shuar-

jen e paevituarshme të shtetit, duke theksuar zgjatjen e këtij procesi, varësinë e tij nga shpejtësija e çvillimit të *fazës së lartë* të komunizmit, duke lënë fare hapët problemin e afateve ose të formave konkrete të shuarjes, pse nukë ka të dhëna për zgjidhjen e këtyre problemeve.

Shteti munt të shuhet krejt, kur shoqërija të realizojë parimin: «sicilido sipas zotësive, sicilitdo sipas nevojave», d. m. th. kur njerzit do të mësohen aqë mirë të respektojnë regullat kryesore të bashkëjetesës dhe kur puna e tyre do të jetë aqë produktive, sa që ata të punojnë vullnetarisht *sipas zotësive të tyre*. «Horizonti i ngushtë i së drejtës borgeze», që të shtrëngon të llogaritësh me pashpirtësinë e një Shylock-u [20]) se mos punon një gjysmë ore më tepër se tjetri, se mos merr një pagë më të vogël se tjetri, ky horizont i ngushtë atëhere do të kapërxehet. Për ndarjen e produkteve atëhere nukë do të ketë më nevojë që shoqërija të caktojë me norma sasinë e produkteve, që do të marrë çdo njeri: kushdo munt të marrë lirisht «sipas nevojave».

Nga pikpamja borgeze është lehtë ta quash një regjim të tillë shoqëror «utopi të kulluar» dhe të zbardhësh dhëmbët duke thënë se socjalistët i premtojnë kujtdo të drejtën që të marrë nga shoqërija pa asnjë kontroll mi punën e çdo qytetari këpurdha, automobila, pjano etj. sa të dojë. Edhe sot shumica e «dijetarëve» borgezë kufizohen të zbardhin vetëm dhëmbët dhe me këtë ata tregojnë injorancën e tyre dhe mpirjtjen e tyre të interesuar që i bëjnë kapitalizmit.

Injorancë, pse asnjë socjalisti nuk i ka shkuar ndërmënt «të premtojë» ardhjen e fazës së lartë të komunizmit; sa për *parashikimin* e ardhjes së saj nga ana e socjalistëve të mbëdhenj, ky supozon jo një produktivitet të punës *siç është sot* dhe jo borgezin e vogël *të sotmë*, që është i zoti, si bursistët e shkrimtarit Pomjalofski [21]), të prishi «kot» depot e pasurisë publike dhe të kërkojë të pamundëshmen.

Gjersa të vijë faza më «e lartë» e komunizmit, socjalistët kërkojnë nga shoqërija *dhe nga shteti* një kontroll shumë të *rreptë* mi masën e punës dhe mi masën e konsumit, po vetëm ky kontroll duhet *të fillojë* me çpronësimin e kapitalistëve, me kontrollin e punëtorëve mi kapitalistët dhe të bëhet jo nga shteti i funksjonarëve, po nga shteti i *punëtorëve të armatosur*.

Mprojtja e interesuar e kapitalizmit nga ana e ideo'ogëve borgezë (dhe të satelitëve të tyre si z. z. Cereteli, Çernov dhe shokë) qëndron pikërisht në faktin që ata me bisedime dhe me fraza për një të arthme të largët i *shtëmëngen* problemit urgjent dhe aktual të politikës së sotme: çpronësimi i kapitalistëve, transformimi *i të gjithë* qytetarëve në punëtorë dhe nëpunës të një «karteli» të math *unik*, d. m. th.: shteti dhe nënështrimi i plotë i gjithë punës së këtij karteli shtetit me të vërtet demokratik, *shtetit të Sovjetëve të deputetëve të punëtorëve dhe të ushtarëve*.

Në thelb, kur një profesor i ditur, dhe pas tij një filistin, dhe pas tij zotërinjtë Cereteli dhe Çernov flasin për utopira të çmendura, për premtime demagogjike të bolshevikëve, për pamundësinë e «futjes» së socjalizmit, ata kanë parasysh pikërisht shkallën ose fazën më të lartë të komunizmit, të cilin asnjeri, jo vetëm nukë e ka premtuar që ta «fusë», po as që e ka shkuar ndërmënt këtë gjë, pse ay përgjithërisht nukë munt të «futet».

Dhe këtu erdhëm te problemi që ka të bëjë me ndryshimin shkencor në mes të socjalizmit dhe të komunizmit, që Engelsi e ka prekur në arësyetimin e përmëndur më sipër mi emrin e gabuar «socjal-demokratë». Nga pikëpamja politike ndryshimi në mes të fazës së parë ose të unjët dhe të fazës më të lartë të komunizmit me kohë do të jetë, ndofta, shumë i math; po tani në regjimin kapitalist

do të ishte një gjë qesharake ta bësh çështje, dhe vetëm disa anarkistë munt ta vënë në plan të parë (në qoftë se në mes të anarkistëve kanë mbetur akoma njers, që nukë kanë mësuar gjë passi burra si Kropetkin, Grave, Cornelissen dhe «yje» të tjerë të anarkizmit bënë një metamorfozë plehanovjane dhe u kthyen në socjal-shovinistë ose në anarkistë të llogoreve, siç shprehet Gay, një nga ata pakë anarkistë që kanë ruajtur nderin dhe ndërgjegjen).

Po ndryshimi shkencor në mes të socjalizmit dhe të komunizmit është i qartë. Atë, që quajnë zakonisht socjalizëm, Marksi e quajti fazë «të parë» ose të unjët të shoqërisë komuniste. Me qënë se mjetet e prodhimit bëhen pronë *e përbashkët*, fjala «komunizëm» munt të përdoret edhe këtu, po të mos harrojmë se ky *nuk është* një komunizëm i plotë. Rëndësija e madhe e shpjegimeve të Marksit qëndron në faktin që ay edhe këtu aplikon në mënyrë konsekuennte djalektikën materjaliste, teorinë e çvillimit, duke e konsideruar komunizmin si një gjë që çvillohet nga kapitalizmi. Në vënt që të merret me përkufizime të epikura në mënyrë skolastike, me përkufizime «të krijuara» dhe me diskutime shterpe mi fjalet (ç'është socjalizëm, ç'është komunizëm), Marksi analizon ato, që munt të quhen shkallët e pjekurisë ekonomike të komunizmit.

Në fazën e tij të parë, në shkallën e tij të parë, komunizmi nukë munt të jetë plotërisht i arrirë nga pikëpamja ekonomike, nukë munt të jetë plotërisht i lirë nga traditat ose gjurmat e kapitalizmit. Prandaj në fazën e parë të komunizmit kemi atë fenomen interesant siç është ruajtja e «horizontit të ngushtë të së drejtës borgeze». Natyrisht, e drejta borgeze në lidhje me ndarjen e produkteve të konsumit supozon me domosdo edhe *shtetin borges*, pse e drejta nuk është asgjë pa një aparat, që të jetë në gjëndje *të detyrojë* për të respektur normat e së drejtës.

Kështu, në regjimin komunist jo vetëm mbetet për një kohë e drejta borgeze, po edhe shteti borges pa borgezi!

Kjo munt të duket si një paradoks ose si një lodër e thjeshtë dialektike e mëndjes, siç e akuzojnë shpesh marksizmin njers, që nukë janë munduar aspakë të studjojnë përmbajtjen e tij jashtëzakonisht të thellë.

Në realitet, jeta na tregon në çdo çap, në natyrë dhe në shoqëri, gjurmët e së vjetrës në të renë. Dhe Marksi nukë ka futur në mënyrë arbitrare një copë të së drejtës «borgeze» në komunizëm, po ka marrë atë që nga pikëpamja ekonomike dhe politike është e paevituarshme në një shoqëri, që del *nga gjiri* i kapitalizmit.

Demokracja ka një rëndësi kolosale në luftën e klasës punëtore kundër kapitalistëve për çlirimin e saj. Po demokracija nuk është aspakë një kufi, që nukë munt të kapërxehet, po vetëm një etapë në rrugën që shpije nga feudalizmi në kapitalizëm dhe nga kapitalizmi në komunizëm.

Demokraci do të thotë barasi. Kupëtohet ç'rëndësi të madhe ka lufta e proletarjatit për barasi dhe parulla e barasisë, po të kupëtohet mirë në kupëtimin e çdukjes së *klasëve*. Po demokraci do të thotë vetëm barasi *formale*. Dhe menjëherë pas realizimit të barasisë së të gjithë anëtarëve të shoqërisë *në lidhje* me posedimin e mjeteve të prodhimit. d.m.th.të barasisë së punës, të barasisë së mëditjes, menjëherë do të dalë përpara njerëzisë problemi për të shkuar përpara, nga barasija formale në barasinë reale, d.m.th. në realizimin e parimit: sicilido sipas zotësive, sicilitdo sipas nevojave». Cilat janë etapat, masat praktike, që do t'i duhen njerëzisë për të arrirë këtë qëllim të lartë, — ne nuk e dimë dhe nukë munt ta dimë. Po duhet të kupëtojmë se sa e rreme është ideja e zakonëshme borgeze që gjoja socjalizmi është një gjë e vdekur, e ngrirë, e dhënë një herë e për gjithënjë, kurse në realitet *vetëm* me socjalizmin fillon

në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe individuale një lëvizje progresive, një lëvizje e shpejtë, e vërtetë, një lëvizje reale masash, ku të marrë pjesë në krye shumica e popullsisë, dhe pastaj gjithë popullsija.

Demokracija është një formë e shtetit, një nga varjetetet e tij. Pra, ajo është, si dhe çdo shtet, aplikimi i organizuar, sistematik i dhunës kundrejt njerzve. Kjo nga një anë. Po nga ana tjetër, ajo do të thotë pranimin formal të barasisë në mes të qytetarëve, pranimin e së drejtës së barabartë të të gjithëve për të caktuar organizimin e shtetit dhe për administrimin e tij. Dhe kjo, nga ana e saj, është lidhur me faktin që në një shkallë të caktuar të çvillimit të demokracisë ajo, e para, bashkon klasën revolucjonare, proletarjatin kundër kapitalizmit dhe i jep atij mundësinë për të thyer, për të bërë copë-copë, për të çdukur nga faqja e dheut maqinën e shtetit borges, qoftë dhe të një shteti borges republikan, ushtërinë permanente, policinë, burokracinë, për t'i zëvëndësuar me një maqinë shteti më demokratike, — po gjithënjë maqinë shteti —, d. m. th. me masat punëtore të armatosura dhe pastaj me pjesëmarrjen totale të popullit në milici.

Këtu «sasija kalon në cilësi»: një gradë e *tillë* e demokracisë është lidhur me daljen e saj nga kuadri i shoqërisë borgeze, me fillimin e transformimit të saj socjalist. Atje ku *të gjithë* marrin pjesë në administrimin e shtetit, aty kapitalizmi nukë munt të mbahet më. Dhe çvillimi i kapitalizmit, nga ana e tij, krijon kushtet e *domosdoshme* për pjesëmarrjen reale «të të gjithëve» në administrimin e shtetit. Një nga këto kushte është çdukja e plotë e analfabetizmit, që është realizuar që tani në një seri nga vëndet më të përparuara kapitaliste, pastaj «edukimi dhe disciplinimi» i miljonëra punëtorëve nga aparati i math, i komplikuar, i socjalizuar i postës, i udhëve të hekurta, i

fabrikave të mbëdha, i tregëtisë së madhe, i bankave e të tjera.

Me kushte të tilla ekonomike është plotërisht e mundëshme, pas përmbysjes së kapitalistëve dhe të funkcjonarëve, të fillosh menjëherë, që të nesërmen, t' i zëvendësosh këta në *kontrollin* e prodhimit dhe të ndarjes, në *evidencën* e punës dhe të produkteve me punëtorët që armatosen, me gjithë popullin e armatosur. (Nukë duhet ngatërruar çështja e kontrollit dhe e evidencës me çështjen e personelit me kulturë shkencore, si ingjinjerë, agronomë etj.: këta zotërinj punojnë sot duke iu nënështruar kapitalistëve, do të punojnë nesër edhe më mirë duke iu nënështruar punëtorëve të armatosur).

Evidenca dhe kontrolli — ja *gjëja kryesore*, që duhet për «regullimin», për funkcjonimin e mirë të shoqërisë komuniste në fazën e parë. *Gjithë* qytetarët transformohen këtu në nëpunës me mëditje të shtetit, që përbëhet prej punëtorëve të armatosur. *Gjithë* qytetarët bëhen nëpunës dhe punëtorë të një «karteli» *të vetëm*, të një karteli të të gjithë popullit, të shtetit. Gjithë puna është që ata të punojnë njësoj, duke respektuar mirë masën e punës, dhe të marrin njësoj. Evidenca dhe kontrolli i kësaj gjëje *është thjeshtësuar* prej kapitalizmit gjer në ekstrem, gjer në operacjone shumë të thjeshta mikqyrjeje dhe regjistrimi, gjer në diturinë e katër operacjoneve të arithmetikës dhe të dhënjes së dëftesave, që munt t'i bëjë çdo njeri që di shkrim e këndim *.

---

*Kur shteti reduktohet në pjesën më kryesore të funkcjoneve të tija, në një evidencë dhe kontroll të tillë nga ana e vetë punëtorëve, atëhere ay pushon të jetë një «shtet politik», atëhere «funkcjonet publike transformohen nga funkcjone politike në funkcjone të thjeshta administrative» (krahaso më sipër, kap. IV § 2, mi polemikën e Engelsit me anarkistët),

Kur *shumica* e popullit do të fillojë të bëjë vetë dhe kudo një evidencë të tillë, një kontroll të tillë të kapitalistëve (që tani janë bërë nëpunës) dhe të zotërinjve intelektualë, që kanë ruajtur zakonet kapitaliste, atëhere ky kontroll do të bëhet me të vërtetë universal, i përgjithshëm, i gjithë popullit, atëhere këtij kontrolli nukë munt t'i shtëmënget, «nukë munt t'i shpëtojë njeri».

Gjithë shoqëria do të jetë një zyrë dhe një fabrikë me barasi pune dhe me barasi page.

Po kjo disciplinë «fabrike», që proletarjati që ka mundur kapitalistët, që ka përmbysur çfrytëzonjësit, do ta shtrijë në gjithë shoqërinë, nuk është aspak ideali ynë, as qëllimi ynë final, po vetëm një *shkallë* e domosdoshme për spastrimin radikal të shoqërisë nga poshtërsitë dhe turpet e çfrytëzimit kapitalist dhe për lëvizjen *e mëtejme* të shoqërisë përpara.

Që nga momenti, kur gjithë anëtarët e shoqërisë ose të pakën shumica e madhe e tyre do të mësohen *vetë* të qeverisin shtetin, ta marrin vetë këtë punë në duart e tyre «të organizojnë» kontrollin mi një pakicë shumë të vogël kapitalistësh, mi zotërinjtë që duan të ruajnë zakonet kapitaliste, mi punëtorët e korruptuar gjer në palcë prej kapitalizmit, që nga ky moment fillon të çduket nevoja për çfarëdo administrate përgjithërisht. Sa më e plotë është demokracija, aq më afër është momenti, kur ajo do të bëhet e panevojëshme. Sa më demokratik është «shteti», që përbëhet prej punetorëve të armatosur dhe që «nukë është më një shtet në kupëtimin e vërtetë të fjalës», aqë më shpejt fillon të shuhet çdo shtet.

Pse, kur *të gjithë* do të mësohen të qeverisin dhe të administrojnë me të vërtet vetë prodhimin shoqëror, do të realizojnë vetë evidencën dhe kontrollin e parasitëve, të djemkave të mamasë, të dallaveraxhinjve dhe të «ruaj-

tësve» të tjerë «të traditave të kapitalizmit», atëhere shtëmëngja nga këjo evidencë dhe nga ky kontroll i gjithë popullit do të bëhet me domosdo një gjë kaqë tepër e vështirë, një përjashtim kaqë i rrallë, do të shoqërohet, ndofta, me një dënim kaqë të shpejtë dhe serjoz (se punëtorët e armatosur janë njers praktikë, dhe jo intelektualka sentimentalë dhe nukë do të lejojnë që të bëhet shaka me ta), sa që *nevoja* per të respektuar regullat e thjeshta, elementare të çdo bashkëjetese njerëzore do të bëhet shumë shpejt një *zakon*.

Dhe atëhere do të hapet porta e madhe për kapërximin nga faza e parë e shoqërisë komuniste në fazën e saj më të lartë, dhe bashkë me këtë në shuarjen e plotë të shtetit. [22]).

KAPITULLI VI

VULGARIZIMI I MARKSIZMIT PREJ OPORTUNISTËVE

Me problemin mi qëndrimin e shtetit kundrejt revolucjonit shoqëror dhe të revolucjonit shoqëror kundrejt shtetit, teoretikët dhe publicistët më të shënuar të Internacjonales së II (1889-1914) janë marrë shumë pakë, ashtu si dhe me çështjen e revolucjonit përgjithërisht. Po ajo që është më karakteristike në procesin e çvillimit gradual të oportunizmit, që shpuri në falimentimin e Internacjonales së II më 1914, është fakti që ata, edhe kur përpiqeshin ballë për ballë me këtë problem, *orvateshin ta evitonin* ose nuk e vinin re.

Përgjithërisht munt të themi se nga *shtëmëngja* në problemin e qëndrimit të revolucjonit proletar kundrejt shtetit, shtëmëngje që është në interesë të oportunizmit dhe që e ushqen atë, rodhi *falsifikimi* i marksizmit dhe vulgarizimi i plotë i tij.

Për të karakterizuar, qoftë dhe shkurt, këtë proces të hidhur, po marrim teoretikët më të përmëndur të marksizmit, Plehanovin dhe Kautskin.

1. *Polemika e Plehanovit me anarkistët*

Plehanovi i kushtoi problemit të qëndrimit të anarkistëve kundrejt socjalizmit një broshurë më vete: «Anarkizmi dhe Socjalizmi», që dolli gjermanisht më 1894.

Plehanovi bëri si bëri, po e la më një anë fare atë që është më aktuale, më urgjente dhe nga pikëpamja politike më esencjale në luftën kundra anarkizmit, pikërisht: qëndrimin e revolucjonit kundrejt shtetit dhe problemin e shtetit përgjithrërisht! Në broshurën e tij çquhen dy pjesë: njëra, pjesa historike-letrare përmban dokumenta të vjyera mi historinë e ideve të Stirner-it, Proudhon-it etj.; pjesa tjetër është filistine, me arësyetime trashanike mi anarkistin, që nukë munt të dallohet nga banditi.

Kombinimi i temave është tepër zbavitës dhe tepër karakteristik për gjithë aktivitetin e Plehanov-it në vëngullën e revolucjonit dhe në periodën revolucjonare në Rusi: kështu u tregua Plehanov-i më 1905-1917 gjysmë doktrinar, gjysmë filistin, duke shkuar në politikë pas bishtit të borgezisë.

Ne pamë se si Marksi dhe Engelsi, duke polemizuar me anarkistët, vinin në dukje me kujdes shumë të math pikëpamjet e tyre mi qëndrimin e revolucjonit kundrejt shtetit. Engelsi, kur botoji më 1891 «Kritikën e programit të Gotha-s» të Marksit, shkruante se «ne (d. m. th. Engelsi dhe Marksi) ishim atëhere në zjarrin më të math të luftës kundër Bakuninit dhe anarkistëve të tij — pa shkuar akoma dy vjet pas kongresit të Hagës të Internacjonales (së Parë)».

Anarkistët u orvatën pikërisht që ta çpallin Komunen e Parizit, si të thuash, «të tyren», se vërtetonte doktrinën e tyre: ata nukë kupëtuan fare mësimet e Komunës dhe analizën e këtyre mësimeve nga ana e Marksit. Anarkizmi nukë dha asgjë që t'i afrohet, qoftë dhe së largu, së vërtetës mi problemet politike konkrete: a duhet *thyer* maqina e vjetër e shtetit dhe *me se* duhet zëvëndësuar?

Po të ilasësh për «anarkizmin dhe socjalizmin», duke lënë më një anë gjithë problemin e shtetit, *duke mos vënë*

re gjithë çvillimin e marksizmit përpara dhe pas Komunës, kjo do të thotë të bijesh në mënyrë të paevituarshme në oportunizëm. Pse pikërisht oportunizmit i intereson sidomos, që të *mos* shtrohen fare dy problemet e përmëndura këtu prej nesh. Edhe kjo vetëm është një fitore e oportunizmit.

2. *Polemika e Kautskit me oportunistët*

Pa dyshim, rusisht janë përkthyer shumë më tepër vepra të Kautskit se në çdo gjuhë tjetër. Nuk është pa arësye që socjal-demokratët gjermanë thonë me shaka se Kautski këndohet më shumë në Rusi se sa në Gjermani (le të themi në kllapa, se në këtë shaka ka një përmbajtje historike shumë me të thellë se sa e kujtojnë ata që e kanë bërë këtë shaka: punëtorët rusë, që kishin paraqitur më 1905 një kërkesë jashtëzakonisht të madhe, të pashëmbëll për veprat më të mira të literaturës më të mirë social-demokrate në botë dhe që kishin pasur një sasi, të panjohur për vëndet e tjera, përkthimesh dhe botimesh të këtyre veprave, çpërngulën, si të thuash, me një ritmë të shpejtuar në tokën e re të lëvizjes sonë proletare eksperjencën e madhe të një vëndi fqinj, më të përparuar).

Kautski njihet tek ne sidomos, përveç paraqitjes së tij popullore të marksizmit, për polemikën e tij me oportunistët, Bernstein-in në krye. Po ka një fakt pothuajse të panjohur, që nukë munt të harrohet, po të kemi si qëllim të studjojmë se si Kautski shkau në një konfuzjon aqë të turpshëm dhe në mprojtjen e socjal-shovinizmit në kohën e krizës së madhe të viteve 1914-1915. E kemi fjalën te fakti që Kautski ka pasur shumë lëkundje të

mbëdha përpara se të ngrihesh kundër përfaqësonjësve më të përmëndur të oportunizmit në Francë (Millerand dhe Jaurès) dhe në Gjermani (Bernstein). Gazeta marksiste «Zarja», që dolli më 1901-1902 në Stuttgart dhe që mpronte pikëpamjet proletare-revolucjonare, u detyrua *të polemizonte* me Kautskin, ta quante «rezolutë prej kauçuku» rezolutën e tij gjysmake, evazive dhe me karakter pajtimi kundrejt oportunistëve në konferencën socjaliste ndërkombëtare të Parizit në v. 1900 [23]). Në shtypin gjerman janë botuar letra të Kautskit, që tregojnë lëkundje jo më të vogëla nga ana e tij përpara se të fillonte fushatën kundër Bernstein-it.

Po ka njt rëndësi shumë të madhe fakti që në vetë polemikën e tij me oportunistët, në të shtruarit e problemit nga ana e tij dhe në mënyrën e trajtimit të problemit, kur studjojmë *historinë* e tratnëtisë së fundit të Kautskit kundrejt marksizmit tani, vëmë re një shtëmëngje sistematike drejt oportunizmit pikërisht në problemin e shtetit.

Të marrim veprën e parë të madhe të Kautskit kundër oportunizmit, librin e tij «Bernstein-i dhe programi socjal-demokrat». Kautski e rëzon Bernstein-in me hollësi. Po ja se ç'gjë është karakteristike.

Në «Premisat e socjalizmit», të famëshme në mënyrën e Erostratit, Bernstein-i akuzon marksizmin për «*blankizëm*» (akuzë që e kanë përsëritur me mijra herë oportunistët dhe borgezët liberalë të Rusisë kundër përfaqësonjësve të marksizmit revolucjonar, kundër bolshevikëve). Këtu Bernstein-i ndalet në mënyrë të veçantë mi «Luftën civile në Francë» të Marksit dhe orvatet — siç e pamë, fare pa sukses — të identifikojë pikëpamjen e Marksit mi mësimet e Komunës me pikëpamjen e Proudhon-it. Bernstein-it i tërheq veçanërisht vëmëndjen konkluzjoni i Marksit, që ky e ka theksuar në parathënjen e v. 1872 për «Mani-

festin Komunisht» dhe që thotë: «klasa punëtore nukë munt të marrë në duart e saja maqinën e shtetit të gatëshme dhe ta vërë në veprim për qëllimet e saja».

Bernstein-it i «pëlqeu» kaqë tepër kjo formulë, saqë ay e përsërit në librin e tij jo më pakë se tri herë, duke e interpretuar në një kupëtim fare të shtrëmbëruar dhe oportunist.

Marksi, siç e pamë, do të thotë se klasa punëtore duhet *të thyej, të çkatërrojë, të hedhë në erë* (Sprengung, hedhje në erë, — shprehje e përdorur prej Engelsit) gjithë maqinën e shtetit. Kurse sipas Bernstein-it, gjoia Marksi me këto fjalë sikur ka dashur t'i thotë klasës punëtore që të ruhet *nga* vrulli revolucjonar i tepëruar në kohën e marrjes së pusntetit në dorë.

Nukë munt të përfytyrohet një shtrëmbërim më trashanik dhe më i shëmtuar i mendimit të Marksit.

Po si vepëron Kautski në rrëzimin e tij shumë të hollësishëm të bernsteiniadës?

Ay shtëmënget nga analiza e shtrëmbërimit të thellë të marksimit nga ana e oportunizmit në këtë pikë. Ay bije vëndin e qekur më sipër nga parathënja e Engelsit për «Luftën civile» të Marksit, duke thënë se sipas Marksit, klasa punëtore nukë munt ta marrë maqinën e shtetit ashtu të gatëshme, po përgjithërisht *munt* ta marrë, dhe vetëm kaqe.

Që Bernstein-i i atribuonte Marksit *dijametralisht të kundërtën* e mendimit të tij të vërtetë, që Marksi që nga v. 1852 kish parashtruar si detyrë të revolucjonit proletar «thyerjen» e maqines së shtetit, — mi të gjitha këto Kautski nukë thotë asnjë fjalë.

Kështu që ndryshimin më esencjal në mes të marksizmit dhe të oportunizmit në problemin e detyrave të revolucjonit proletar, Kautski e ka fshirë!

«Zgjidhjen e problemit të diktaturës proletare — shkruante Kautski *«kundër»* Benstein-it — munt të ja lëmë fare të qetë së arthmes» (f.172 e botimit gjermanisht).

Kjo nuk është një polemikë *kundër* Bernstein-it, po, në realitet, një *koncesjon*, një kapitullim përpara oportunizmit, pse oportunistët nukë duan asgjë më tepër sot për sot, veçse «të ja lënë së arthmes fare të qetë» të gjitha problemet esencjale të revolucjonit proletar.

Marksi dhe Engelsi që nga viti 1852 dhe gjer në vitin 1891, dyzet vjet me radhë, i kanë mësuar proletarjatit se ay duhet të thyej maqinën e shtetit. Kurse Kautski më 1899 përpara trathëtisë së plotë të marksizmit nga ana e oportunistëve në këtë pikë, *në vënt* të problemit: a duhet thyer kjo maqinë, vë problemin e formave konkrete të thyerjes dhe fshihet prapa së vërtetës filistine «të pamohuarshme» (dhe shterpë), që format konkrete nukë munt t'i dimë që më parë!!

Në mes të Marksit dhe të Kautskit ka një greminë në qëndrimin e tyre kundrejt detyrës së partisë proletare për të pregatitur klasën punëtore për revolucjon.

Të marrim një vepër tjetër, më të pjekur të Kautskit, që i kushtohet gjithashtu në një masë të madhe hedhjes poshtë të gabimeve të oportunizmit: broshurën e tij mi «Revolucjonin shoqëror». Auktori këtu ka marrë si temë specjale problemin e «revolucjonit proletar» dhe të «regjimit proletar». Autori na jep shumë gjëra jashtëzakonisht të viyera, *po lë më një anë*, pikërisht problemin e shtetit. Në broshurë flitet kudo për marrjen e pushtetit të shtetit, dhe vetëm kaqë, d. m. th. është zgjedhur një formulë që është një koncesjon kundrejt oportunistëve, me qënë se *pranon* marrjen e pushtetit *pa* çkatërruar maqinën e shtetit. Kautski më 1902 *ngjallë përsëri* atë, që Marksi e quante «të vjetëruar» më 1872 në programin e «Manifestit Komunist».

Në broshurë u kushtohet një paragraf i veçantë «formave dhe armëve të revolucjonit shoqëror». Këtu flitet për grevën politike të masave, për luftën civile, për «veglat e forcës së shtetit të math modern, si burokracija dhe ushtëria», por asnjë fjalë për atë gjë, që u mësoji punëtorëve Komuna. Sigurisht, Engelsi nuk u kish thënë më kot, sidomos socjalistëve gjermanë, që të ruhen nga «respekti bestytë» kundrejt shtetit.

Kautski thotë kështu: proletarjati fitimtar «realizon programin demokratik» dhe spjegon pikat e tij. Asnjë fjalë për atë gjë të re, që dha v. 1871 në çështjen e zëvëndësimit të demokracisë borgeze me demokracinë proletare. Kautski kufizohet me banalitete si këto, që duken «shumë serjoze»:

> «Kupëtohet vetëvetiu se ne nukë do të arrijmë në fuqi në konditat e sotme. Revolucjoni vetë supozon një luftë të gjatë që rrëmben thellë, një luftë që do të ndryshojë strukturën tonë politike dhe shoqërore të sotme».

Sigurisht se kjo «kupëtohet vetëvetiu», ashtu siç është vërtetë që kuajt hanë tagji dhe që Vollga derdhet në detin Kaspik. Na vjen keq vetëm që me frazën e zbrazët dhe të fryrë mi një luitë «që rrëmben thellë» *lihet me një anë* një problem jetësor për proletarjatin revolucjonar: *ku* qëndron «thellësija»e revolucjonit të tij në lidhje me shtetin dhe demokracinë, ndryshimi i saj në këtë pikë me revolucjonet e mëparëshme, jo proletare?

Duke lënë më një anë këtë problem, Kautski në *realitet* në këtë pikë shumë esencjale i bën një koncesjon oportunizmit; ay i çpall luftë të tmerrshme *me fjalë* oportunizmit, thekson rëndësinë e «idesë së revolucjonit» (po ç' vlen kjo «ide», kur ke frikë t' u propagandosh punëtorëve mësimet konkrete të revolucjonit?) ose thotë: «idea-

lizmë revolucjonar në radhë të parë», ose deklaron se punëtorët inglizë tani nukë janë «shumë më tepër se borgezë të vegjël».

> «Në shoqërinë socjaliste — shkruan Kautski — munt të egzistojnë pranë njëra tjetrës.... format më të ndryshme të ndërmarrjeve burokratike (! !), trade-unioniste, kooperative, individuale»,... «ka, për shëmbëll, ndërmarrje, që nukë munt të bëjnë pa një organizim burokratik (! !), siç janë udhët e hekurta. Këtu organizimi demokratik munt të marrë këtë formë: punëtorët zgjedhin delegatët e tyre, të cilët formojnë një farë parlamenti, dhe ky parlament cakton regjimin e punës dhe kontrollon funkcjonimin e aparatit burokratik. Disa ndërmarrje të tjera munt t'u lihen sindikateve, disa të tjera munt të organizonen mi baza kooperative» (f. 148 dhe 115 të përkthimit rusisht, botuar në Genevë në v. 1903).

Ky arësyetim ësht i gabuar; ay shënon një çap prapa në krahasim me atë, që shpjeguan Marksi dhe Engelsi më 1870-1880 duke u pështetur në mësimet e Komunës.

Nga pikëpamja e organizmit të domosdoshmë «burokratik», udhët e hekurta nukë ndryshojnë aspakë nga të gjitha ndërmarrjet e industrisë mekanike të madhe përgjithërisht, nga çdo fabrikë, magazi e madhe, ndërmarrje e madhe bujqësore kapitaliste. Në të gjitha këto ndermarrje teknika kërkon një disciplinë fare të rreptë, një kujdes shumë të math në kryerjen e pjesës së punës, që i është ngarkuar sicilitdo, pse ndryshe është në rrezik që të mbetet gjithë puna ose të prishen mekanizmat, të prishen produktet. Në të gjitha këto ndërmarrje punëtorët sigurisht do të «zgjedhin delegatë, që formojnë një farë *parlamenti*».

Po gjithë puna është që ky «farë parlamenti» *nukë* do të jetë një parlament në kupëtimin e institucjoneve parlamentare borgeze. Gjithë puna është që ky «farë parlamenti» *nukë* do të «caktojë vetëm regjimin e punës dhe të kon-

trollojë funkcjonimin e aparatit burokratik», siç kujton Kautski, ideja e të cilit nukë del jashtë kuadrit të parlamentarizmit borges. Në shoqërinë socjaliste «një farë parlamenti» me deputetë punëtorë, natyrisht, do të «caktojë regjimin e punës dhe do të kontrollojë funkcjonimin e «aparatit», *po* ky aparat *nukë* do të jetë «burokratik». Punëtorët, me të marrë pushtetin politik në dorë, do të çkatërrojnë aparatin e vjetër burokratik, do ta prishin nga themeli, nukë do të lënë gur mi gur, do ta zëvëndësojnë me një aparat të ri, të përbërë nga punëtorë dha nga nëpunës. Për të *ndaluar* që këta të bëhen burokratë, do të merren menjëherë masat e studjuara me hollësi nga Marksi dhe nga Engelsi: 1) jo vetëm parimi i të zgjedhurit, po dhe parimi që munt të hiqen në çdo çast: 2) pagë jo më e madhe se paga e punëtorit; 3) *të gjithë* të fillojnë menjëherë të kryejnë funkcjonet e kontrollit dhe të mikqyrjes, *të gjithë* te bëhen për një kohë «burokratë», kështu që *asnjë* të mos bëhet «burokrat».

Kautski nuk i ka peshuar fare këto fjalë të Marksit: «Komuna nuk ka qënë një parlamentar, po një trup vepëronjës, që ka njëkohësisht pushtet legjislatif dhe pushtet egzekutif».

Kautski nukë ka kupëtuar fare ndryshimin në mes të parlamentarizmit borges, që kombinon demokracinë *(jo për popullin)* me burokracinë (kundër popullit) dhe të demokracisë proletare, që do të marrë menjëherë masa për të prerë në rrënjë burokracinë dhe që do të jetë në gjëndje t' i shpjerë këto masa gjer në funt, gjer në çdukjen e plotë të burokracisë, gjer në vendosjen e plotë të demokracisë për popullin.

Kautski këtu tregon po atë «respekt bestytë» kundrejt shtetit, po atë «besim bestytë» në burokracinë.

Të hidhemi e të shohim veprën e fundit, veprën më të

mirë të Kautskit kundër oportunistëve, broshurën e tij «Rruga për në pushtet» (më duket nuk është botuar rusisht, pse ajo dolli më 1909, kur tek ne reakcjoni ishte në kulm). Kjo broshurë është një çap i math përpara, pse këtu nukë flitet përgjithërisht për programin revolucjonar, si në broshurën e v. 1899 kundër Bernstein-it, nukë flitet për detyrat e revolucjonit shoqëror pavarësisht nga koha e ardhjes së revolucjonit, si në broshurën «Revolucjoni shoqëror» më 1902, po për konditat konkrete, që na detyrojnë të themi se *po vjen* faza e revolucjoneve».

Autori flet në mënyrë të prerë për ashpërsimin e kontradiktave të klasëve përgjithërisht dhe për imperjalizmin, që nga kjo pikëpamje luan një rol veçanërisht të math. Pas «periodës revolucjonare 1789-1871» për Evropën e perëndimit, fillon me vitin 1905 po një periodë e tillë për Lindjen. Lufta e përbotëshme po afrohet me një shpejtësi alarmante. «Proletarjati tani nukë munt të flasë më për revolucjon përpara kohës.» Ne kemi hyrë në një periodë revolucjonare». «Po fillon faza e revolucjonit.»

Këto deklarata janë fare të qarta. Kjo broshurë e Kautskit duhet të na shërbejë si kriter për të krahasuar atë që socjal-demokracija gjermane *premtonte të ish* përpara luftës imperjaliste dhe se sa poshtë ra (bashkë me të edhë vetë Kautski) me plasjen e luftës. «Situata e sotme — shkruante Kautski në broshurën që shqyrtuam — sjell me vete këtë rezik: ne (d. m. th. socjal-demokracinë gjermane) munt të na marrin kollaj si më të matur seç jemi në realitet». Në realiiet dolli që partija socjal-demokrate gjermane u tregua pa krahasim më e matur dhe më oportuniste seç dukesh!

Aqë më karakteristike është që, me gjithë karakterin e prerë të deklaratave të Kautskit mi fillimin e fazës së revolucjoneve, ay problemin e shtetit e la prapë fare me

një anë edhe në një broshurë, që, sipas fjalëve të tija, i qe kushtuar pikërisht analizës së problemit të «revolucjonit politik».

Të gjitha këto orvajtje për të lënë më një anë problemin, për ta mbytur në heshtje, të gjitha këto shtëmëngje patën si pasojë të domosdoshme kalimin e plotë në oportunizëm, për të cilin ne do të flasim tani.

Socjal-demokracija gjermane, në personin e Kautskit dukesh sikur deklaronte: unë qëndroj në pikëpamjet revolucjonare (1899). Unë pranoj në mënyrë të veçantë karakterin e paevituarshëm të revolucjonit shoqëror të proletarjatit (1902). Unë pranoj fillimin e një ere të re revolucjoni (1909). Po me gjithatë unë kthehem prapa në krahasim me atë që ka thënë Marksi që më 1852, kur shtrohet problemi i detyrave të revolucjonit proletar kundrejt shtetit (1912).

Pikërisht kështu, drejt për drejt, shtrohesh problemi në polemikën e Kautskit me Pannekoek-un.

3. *Polemika e Kautskit me Pannekoek-un*

Pannekoek u ngrit kundër Kautskit si një përfaqësues i rrymës «radikale të mëngjër», që kishte në radhët e saja Roza Luksenburg, Karl Radek dhe të tjerë, rrymë që në mprojtjen e taktikës revolucjonare bashkoheshe nga bindja se Kautski po bije në pozitën e «qëndrës», po lëkundet pa asnjë parim në mes të marksizmit dhe të oportunizmit. Lufta provoji plotërisht se kjo pikëpamje ishte e drejtë: rryma e «qëndrës» (që quhesh pa të drejtë marksiste, ose e «kautskizmit», u tregua funt e krye në gjithë mizerjen e saj të shëmtuar.

Në artikullin «Vepërimi i masave dhe revolucjoni» («Neue Zeit», 1912, XXX, 2), ku flitesh për problemin e

shtetit, Pannekoek e karakterizon pozitën e Kautskit si pozitë «radikalizmi pasif», si «teori të pritjes mosvepëronjëse». «Kautski nukë do të shohë procesin e revolucjonit» (f. 616). Duke shtruar kështu problemin, Pannekoek arriu në temën që na intereson: detyrat e revolucjonit proletar kundrejt shtetit.

> «Lufta e proletarjatit — shkruante ay — nuk është vetëm një luftë kundër borgezisë *për* pushtetin shtetëror, po dhe një luftë *kundër* pushtetit shtetëror... Përmbajtja e revolucjonit proletar është çdukja e veglave të forcës së shtetit dhe eliminimi i tyre (fjalë për fjalë: përndarja, *Aufloesung*) me veglat e forcës së proletarjatit... Lufta pushon vetëm atëhere, kur, si një rezultat final i saj, çduket krejt organizata e shtetit. Organizata e shumicës provon epërsinë e saj duke çdukur organizatën e pakicës sundonjëse» (f. 548).

Formula, me të cilën Pannekoek i ka veshur mendimet e tija, ka mungesa shumë të mbëdha. Po ideja është e qartë, dhe është interesante se si e ka hedhur poshtë Kautski.

> «Gjer më sot — shkruante ay — kundërshtimi në mes të socjal-demokratëve dhe të anarkistëve qëndronte në faktin që të parët donin të mirrnin pushtetin e shtetit, kurse të dytët ta çkatërronin. Pannekoek i do që të dyja» (f. 724).

Paraqitja e Pannekoek-ut nuk është e qartë dhe konkrete (pa folur këtu për mungesa të tjera të artikullit të tij, që nukë kanë të bëjnë me temën që shqyrtojmë), po Kautski ka marrë pikërisht esencën *parimore*, që prek Pannekoek, dhe në këtë çështje *rrënjësore parimi* Kautski largohet funt e krye nga pozita e marksizmit, hidhet fare në oportunizëm. Ay ndryshimin në mes të socjal-demokratëve dhe të anarkistëve e përcakton në mënyrë fare të gabuar, e shtrëmbëron dhe vulgarizon definitivisht marksizmin.

Ndryshimi në mes të marksistëve dhe të anarkistëve

qëndron në faktin që 1) të parët, duke pasur si qëllim çdukjen e plotë të shtetit, thonë se ky qëllim munt të realizohet vetëm pas çdukjes së klasëve prej revolucjonit socjalist, si rezultat i vendosjes së socjalizmit, që shpije në shuarjen e shtetit; të dytët duan çdukjen e plotë të shtetit me një herë, pa kupëtuar konditat që dunen për realizimin e kësaj çdukjeje. 2) Të parët thonë se është e domosdoshme që proletarjati, me të marrë pushtetin politik, të çkatërrojë krejt maqinën e vjetër të shtetit, duke e zëvëndësuar me një maqinë të re, me organizimin e punëtorëve të armatosur, sipas tipit të Komunës; të dytët, duke mprojtur çkatërrimin e maqinës së shtetit, nukë kanë aspakë një ide të qartë, *me se* do ta zëvëndësojë proletarjati dhe *se si* do ta përdorë pushtetin revolucjonar; bile anarkistët mohojnë të përdorurit e pushtetit revolucjonar, të diktaturës revolucjonare nga ana e proletarjatit revolucjonar. 3) Të parët kërkojnë që proletarjati të përgatitet për revolucjon duke përdorur shtetin e sotmë; anarkistët e mohojnë këtë.

Në këtë diskutim marksizmin e përfaqëson kundër Kautskit, pikërisht Pannekoek, pse Marksi na ka mësuar që proletarjati nukë munt ta marrë pushtetin e shtetit vetëm në kupëtimin që aparati i vjetër i shtetit të shkojë në duar të reja, po duhet ta thyej, ta çkatërrojë këtë aparat, ta zëvëndësojë me një aparat të ri.

Kautski largohet nga marksizmi dhe vete me oportunistët, pse tek ay çduket fare pikërisht ky çkatërrim i maqinës së shtetit, që nukë është aspakë i përshtatshëm për oportunistët; kështu këtyre u mbetet një shtek për të interpretuar «marrjen e pushtetit» si një realizim të thjeshtë të shumicës.

Për të fshehur shtrëmbërimin e tij të marksizmit, Kautski vepëron si talmudist: ay na nxjerr përpara një «citat» të vetë Marksit. Më 1850 Marksi shkroi mi nevojën

e një «centralizimi të vendosur të forcës në duart e pushtetit shtetëror». Dhe Kautski hidhet e pyet me trijumf: mos do vallë Pannekoek të prishë «centralizmin»?

Ky është vetëm një marifet si ay i Bernstein-it, që identifikon marksizmin dhe proudhonizmin, kur flet për federatën në vënt të centralizimit.

«Citati» që merr Kautski është pa vënt. Centralizëm munt të ketë dhe me maqinën e vjetër të shtetit dhe me maqinën e re. Kur punëtorët i bashkojnë vullnetarisht forcat e tyre të armatosura, kemi centralizëm, po ky centralizëm bazohet në «çkatërrimin e plotë» të aparatit centralist të shtetit, të ushtërisë të përhërëshme, të policisë, të burokracisë. Kautski nukë sillet fare në mënyrë të ndershme: ay le më një anë arësyetimet e njohura mirë të Marksit dhe të Engelsit mi Komunën dhe nxjerr përpara një citat, që nukë ka të bëjë me çështjen.

> ....«Ndofta Pannekoek do të çdukë funkcjonet publike të funkcjonarëve? — vazhdon Kautski. — Po ne nukë bëjmë pa funkcjonarë as në parti, as në organizatën sindikale, pa le në administrimin e shtetit. Programi ynë nukë kërkon çdukjen e funkcjonarëve të shtetit, po zgjedhjen e funkcjonarëve nga populli»... «Për ne nuk është fjala të dimë ç'formë do të marrë aparati administratif në «shtetin e nesërm» po të dimë në e çduk apo jo (fjalë për fjalë: e përndan, aufloest) lufta jonë politike pushtetin shtetëror, *përpara se ta marrim këtë pushtet* (kursivi është i Kautskit). Cila ministri munt të çduket bashkë me funkcjonarët e saja?» Përmënden ministrija e Arësimit e Drejtësisë, e Financave, e Luftës. «Jo, asnjë nga ministritë e sotme nukë do të hiqet nga lufta jonë politike kundër qeverisë...,. Po përsëris, për të evituar moskuptime: nuk është fjala për formën që do t'i japë «shtetit të nesërm» socjal-demokracija fitimtare, po si e ndryshon shtetin e sotmë opozita jonë« (f. 725).

Këtu kemi sheshit një hile. Pannekoek-u shtronte pikërisht problemin e *revolucjonit*. Kjo duket sheshit në titu-

llin e artikullit të tij, si dhe në rrjeshtat e qekura. Duke kërcyer në çështjen e «opozitës», Kautski fut kontrabandë pikëpamjen oportuniste në vënt të pikëpamjes revolucjonare. Ay arësyeton kështu: tani opozitë, dhe *pas* marrjes së pushtetit shohim e bëjmë. *Revolucjoni çduket!* Kjo është pikërisht ajo që dorin oportunistët.

Nuk është fjala as për opozitë as për luftë politike përgjithërisht, po për *revolucjon.* Revolucjoni qëndron në faktin që proletarjati *prish* «aparatin administratif» dhe *gjithë* aparatin e shtetit, duke e zëvëndësuar me një aparat të ri, me organizimin e punëtorëve të armatosur. Kautski tregon një «respekt bestytë» për «ministritë», po a nukë munt të zëvëndësohen ato, për shëmbëll, me komisjone specjalistësh pranë Sovjetëve të plotfuqishmë të Deputetëve, të Punëtorëve dhe të Ushtarëve?

Nuk është esencjale në do të mbeten «ministritë», në do të ketë «komisjone specjalistësh» ose institucjone të tjera: kjo nukë ka fare rëndësi. Esencjale është, në do të mbetet maqina e vjetër e shtetit (që është lidhur me borgezinë me mijra fije dhe është zhytur funt e krye në rutinë dhe koservatizëm) ose në do të *prishet* dhe do të zëvëndësohet me një *të re.* Revolucjoni nukë qëndron në faktin që klasa e re të komandojë, të administrojë me anën e maqinës *së vjetër* së shtetit, po që ajo ta *thyej* këtë maqinë dhe të komandojë, të administrojë me anën e maqinës *së re,*— këte ide *themelore* të markzismit e falsifikon, ose nuk e ka kupëtuar fare Kautski.

Pyetja e tij mi funkcjonarët tregon sheshit se ay nuk i ka kupëtuar mësimet e Komunës dhe doktrinën e Marksit.

«Ne nukë bëjmë pa funkcjonarë në organizatën e partisë dhe në organizatën sindikale»...

Ne nukë bëjmë pa funkcjonarë *në regjimin kapitalist,* nënë *sundimin e borgezisë.* Proletarjati shtypet, masat punonjëse skilavërohen prej kapitalizmit. Në regjimin kapi-

talist demokracija ësht e mbledhur, e shtypur, e prerë, e gjymtuar nga gjithë rethi i skllavërisë me mëditje, i nevojës dhe i varfërisë së masave. Për këtë arësye, dhe vetëm për këtë arësye, në organizizatat tona politike dhe sindikale funkcjonarët koruptohen (ose, më mirë, kanë tendencë që të koruptohen) nga rethi kapitalist dhe kanë tendencë të bëhen burokratë, d. m. th. persona të privilegjuara, të çkëputura nga masat dhe që qëndrojnë *përmi* masat.

Këtu është *esenca* e burokracisë, dhe gjersa të mos çpronësohen kapitalistët, gjersa të mos përmbyset borgezija, ësht e paevituarshme një farë «burokratizmi» *edhe* i funkcjonarëve proletarë.

Kautski arësyeton kështu: me qënë se mbeten funkcjonarë të zgjedhur, mbeten dhe funkcjonarët në regjimin socjalist, mbetet burokracija! Pikërisht kjo nuk ësht e vërtetë. Pikërisht me shëmbëllën e Komunës Marksi tregoji se në regjimin socjalist funkcjonarët pushojnë së qëni «burokratë», «funkcjonarë», pushojnë *në atë masë* që vendoset, përveç parimit të të zgjedhurit, *edhe* parimi që munt të hiqen në çdo çast; *në atë masë* që u'et paga gjer në mëditjen mesatare të punëtorit; në atë masë që zëvëndësohen institucjonet parlamentare me institucjone «vepëronjëse», d.m.th. me institucjone, që kanë pushtet legjislatif dhe egzekutif njëkohësisht».

Në të vërtetë, gjithë argumentimi i Kautskit kundër Pannekoek dhe sidomos argumenti i admiruarshëm i Kautskit se ne nukë bëjmë dot pa funkcjonarë në organizatat sindikale dhe në organizatat e partisë, tregojnë se Kautski përsërit «argumentet» e vjetra të Bernstein-it kundër marksizmit përgjithërisht. Në librin e tij prej renegati «Premisat e Socjalizmit» Bernstein-i lëfton kundër idesë së demokracisë «primitive», kundër asaj, që ay e quan «demokraci doktrinare»: mandate imperative, funkcjonarë që nukë marrin shpërblim, përfaqësi qëndrore e pafuqishme

etj... Për të provuar se kjo demokraci «primitive» është pa themel, Bernstein-i mbështetet ne eksperjencën e trade-unioneve inglize, siç e kanë interpretuar bashkështortët Webb. Gjatë shtatëdhjetë vjet të çvillimit të tyre trade-unionet, që janë çvilluar gjoja «në liri të plotë» (f. 137 e botimit gjermanisht), u bindën pikërisht se demokracija primitive nukë bën dhe e zëvëndësuan atë me demokracinë e zakonëshme: me parlamentarizmin, të lidhur me burokracinë.

Në të vërtetë trade-unionet janë çvilluar jo «në liri të plotë», *po në skllavëri të plotë kapitaliste*, ku, natyrisht, «nukë munt të bëhet dot» pa i bërë një varg koncesjonesh së keqes që mbretëron, dhunës, gënjeshtrës, pa përjashtuar të varfërit nga administrata «e lartë». Në regjimin socjalist shumë gjëra nga demokracija «primitive» do të ringjallen, pse për herë të parë në historinë e shoqërive të qytetëruara *masa* e popullsisë do të ngrihet gjer në një pjesëmarrje *të pavarur* jo vetëm në votime dhe në zgjedhje, po dhe *në administrimin e përditshëm.* Në regjimin socjalist *të gjithë* do të qeverisin me radhë dhe do të mësohen shpejt që asnjeri të mos qeverisë.

Marksi me mendjen e tij gjenjale, me kritikën dhe me analizën e tij pa në masat praktike të Komunës atë *kthesë*, që oportunistët nukë duan ta pranojnë nga frika, nga mosdashja që t'i këpusin urat definitivisht me borgezinë, dhe që anarkistët nukë duan ta shohin ose pse nguten, ose pse nukë kupëtojnë konditat e transformacjoneve shoqërore të masave përgjithërisht. «As që duhet të mendojmë për prishjen e maqinës së vjetër të shtetit; si munt të bëjmë pa ministri dhe pa funkcjonarë?» — arësyeton oportunisti i zhytur funt e krye në filistinizëm dhe që, në substancë, jo vetëm nukë ka besim në revolucjon, në fuqinë krijonjëse të revolucjonit, po dhe trëmbet nga revolucjoni (siç trëmben prej saj menshevikët dhe eserët tanë).

«Duhet të mendojmë *vetëm* për çkatërrimin e maqinës së vjetër të shtetit; nukë ka përse të hyjmë thellë në mësimet *konkrete* të revolucjoneve proletare të mëparëshme dhe të analizojmë *me se* dhe *si* ta zëvëndësojmë atë që është çkatërruar», — arësyeton anarkisti (natyrisht, anarkisti më i mirë dhe jo ay, që duke ndjekur gjurmët e zotërinjve Kropotkin dhe shokë hiqet zvarë prapa borgezisë); dhe prandaj anarkisti arrin në një taktikë *dëshpërimi* dhe jo në një aktivitet revolucjonar konkret, që është pa mëshirë i guximshëm dhe që merr parasysh njëkohësisht konditat praktike të lëvizjes së masave.

Marksi na mëson që t' i evitojmë që të dyja këto gabime, na mëson që të jemi pa rezerva të guximshëm në çkatërrimin e gjithë maqinës së vjetër të shtetit dhe njëkohësisht ta shtrojmë problemin konkretisht: Komuna në pakë javë *filloji* të ndërtojë një maqinë shteti *të re,* proletare, duke zbatuar këto e këto masa për të arrirë në një demokraci më të madhe dhe për të çrrënjosur burokracinë. Le të mësojmë, pra, nga komunarët guximin revolucjonar, le të shohim në masat e tyre praktike një *skicë* të masave praktike, urgjente dhe që munt të realizohen menjëherë; dhe atëhere, *duke ndjekur këtë rrugë,* ne do të arrijmë në çkatërrimin e plotë të burokracisë.

Ajo që garanton mundësinë e një çkatërrimi të tillë është fakti që socjalizmi do ta shkurtojë ditën e punës, do t' i ngrerë *masat* në një jetë të re, do ta vërë *shumicën* e popullsisë në kondita, që u lejojnë të *gjithëve* pa përjashtim të krvejnë «funkcjonet e shtetit», dhe kjo do të shpjerë në *shuarjen e plotë* të shtetit përgjithërisht.

.... «Detyra e grevës së masave — vazhdon Kautski — kurrë nukë munt të jetë që të *çkatërojë* pushtetin e shtetit, po vetëm që ta shpjerë qeverinë të bëjë koncesjone në një çështje të caktuar ose të zëvëndësojë një qe-

veri, cë është kundër proletarjatit, me një qeveri, që i zgjat dorën (*entgegenkommende*)... Po kjo» (d. m. th. fitorja e proletarjatit kundër qeverisë kundërshtare) «nukë mund të shpjerë kurrë në *çkatërimin* e pushtetit shtetëror, po vetëm në një farë çvendosje (*Verschiebung*) të raporteve të forcavë *brënda pushtetit shtetëror*... Pra qëllimi i luftës sonë politike mbetet, si dhe gjer më sot, marrja në dorë e pushtetit shtetëror duke filuar shumicën në parlament dhe duke e bërë *parlamentin* zot të qeverisë». (P 726, 727, 728).

Këtu kemi oportunizmin më të kulluar dhe më banal; këtu kemi në fakt heqjen dorë nga revolucjoni, që pranohet me fjalë. Mendimi i Kautskit nukë shkon më lark se një «qeveri, që i zgjat dorën proletarjatit» — një çap prapa drejt filistinizmit në krahasim me v. 1847, kur «Manifesti Komunist» proklamoji «organizimin e proletarjatit në klasë sundonjëse».

Kautski do të shtrëngohet të realizojë «unitetin» e dëshëruar me Scheideman-ët, me Plehanovin, me Vanderveldët, të cilët që të gjithë janë në një mëndje për të lëftuar për një qeveri, «që i zgjat dorën proletarjatit». Sa për ne, ne do të ndahemi nga këta trathëtorë të socjalizmit dhe do të lëftojmë për çkatërrimin e gjithë maqinës së vjetër të shtetit, që vetë proletarjati i armatosur të bëhet qeveri. Këtu kemi dy ndryshime të mbëdha.

Kautski do të futet në kompaninë e ëmbël të Legienëve, dhe David-ëve, Plehanov-ëve, Potresovë-ve, Ceretelëve, Çernov-ëve, të cilët janë fare më një mëndje të lëftojnë për «çvendosjen e raporteve të forcës brënda pushtetit shtetëror», për «fitimin e shumicës në parlament dhe për t'i dhënë parlamentit tërë fuqinë përmi qeverinë», — një qëllim shumë fisnik, ku çdo gjë munt të pranohet nga oportunistët, ku çdo gjë mbetet në kuadrin e republikës parlamentare borgeze.

Sa për ne, ne do të ndahemi nga oportunistët; dhe gjithë proletarjati i ndërgjegjshëm do të jetë bashkë me ne në luftë jo për një «çvendosje të raporteve të forcës», po për *përmbysjen e borgezisë*, për *çkatërrimin* e parlamentarizmit borges, për republikën demokratike të tipit të Komunës ose për republikën e Sovjetëve të Deputetëve të punëtorëve dhe të Ushtarëve, për diktaturën revolucjonare të proletarjatit.

* * *

Në socjalizmin ndërkombëtar edhe më djathtas nga Kautski qëndrojnë këto tendenca: «E Përmuajshmja Socjaliste» në Gjermani (Legien, David, Kolb dhe shumë të tjerë, duke përfshirë dhe skandinavët Stauning dhe Branting); Jaurès-istët dhe Vandervelde në Francë dhe në Belgjikë; Turati, Treves dhe përfaqësonjës të tjerë të krahut të djathtë të partisë italjane; Fabjanët dhe «Të Pavarurit» («Partija Punëtore e Pavarur», që në të vërtetë kurdoherë është varur nga liberalët) në Angli etj. Të gjithë këta zotërinj, që luajnë një rol shumë të math, shumë shpesh predominant në punën parlamentare dhe në shtypin e partisë, mohojnë drejt për drejt diktaturën e proletarjatit, praktikojnë një oportunizëm të hapët. Për këta zotërinj «diktatura» e proletarjatit «është në kundërshtim» me demokracinë!! Në të vërtetë, ata nga demokratët mikroborgezë nuk i dallon asgjë serioze.

Duke marrë para sysh këtë rethanë, ne kemi të drejtë të përfundojmë se Internacjonalja e Dytë në shumicën dërmonjëse të përfaqësonjësve të saj zyrtarë ka rënë krejt në oportunizëm. Eksperjenca e Komunës nuk është harruar vetëm, po edhe shtrëmbëruar. Masave punëtore jo vetëm nuk u thoheshe se po afrohet koha, kur ato duhet të ngrihen dhe të thyejnë maqinën e vjetër të shtetit, duke e zëvëndësuar me një të re dhe duke bërë kështu sundimin

e tyre politik një bazë të transformimit të shoqërisë, po u thoheshe e kundërta, dhe «marrja e pushtetit» paraqitesh në mënyrë që mbeteshin mijra shtigje për oportunizmin.

Shtrëmbërimi i problemit mi qëndrimin e revolucjonit proletar kundrejt shtetit dhe heshtja reth këtij problemi nukë munt të mos luanin një rol kolosal atëhere, kur shtetet me një aparat ushtarak të forcuar nga konkurenca imperjaliste u transformuan në përbindsha lufte, që çfarosin miljonë njers për të zgjidhur konfliktin: kush do të sundojë në botë, Anglija ose Gjermanija, ky kapital financjar ose tjetri? *.

---

*) Në derëshkrim pason:

KAPITULLI VII

EKSPERJENCA E REVOLUCJONEVE RUSE TË 1905-ës DHE TË 1907-ës. Tema, që përmendet në tituilin e këtij kapitulli, është kaqë e madhe, sa që mi këtë temë munt dhe duhet të shruhen volume. Në këtë broshurë, natyrisht, duhet të kufizohemi vetëm me mësimet më kryesore të eksperjencës, me mësimet që kanë të bëjnë drejt për drejt me detyrat e proletarjatit në revolucjon në lidhje me pushtetin e shtetit». (Këtu derëshkrimi pritet.) Red.

PASTHËNJE PËR BOTIMIN E PARË

Kjo broshurë është shkruar në gusht dhe në shtator të v. 1917. Unë kisha hartuar planin e kapitullit që pason, e kapitullit të VII-të: «Eksperjenca e revolucjoneve ruse të viteve 1905 dhe 1917». Po, përveç titullit, nga ky kapitull nuk munda të shkruaj asnjë radhë: më «pengoji» kriza politike, vëngjilla e revolucjonit të Tetorit të v. 1917. Për një «pengesë» të tillë njeriu nukë munt veçse të gëzohet. Po botimin e pjesës së dytë të kësaj broshure (që i kushtohet «Eksperjencës së revolucjoneve ruse të viteve 1905 dhe 1917»), si duket, duhet ta shtyj për shumë kohë, është një gjë më e këndëshme dhe më e dobishme ta bësh «eksperjencën e revolucjonit», se sa të shkruash për këtë eksperjencë.

Autori

Petrograd, 30 nëntor 1917.

Botuar për herë të parë si libër më vete në botimet «Zhisn i Znanié» (Jeta dhe Shkenca), më 1918.

SHËNIM I INSTITUTIT TË SHKENCAVET:

Përkthimi që botojmë është bërë në bazë të origjinalit rusisht, botuar në «Veprat e Zgjedhura» të Leninit, 2 vëllime, Moskë 1943 (Gospolitizdat). Shënimet janë marrë nga botimi gjermanisht, Moskë 1947.

SHËNIME

1) *Fabjanët* — anëtarë të shoqërisë reformiste Fabjane (Fabian Society) në Angli. Shoqërija u themelua më 1884 nga një grup intelektualësh borgezë. Emërin «Fabjane» shoqërija e ka prej komandantit romak Fabius Cunctator (Ngurronjësi) që u bë i famëshëm për ngurrimin e tij dhe për taktikën që i bënte bisht çdo ndeshjeje vendimtare. Fabjanët predikonin kapërximin paqësor nga kapitalizmi në socjalizmë me anë reformash të vogëla. — f. 7.

2) *Herbert Spencer* (1820-1903) — Socjolog borges inglis. Sipas teorisë së Spencer-it shteti nukë lindi nga ndarja e shoqërisë në klasa dhe nga lufta e klasave, po nga se «funkcjonet shoqërore u bënë të koklavitura». — f. 14.

3) *N. K. Mihailovski* (1842-1904) — Ideologu më i rëndësishëm i narodnikëve liberalë rusë të viteve 1880-90. Përfaqësonjës i s'ashtuquajturës «metodë subjektive në socjologi». Në veprat e Leninit «Ç'janë Miqt' e Populit dhe si luftojnë ata kundër socjal-demokratëve?», «Brëndija ekonomike e lëvizjes narodnike» dhe «Zhvillimi i kapitalizmit në Rusi» gjejmë një kritikë të hollësishme të pikëpamjeve të Mihailovskit. — f. 14.

4) *Qeverija e Koalicjonit* — fjala është për qeverinë që u formua më 5 maj 1917, dy muaj pas përmbysjes së carizmit (në mars 1917), në të cilën bënin pjesë bashkë me përfaqësonjësit e borgezisë së madhe edhe menshevikët Skobeljev, Cereteli, dhe eserët (socjal-revolucjonarët) Çernov dhë Kerenski. — f. 18.

5) *Lufta tridhjetë-vjeçare* (1618-48) — filloi si luftë e princave feudalë të Gjermanisë kundër pushtetit të perandorit. Më vonë u futën në luftë pothuajse të gjitha fuqitë europjane. Lufta tridhjetë-vjeçare forcoi pushtetin e princave feudalë, e ndau Gjermaninë në qindra principata të vogëla dhe e çkatërroi dhe e shkretoi këtë vënd. — f. 26.

6. *Programi i Gotha-s* — i «Partisë Punëtore Socjal-Demokrate të

Gjermanisë» u pranua më 1875 në kongresin e partisë në Gotha, ku u bashkua partija marksiste që udhëhiqeshe nga Wilhelm Liebknecht dhe August Bebel me «Lidhjen e Përgjithëshme të Punëtorëve Gjermanë» të Lassalle-it. — f. 27.

7) *«Die Neue Zeit»* (Koha e re) — ishte organi teorik i socjaldemokracisë gjermane prej 1883-1922. — f. 41.

8) Është fjala për revolucjonet borgeze në Portugal (në shkurt 1908) dhe në Turqi (në gusht 1908). — f. 48.

9) *Perandorija e dytë* — quhet perandorija e Luigj Bonapartit (më vonë Napoleon III) në Francë, që zgjati prej 1852-1870, duke e dalluar nga Perandorija e parë e Napoleonit I, që zgjati prej 1804-1814. — f. 50.

10) *Girondinët* — që quheshin kështu pas lumit Gironde dhe departementit frances po me atë emër, — ishin përfaqësonjësit e partisë së borgezisë së madhe tregëtare dhe industriale në Francë, në kohën e revolucjonit borges, nga fundi i shek. XVIII. — f. 65.

11) *Blankistët* — shokët e revolucjonar të njohur frances Auguste Blanqui (1805-1881). Sipas Leninit, Blankistët «e prisnin shpëtimin e njerëzisë nga skllavërija e mëditjes jo prej luftës së klasës që do të bënte proletarjati, po nga përbetimi i një grupi të vogël intelektualësh», që s'kishin mbështetje në masat. Blankistët luajtën një rol me rëndësi në Komunën e Parisit më 1871. Më 1901 Blankistët hynë në Partinë socjaliste të Francës që kish themeluar Jules Guèsde. — f. 70.

12) *Programi i Erfurtit* — i partisë socjal-demokrate gjermane u pranua më 1891 nga kongresi i partisë në Erfurt. — f. 79.

13) *Ligja e socjalistëve* — ligjë e jashtëzakonëshme që u bë më 1878 nga Bismark-u për të luftuar socjal-demokracinë në Gjermani. U hoq më 1890. — f. 81.

14) *Kryengritje nga lartë* — kështu e quan Engelsi bashkimin e shteteve të shpërndara gjermane në një shtet të vetëm, bashkim që e bëri klika qeveritare prusjane «nga lartë», duke përdorur armët. Në luftën e Prusisë kundër Austrisë më 1866 u krijua «Federata Gjermane e Veriut». Pas luftës franko-gjermane më 1870-71 u krijua perandorija gjermane nën udhëheqjen e Prusisë. — f. 84.

15) *«Pravda»* (E vërteta) — gazetë e përditëshme bolshevike që u themelua më 22 prill 1912 (5 maj të kalendarit të ri) në Petersburg.

Doli gjer më 21 korrik 1914. Themelonjësit dhe drejtonjësit e gazetës ishin Leninі dhe Stalini. Ajo u ndoq vazhdimisht prej qeverisë cariste, u ndalua shpesh herë, dhe e vazhdoi botimin e saj me emëra të rij. Që prej marsit 1917 Pravda ishte organi qëndror i Partisë bolshevike. — f. 86.

16) *L. Cavaignac* (1802-1857) — gjeneral frances që shtypi me brutalitet të pashëmbëllt kryengritjen e punëtorëve të Parisit në qershor 1848. — f. 88

17) *Mandate imperative ose të lidhura* — quhen mandatet që e detyrojnë deputetin ta ndjekë pikë për pikë vijën dhe instrukcjonet që i kanë dhënë zgjedhësit. Shkelja ose shtrëmbërimi i vijës së dhënë shkakëton heqjen e mandatit të deputetit. — f. 91.

18) Në korrik-gusht 1903 u bë kongresi i dytë i Partisë Punëtore Socjal-demokrate Ruse, që u hap në Bruksel, po u detyrua të shpërngulet për në Londër për arësye të ndjekjeve të policisë. Kongresi i dytë ka luajtur një rol të math në historinë e partisë. Në fakt, gjatë kongresit të dytë u themelua partija punëtore socjal-demokrate ruse, u pranua programi dhe statuti i partisë, u zgjodhën organet qëndrore që drejtonin partinë. Lufta që u ndez në kongres pikësëpari për çështje organizative në mes të dy rrymave të partisë punëtore socjal-demokrate ruse (me një anë rryma revolucjonare e udhëhequr nga Leninі, dhe rryma oportuniste nga ana tjetër) shkakëtoi ndarjen e partisë në dy grupe: në bolshevikë e në menshevikë. Emërat spjegohen nga fakti se në zgjedhjet për organet qëndrore të partisë drejtimi i Leninit fitoi shumicën (rusisht: bolshinstvo) e zërave dhe kundërshtarët mbetën në minoritet (rusisht: menshinstvo). — f. 95.

19) Fjala është për ngjarjet e ditëve 3-5 korrik 1917 në Petrograd. Këto ditë u bënë demonstrata të mëdha nga punëtorët dhe ushtarët me parullën: gjithë pushtetin Sovjetëve! Me gjithë karakterin paqësor të demonstratës, qeverija provizore e Kerenskit përdori trupat kundër demonstrantëve. Si e shpërndau demonstratën duke përdorur armët, qeverija mori masa shtypjeje brutale kundër partisë bolshevike. Organi qëndror i partisë, gazeta «Pravda» u mbyll, kundër Leninit u lëshua një mandat arrestimi që e detyroi të hidhet në ilegalitet, një sërë udhëheqësish të partisë bolshevike u arrestuan. Me gjithë kushtet e vështira, partija nënë udhëheqjen e Leninit dhe Stalinit mundi të përgatisë fitoren e revolucjonit të proletarjatit në tetor 1917. — f. 95.

20) *Shylok* — është tipi i fajdexhiut në dramën e Shakespearit: tregëtari i Venedikut. — f. 112.

21) Shkrimtari rus Pomjalovski përshkruan në librin e tij «Skica nga seminari» sistemin e edukatës që budalleps njerëzit dhe sjelljet bru tale që përdoreshin në shkollat fetare ruse nga mezi i shek. XIX. — f. 112

22) Në raportin e tij para kongresit XVIII të Partisë Komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik në mars 1939, shoku Stalin foli kështu mi dok rinën e Marksit-Engelsit mi shtetin:

«Nga një herë bëjnë këtë pyetje:... Klasat çfrytëzonjëse janë çdu kur tek ne, socjalizmi në vijat kryesore është ndërtuar, ne po ecim drejt komunizmit; po doktrina marksiste e shtetit thotë, se në regjimin komunist nukë do të ketë shtet — pse të mos kontribuojmë ne atë herë, që ta bëjmë të shuhet shteti ynë socjalist? A nuk është koha që ta vënë shtetin në muzenë e antikave?

Këto pyetje dëshmojnë se ata që i bëjnë, kanë mësuar përmëndsh dhe me zell disa fraza nga doktrina e Marksit dhe Engelsit mi shte tin. Po ato dëshmojnë gjithashtu, se këta shokë nuk e kanë kupëtuar thelbin e kësaj doktrine... se nukë kanë kupëtuar veçanërisht situacjo nin e tanishëm internacjonal, se kanë harruar faktin e rrethimit kapi talist, se nuk i shohin rreziqet që rrjedhin nga kjo situatë për vëndin e socjalizmit...

Ne shkojmë përpara, drejt komunizmit. A do të mbesi shteti tek ne edhe në periodën e komunizmit?

Po, ay do të mbesi, po nuk u hoq rrethimi kapitalist, po s'u çduk rreziku i sulmeve ushtarake nga jashtë. Kupëtohet vetiu, se forma e shtetit tonë do të ndryshojë përsëri, sipas ndryshimeve të situacjonit të brëndshëm dhe të jashtëm.

Jo, ay nuk ko të mbesi, ay do të çduket, po qe se hiqet rrethimi kapitalist, po qe se këtij rrethimi ia zën vëndin rrethimi socjalist.» (J. Stalin, «Çështjet e Leninizmit» Moskë 1945, f. 619-620 dhe 625)—f. 119

23) Kongresi i Parisit i Internacjonales së Dytë pranoi rezolucjonin e Kautskit, sipas të cilit hyrja e socjalistëve në një qeveri borgeze le joheshe nënë disa kondita. — f. 123.

PASQYRË E LËNDËS

Parathënje për botimin e parë . . . faqe 7
Parathënje për botimin e dytë . . . » 8

Kapitulli I. SHOQËRIJA ME KLASA DHE SHTETI
1. Shteti-produkt kontradiktash të papajtuarshme në mes të klasave . . . » 9
2. Formacjone specjale të armatosura, burgje e të tjera . . . » 13
3. Shteti si vegël për çfrytëzimin e klasës së shtypur . . . » 17
4. «Shuarja» e shtetit dhe revolucjoni me forcë . . . » 21

Kapitulli II. SHTETI DHE REVOLUCJONI. EKSPERJENCA E VJETËVE 1848-1851
1. Vëngjilla e revolucjonit . . . » 29
2. Bilani i revolucjonit . . . » 34
3. Si e shtronte Marksi problemin më 1852 . . . » 41

Kapitulli III. SHTETI DHE REVOLUCJONI. EKSPERJENCA E KOMUNËS SË PARIZIT TË 1871-së. ANALIZA E MARKSIT
1. Ku qëndron heroizmi i orvatjes së komunarëve? . . . » 44
2. Me se duhet zëvëndësuar maqina e shtetit që është thyer . . . » 49
3. Çdukja e parlamentarizmit . . . » 54
4. Organizimi i unitetit të kombit . . . » 61
5. Çdukja e shtetit parazit . . . » 65

Kapitulli IV. VAZHDIM. SHPJEGIME PLOTËSONJËSE TË ENGELSIT
1. «Problemi i banesave» . . . » 68
2. Polemika me anarkistët . . . » 71
3. Letra e Bebelit . . . » 76
4. Kritika e projektit të programit të Erfurt-it . . . » 79
5. Prapathënie e vitit 1891 për «Luftën Civile» të Marksit . . . » 87
6. Rreth [illegible] përxmin e demokracisë . . . » 93

Kapitulli V. BAZAT EKONOMIKE TË SHUARJES SË SHTETIT
1. Si e shtron problemin Marksi . . . . . faqe 97
2. Kapërximi prej kapitalizmit në komunizëm . . . . . » 100
3. Faza e parë e shoqërisë komuniste . . . . . » 106
4. Faza më e lartë e shoqërisë komuniste . . . . . » 110

Kapitulli VI. VULGARIZIMI I MARKSIZMIT PREJ OPORTUNISTËVE
1. Polemika e Plehanovit me anarkistët . . . . . » 120
2. Polemika e Kautskit me oportunistët . . . . . » 122
3. Polemika e Kautskit me Ponnekoek-un . . . . . » 130

Pasthënje për botimin e parë . . . . . » 141

Shënime . . . . . » 143

Gabime shtypi

f.	7	rj.	7	nga poshtë:	dheinë — lexo: dhe në.
»	»	»	2	» » :	shumica të ashtuquajturave — lexo: shumica *e* të etj.
»	8	»	7	» poshtë:	masava — lexo: masave.
»	11	»	5	» lart :	sh erpë — lexo: shterpë.
»	13	»	6	» » :	nkarje — lexo: ndarje.
»	13	»	12	» poshtë:	zi forcë — lexo: *si* forcë.
»	13	»	7	» » :	nga sjera — lexo: nga *njers*.
»	18	»	17	» lart :	tani, më — lexo: tani më.
»	22	»	12/13	» :	si, përfaqësonjësi — lexo: si përfaqësonjësi.
»	26	»	10	» poshtë:	pas fjalëve «lufta e Tridhjetë Vjetëve» mungon shifra [4]) që i referohet shënimit në fund të librit.
»	32	»	3	» lart :	të vjeteve 1848-1871 — lexo: të vjeteve 1848 *dhe* 1871.
»	32	»	10	» » :	dokrinën — lexo: doktrinën.
»	36	»	6	» » :	së tfj — lexo: së tij.
»	37	»	11	» » :	«mprojtjes së atdheut». Po është etj. — lexo: «mprojtjes së atdheut», *po* është etj.
»	37	»	14	» poshtë:	... e të tjerëve vënde — lexo: ... e të tjerëve, vënde.
»	39	»	13	» » :	e ç aqet — lexo: e çfaqet.
»	42	»	3	» » :	të Marksi — lexo: *te* Marksi.
»	44	»	3	» lart :	orvajtje — lexo: orvatje.
»	46	»	16/15	» poshtë:	orvatja shokëve — lexo: orvatja *e* shokëve.
»	47	»	6	» lart :	e mundëshme — lexo: i mundëshëm.
»	47	»	fundit	:	skelastike — lexo: skolastike.
»	48	»	3	» lart :	pas fjalës «turk» mungon shifra [5]) që i referohet shënimit në fund të librit.
»	51	»	12	» » :	m ud të hiqeshë — lexo: mund të hiqeshe.

f.	53	rrj.	4	»	lart : demokratik-revolucjonar — lexo: demokratike-revolucjonare.
»	58	»	14	»	poshtë: Sombat-ët — lexo: Sembat-ët.
»	59	»	14	»	» : pas fjalës nënështrim duhet një *pikëpresë*
»	67	»	6	»	» : në të cilën — lexo: *me* të cilën.
»	73	»	17	»	poshtë: të *caktuar*. — lexo: të *caktuar»*.
»	76	»	14	»	lart : mars — 1875 — lexo: mars 1875.
»	84	»	9	»	» : g i hë — lexo: gjithë.
»	89	»	13	»	» : . . . private ose etj. — lexo: private. Ose etj.
»	89	»	14	»	poshtë: revolucjonar që gjer etj. — lexo: revolucjonar gjer etj.
»	90	»	9	»	» : sh e et — lexo shtetet.
»	90	»	2	»	» : më mëditjen — lexo: me mëditjen.
»	91	»	7/8	»	lart : Pse per çdukjen e shtetit duhet etj. — lexo: Pse, për çdukjen e shtetit, duhet etj.
»	92	»	14	»	» : Që a të h dhur — lexo: këta të hedhur
»	95	»	8	»	» : pas fjalës gushtit mungon shifra 1) që i re-ferohet shënimit në fund të librit.
»	101	»	[illegible]	»	» : «transformimin» e proletarjatit — lexo: «transformimin e proletarjatit etj.
»	105	»	10	»	» : «shteti», është etj. — lexo: «shteti» është etj.
»	113	»	15	»	» : d.m.th.: shteti etj. — lexo: d.m.th.: të shtetit etj.
»	114	»	4	»	» : Kropetkin — lexo: Kropotkin
»	115	»	12	»	poshtë: së të gjithë etj. — lexo: së gjithë etj.
»	125	»	2	»	lart : Benstein-it — lexo: Bernstein-it.
»	125	»	7	»	poshtë: në një anë, pikërisht etj. — lexo: në një anë pikërisht etj.
»	128	»	14	»	një parlamentar — lexo: një trup parlamentar

BIBLIOTEKA NARULL

Shtypur në 30.000 copë
Stabilimenti «Mihal Duri» — Tiranë, 1942